



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 1

D H J E T O R 2 0 1 0



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 1

**BOTUES** © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Zyra e Kryeekonomistit  
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000  
Tel: ++381 38 222 243  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike** [economicanalysis@bqk-kos.org](mailto:economicanalysis@bqk-kos.org); [statistics@bqk-kos.org](mailto:statistics@bqk-kos.org);

**KRYEREDAKTOR** Gani GËRGURI

**REDAKTORË** Valentin TOÇI  
Arben MUSTAFA

**SHKURTESAT:**

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ATM	Bankomatë (angl. Automated Teller Machines)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BEEPS	Business Environment and Enterprise Performance Survey
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CED	Ditët për Zbatimin e Kontratës (angl. Contract Enforcement Days)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (angl. European Bank for Reconstruction and Development)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi i Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
NLIS	New Legal Indicators Survey
NPL	Kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (angl. Point of Sales)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (angl. Organization for Economic Cooperation and Development)
OJSHEF	Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (angl. Rule of Law Index)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
ROE	Kthimi në kapital (angl. Return on Equity)
RWA	Asetet e Përshtatura ndaj Riskut (angl. Risk Weighted Assets)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (angl. Special Drawing Rights)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

**Vërejtje:** Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.  
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2010), Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 1, Prishtinë: BQK.  
 Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

**PËRMBAJTJA:**

<b>1. Parathënie</b>	<b>9</b>
<b>2. Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>11</b>
<b>3. Zhvillimet Makroekonomike dhe Financiare në Ekonominë Globale</b>	<b>14</b>
3.1. Zhvillimet ekonomike në Evropën Juglindore	20
<b>4. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë</b>	<b>22</b>
<b>5. Sektori Financiar i Kosovës</b>	<b>26</b>
5.1. Karakteristikat e përgjithshme	26
5.2. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj institucioneve tjera financiare	28
<b>6. Sektori Bankar</b>	<b>29</b>
6.1. Karakteristikat e përgjithshme të sektorit bankar	29
6.2. Bilanci i gjendjes së sektorit bankar	30
6.3. Performanca e sektorit bankar	35
6.4. Normat e interesit	40
6.5. Risqet e sektorit bankar	41
6.6. Analiza ‘Stress-Test’	51
<b>7. Institucionet tjera Financiare</b>	<b>57</b>
7.1. Kompanitë e sigurimit	57
7.2. Institucionet mikrofinanciare	57
7.3. Fondet pensionale	58
<b>Tema Specifike</b>	
<b>8. Stabiliteti i Sektorit Financiar dhe Potencialet e Rritjes Ekonomike në EJK</b>	<b>61</b>
<i>Boštjan Jazbec dhe Albulenë Kastrati</i>	
<b>9. Zbërthimi i Kostos së Ndërmjetësimit Financiar: Analizë Krahasuese</b>	<b>78</b>
<i>Valentin Toçi, Arben Mustafa dhe Astrit Panxha</i>	
<b>10. Zbatimi i të Drejtave të Kreditorëve në Kosovë: Analizë Empirike</b>	<b>87</b>
<i>Valentin Toçi dhe Arben Mustafa</i>	
<b>11. Qasja në Financa në Kosovë: Rezultatet nga BEEPS 2009</b>	<b>96</b>
<i>Valentin Toçi, Zana Gjocaj dhe Arben Mustafa</i>	
<b>12. Shtojca Statistikore</b>	<b>103</b>
<b>13. Referencat</b>	<b>123</b>

**LISTA E FIGURAVE-----9**

Figura 1. Norma e interesit EURIBOR DHE LIBOR -----	16
Figura 2. Ndryshimi vjetor i indeksave të tri bursave më të mëdha-----	16
Figura 3. Kthimi ndaj kapitalit për grupet bankare -----	17
Figura 4. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave për grupet bankare-----	18
Figura 5. Rritja reale e PBB-së -----	22
Figura 6. Indeksi i çmimeve të konsumit -----	23
Figura 7. Papunësia në Kosovë, rajon dhe Evropë-----	24
Figura 8. Bilanci tregtar-----	25
Figura 9. Struktura e asetëve e sektorit financiar -----	26
Figura 10. IHH për sektorin financiar në Kosovë-----	27
Figura 11. Struktura e investimeve e sektorit financiar -----	28
Figura 12. Numri i bankave dhe struktura e pronësisë -----	29
Figura 13. Kontributi në rritjen e asetëve sipas burimeve-----	31
Figura 14. Struktura e kredive -----	32
Figura 15. Struktura e kredive sipas industrisë-----	32
Figura 16. Struktura e depozitave sipas sektorëve -----	34
Figura 17. Struktura e depozitave të afatizuara -----	35
Figura 18. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve operacionale-----	35
Figura 19. Treguesit e performancës -----	36
Figura 20. Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e KMK-së -----	36
Figura 21. Trendi i të hyrave nga interesi -----	37
Figura 22. Trendi i të hyrave nga jo interesi -----	37
Figura 23. Struktura e të hyrave e sektorit bankar -----	38
Figura 24. Trendi i shpenzimeve të sektorit bankar -----	38
Figura 25. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar-----	39
Figura 26. Trendet e të hyrave dhe shpenzimeve -----	39
Figura 27. Mesatarja lëvizëse 12-mujore e normave të interesit -----	40
Figura 28. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar -----	41
Figura 29. Rezervat e sektorit bankar-----	42
Figura 30. Asetet likuide-----	43
Figura 31. Struktura e letrave me vlerë -----	43
Figura 32. Hendeku i likuiditetit, diferenca në mes gjithsej asetëve dhe detyrimeve sipas maturitetit -----	44
Figura 33. Struktura e kredive sipas klasifikimit -----	44
Figura 34. Gjithsej kreditë dhe NPL -----	45
Figura 35. Struktura e kredive jo performuese -----	45
Figura 36. NPL sipas sektorëve -----	46

Figura 37. NPL sipas industrive -----	46
Figura 38. Struktura e kredive mbi 90 ditë vonesë sipas industrive -----	46
Figura 39. NPL dhe provizionet-----	47
Figura 40. Koncentrimi i riskut kreditor-----	47
Figura 41. Kapitalizimi i sektorit bankar-----	48
Figura 42. Gjithsej kapitali i sektorit bankar -----	49
Figura 43. Struktura e kapitalit të klasit të parë-----	50
Figura 44. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ -----	50
Figura 45. Struktura e RWA sipas peshës së riskut-----	51
Figura 46. Prezentimi i thjeshtësuar i metodologjisë së modelit ‘Stress-Test’ -----	52
Figura 47. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	57
Figura 48. Kreditë e lëshuara nga IMF-të -----	57
Figura 49. Çmimi i aksionit të Trustit -----	58
Figura 50. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit -----	64
Figura 51. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit në Kosovë -----	65
Figura 52. Rritja reale dhe bilanci buxhetor në Kosovë -----	65
Figura 53. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së në Kosovë -----	65
Figura 54. Rritja e depozitave dhe kredive në Kosovë -----	65
Figura 55. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit në Shqipëri-----	66
Figura 56. Rritja reale dhe bilanci buxhetor në Shqipëri -----	66
Figura 57. Llogaria rrjedhëse në Shqipëri -----	66
Figura 58. Rritja e depozitave dhe kredive në Shqipëri -----	66
Figura 59. Inflacioni, mesatarja e çmimit të konsumit në Maqedoni -----	67
Figura 60. Rritja reale dhe bilanci buxhetor në Maqedoni -----	67
Figura 61. Llogaria rrjedhëse në përqindje të PBB-së -----	68
Figura 62. Rritja e depozitave dhe kredive në Maqedoni -----	68
Figura 63. Inflacioni, mesatarja e çmimit të konsumit në Bullgari -----	69
Figura 64. Rritja reale dhe bilanci buxhetor në Bullgari -----	69
Figura 65. Llogaria rrjedhëse në Bullgari -----	69
Figura 66. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit në Serbi -----	70
Figura 67. Rritja reale dhe bilanci buxhetor në Serbi -----	70
Figura 68. Llogaria rrjedhëse në Serbi-----	70
Figura 69. Rritja e depozitave dhe Kredive në Serbi-----	70
Figura 70. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit në Mal të Zi -----	71
Figura 71. Rritja reale dhe bilanci buxhetor në Mal të Zi -----	71
Figura 72. Llogaria rrjedhëse në Mal të Zi -----	72
Figura 73. Rritja e depozitave dhe kredive në Mal të Zi -----	72
Figura 74. Normat e interesit të depozitave dhe kredive në vendet e EJT-së-----	73



Figura 75. Normat e interesit në sektorin bankar 2006-2009 .....	79
Figura 76. Dhjetë pengesat kryesore për biznesin në Kosovë .....	97
Figura 77. Përqindja e firmave që identifikojnë qasjen në financa si pengesë për të bërë biznes .....	97
Figura 78. Përqindja e firmave që përdorin linja krediti nga institucionet financiare .....	98
Figura 79. Numri i huamarrësve në banka komerciale, në 1000 të rritur .....	98
Figura 80. Përqindja e ndërmarrjeve që shfrytëzojnë financim bankar për investime .....	99
Figura 81. Përqindja e investimeve të mbuluara nga financimi bankar .....	100
Figura 82. Raporti i mbulimit të kredisë me kolateral .....	100

## LISTA E TABELAVE .....

Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së botërore .....	15
Tabela 2. Gjithsej humbjet e raportuara dhe kapitali shtesë për bankat .....	20
Tabela 3. Numri i institucioneve financiare .....	26
Tabela 4. Rrjeti i sektorit bankar .....	30
Tabela 5. Struktura e asetëve të sektorit financiar .....	31
Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sektorit financiar .....	34
Tabela 7. Treguesit e efikasitetit të sektorit bankar .....	40
Tabela 8. Distribrimi i asetëve sipas shkallës së CAR .....	48
Tabela 9. Përmbledhja e rezultateve të 'Stress-Testit': rreziku kreditor .....	55
Tabela 10. Përmbledhja e rezultateve të 'Stress-Testit': rreziku i likuiditetit .....	56
Tabela 11. Regjimet e normës së këmbimit në EJM .....	63
Tabela 12. Struktura e eksportit dhe importit .....	64
Tabela 13. Struktura e pronësisë së sektorit bankar .....	74
Tabela 14. Matrica e tregtisë mes vendeve të EJM-së .....	75
Tabela 15. Kushtet e biznesit në vendet e EJM-së .....	76
Tabela 16. Struktura e pasqyrës së të hyrave të bankave komerciale dhe margjinat e fitimit .....	81
Tabela 17. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit .....	84
Tabela 18. Ditët e Zbatimit të Kontratës, Kosto e Zbatimit, Indeksi i Sundimit të Ligjit .....	88
Tabela 19. Zbatimi i Ligjit të Kolateralit në Kosovë .....	91
Tabela 20. Zbatimi i ligjeve të kolateralit në Kosovë, EJM, EQL dhe CIS .....	93

## LISTA E KUTIVE .....

Kutia 1. Performanca e grupeve bankare të cilat operojnë në Kosovë .....	15
Kutia 2. Zbërthimi i faktorëve kontribues në Kthimin Mesatar në Kapital .....	36



## 1. Parathënie

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka kënaqësinë t'i prezantojë publikut numrin e parë të Raportit të Stabilitetit Financiar. Ky publikim i pasuruar për nga përmbajtja dhe i përmirësuar në cilësi, është një vazhdimësi e publikimit të mëhershëm 'Buletini i Sektorit Financiar' që është botuar nga Banka Qendrore që nga viti 2005. Raporti i Stabilitetit Financiar synon të informojë publikun e gjerë, profesionistët dhe autoritetet vendimmarrëse mbi zhvillimet në sektorin financiar, me fokus të veçantë në sektorin bankar, duke identifikuar brishtësitë dhe rreziqet për stabilitetin e këtij sektori. Bazuar në Ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, sigurimi i stabilitetit të sektorit financiar paraqet objektivin primar të këtij institucioni. Pasi që një krizë financiare mund të ketë kosto të lartë ekonomike e sociale, stabiliteti financiar paraqet një objektive të rëndësishme për politikë bërësit. Rrjedhimisht, publikimi i Raportit të Stabilitetit Financiar paraqet një vazhdimësi të angazhimeve në funksion të stabilitetit të këtij sektori. Duke informuar publikun mbi gjendjen e sektorit financiar, Banka Qendrore synon të ngritë transparencën dhe nxitë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sektorit financiar të vendit.

Duke pasur parasysh shkallën e integritit financiar në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë këtu edhe sistemin financiar të Kosovës, ky numër i Raportit të Stabilitetit Financiar fillimisht trajton zhvillimet kryesore makroekonomike dhe financiare ndërkombëtare, me qëllim të identifikimit të rreziqeve potenciale ekzgjene për sektorin financiar të Kosovës. Sektorët real, të jashtëm dhe fiskal të ekonomive bashkëdeterminohen me sektorin financiar dhe paraqesin një përcaktues shumë të rëndësishëm të performancës së këtij sektori. Kështu, raporti vazhdon me një analizë të zhvillimeve makroekonomike në ekonominë vendore. Pastaj, raporti paraqet një pasqyrë mbi karakteristikat e përgjithshme të sektorit financiar të Kosovës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar sektorit bankar, andaj raporti vazhdon me një analizë të hollësishme të zhvillimeve për sa i përket aktivitetit dhe performancës së këtij sektori.

Për të ofruar një pasqyrë më të qartë mbi qëndrueshmërinë dhe rreziqet potenciale të sektorit bankar, ky raport trajton rrezikun kreditor, rrezikun e solvencës dhe të likuiditetit. Po ashtu, është prezantuar metodologjia dhe rezultatet e 'Stress-Testit' për sektorin bankar të Kosovës, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit bankar për të përballuar tronditjet eventuale. Një pjesë e raportit trajton zhvillimet në sektorët tjerë të sistemit financiar dhe ndërlihdjes së tyre me sektorin bankar.

Pos qëndrueshmërisë ndaj tronditjeve, stabiliteti financiar nënkupton edhe funksionimin efikas të tregjeve, institucioneve dhe infrastrukturës mbështetëse të sistemit financiar, që mundëson një ndërmjetësim efikas financiar dhe alokim efikas të resurseve. Andaj, ky edicion i Raportit të Stabilitetit Financiar përmban katër artikuj tematik. Këto punime trajtojnë segmente specifike, të ndërlihdura me sektorin bankar dhe ndërveprimin e tij me sektorët tjerë të ekonomisë. Analiza e parë shtjellon çështjet e ndërlihdura me rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar në vendet e EJL-së. Analiza e dytë zbërthen koston e ndërmjetësimit të sektorit bankar të Kosovës dhe krahason atë me disa vende të rajonit, duke ofruar kështu një pasqyrë mbi faktorët që përcaktojnë normat e interesit për kreditë në Kosovë. Analiza e tretë trajton çështjen e zbatimit të të drejtave të kreditorëve në Kosovë dhe bazohet në rezultatet e një ankete me bankat komerciale në vend. Së fundi, ky publikim trajton problematikën e qasjes së bizneseve në financa në Kosovë dhe bazohet në të dhënat nga anketa Business Environment and Enterprise Performance Survey (BEEPS).

Gani Gërguri  
Guvernator, u.d.



## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Në dy vitet e fundit, ekonomia botërore përjetoi një rën timer nga krizat më të rënda në historinë e saj, e cila filloi me turbulencat në sektorin financiar dhe çoi në një krizë të përgjithshme ekonomike. Shumë vende të zhvilluara hynë në recesion, ndërsa vështirësitë e sektorit financiar ishin të pranishme pothuajse në çdo vend. Efektet e krizës janë reflektuar edhe në Kosovë, por ndikimi mund të konsiderohet të ketë qenë i moderuar. Në kuadër të sektorit financiar, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) përfaqëson sektorin më së shumti të goditur, i cili shënoi një rënie të konsiderueshme në vlerën investimeve në tregjet financiare ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, performanca e grupeve bankare të huaja që kanë degët në Kosovë është ndikuar negativisht, por kjo nuk u pasqyrua në bankat që operojnë në Kosovë. Kriza globale në Kosovë u reflektua edhe përmes sektorit të jashtëm, ku u vu re një rënie e eksporteve, dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja direkte (IHD). Megjithatë, në gjysmën e parë të vitit 2010, ekonomia globale kishte performancë më të mirë në krahasim me vitin 2009, si rezultat i politikave ekspansioniste monetare dhe fiskale të ndërmarra në shumë vende. Si rezultat, shumica e vendeve të zhvilluara pritet të shënojnë norma pozitive rritjes ekonomike në vitin 2010, ndërsa tregjet financiare kanë filluar të rikuperohen. Përmirësimet në ekonominë globale u reflektuan edhe në ekonominë e Kosovës gjatë kësaj periudhe. Në këtë kontekst, vërehet përmirësim në performancën e investimeve të TKPK-së dhe po ashtu është regjistruar rritje e eksporteve, dërgesave të emigrantëve dhe IHD-ve. Këto përmirësime zvogëlojnë rrezikun nga tronditjet e mundshme të ekonomisë së Kosovës që mund të vijnë nga sektori i jashtëm.

Zhvillimet në ekonominë e Kosovës gjatë periudhave të fundit ishin në përputhje me zhvillimet ekonomike ndërkombëtare, gjë që është normale për një ekonomi të vogël dhe të hapur. Si pasojë e krizës globale, ekonomia e Kosovës në vitin 2009 u ballafaqua me rënie të dërgesave të emigrantëve, eksporteve dhe IHD-ve, të cilat ndikuan negativisht konsumin dhe investimet në vend. Këto zhvillime ndikuan në rritjen e pasigurisë së sektorit bankar ndaj performancës së ekonomisë së vendit, gjë që u shoqërua me ngadalësim të rritjes së kredihënies. Sidoqoftë, rritja e shpenzimeve publike gjatë kësaj periudhe arriti që deri në një masë të kompensojë zvogëlimin e konsumit dhe investimeve të sektorit privat. Si rezultat, ekonomia e Kosovës në vitin 2009 kishte një normë pozitive të rritjes prej 2.9 përqind, bazuar në vlerësimet e Entit Statistikor të Kosovës, por që ishte më e ulët krahasuar me normën e rritjes në vitin 2008. Në vitin 2010, ekonomia e Kosovës pritet të shënojë një normë reale të rritjes ekonomike prej 4.6 përqind (FMN, 2010c), e cila mbështetet në rritjen e konsumit dhe investimeve të sektorit privat. Ekonomia e Kosovës edhe gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me nivel të ulët të inflacionit dhe të deficitit buxhetor, ndërsa norma e lartë e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe papunësia e lartë vazhdojnë të jenë sfida. Në përgjithësi, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2010 pritet të ketë performancë më të mirë, gjë e cila ka implikime pozitive për stabilitetin e sektorit financiar. Në këtë aspekt, përmirësimi i aktivitetit ekonomik ngritë aftësinë paguese të kredimarrësve, duke zvogëluar kështu rrezikun kreditor për sektorin bankar. Kjo pritet të ndikojë pozitivisht në zgjerimin e kredihënies nga sektori bankar, duke i kontribuar përmirësimin të mëtutjeshëm të performancës së ekonomisë përmes rritjes së nivelit të konsumit dhe investimeve në vend.

Sistemi financiar i Kosovës vazhdon të dominohet nga sektori bankar, me një pjesëmarrje prej 77.5 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar. Gjithsej asetet e sektorit bankar shënuan një normë më të ulët të rritjes gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, gjë që shkaktoi një rënie të lehtë të pjesëmarrjes së aseteve të këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar. Në anën tjetër, përmirësimi i performancës së investimeve të TKPK-së në sektorin e jashtëm bëri që pjesëmarrja e aseteve të fondeve pensionale në gjithsej asetet e sistemit financiar të shënojë rritje. Struktura e tregut në sistemin financiar të Kosovës dallon ndërmjet sektorëve të ndryshëm. Përderisa sektori i sigurimeve dhe ai i institucioneve mikrofinanciare kanë një shkallë të moderuar të koncentrimin të tregut, tregu bankar vazhdon të jetë mjaft i koncentruar. Sidoqoftë, shkalla e koncentrimin të

tregut në sektorin bankar vazhdon të zvogëlohet si rezultat i zgjerimit të vazhdueshëm të aktivitetit të bankave më të vogla, të cilat po bëjnë që presionet konkurruese në tregun bankar të rriten.

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë i dominuar nga bankat me pronësi të huaj, si për nga numri i bankave ashtu edhe për nga pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet. Nga tetë banka komerciale që operojnë në Kosovë, gjashtë janë në pronësi të huaj dhe përfaqësojnë rreth 90 përqind të gjithsej asetëve të sektorit bankar. Ky sektor në vitet e fundit vazhdimisht ka zgjeruar rrjetin, duke lehtësuar kështu qasjen e publikut në shërbimet bankare. Sidoqoftë, ngadalësimi i aktivitetit ndërmjetësues që nga evoluimi i krizës shtyri bankat të zvogëlojnë shpenzimet, duke bërë që të zvogëlohen edhe shpenzimet për zgjerimin e rrjetit bankar gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 si dhe të zvogëlohet numri i punëtorëve në këtë sektor.

Asetet e sektorit bankar të Kosovës vazhduan të rriten edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, duke arritur vlerën prej 2.2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind. Në kuadër të strukturës së asetëve të sektorit bankar vërehet një rritje e theksuar e investimeve në letra me vlerë jashtë vendit, përderisa pjesëmarrja e kredive ka shënuar rënie. Megjithatë, kreditë vazhdojnë të jenë komponenti kryesor i asetëve të sektorit bankar. Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të shtrëngojë kredidhënien edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Si rezultat, në qershor 2010 kreditë shënuan një normë vjetore të rritjes prej 9.7 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 17.5 përqind në qershor 2009. Sidoqoftë, sinjalet pozitive për performancën e ekonomisë gjatë vitit 2010 kanë ndikuar pozitivisht në kreditimin e sektorit bankar, duke pasur parasysh se norma e rritjes së kredive gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 ishte më e lartë krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2009. Struktura e kredive të sektorit bankar vazhdon të dominohet nga kreditë e lëshuara për ndërmarrjet, ndërsa kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare mbeten në një nivel më të ulët, edhe pse në rritje gjatë kësaj periudhe. Pjesëmarrja e ulët e kredive për ekonomitë familjare mund të shpjegohet pjesërisht nga niveli i lartë i papunësisë që mbizotëron në Kosovë, gjë që e zvogëlon përqindjen e popullsisë që kualifikohen për të marrë kredi bankare. Sa i përket strukturës së kredive të lëshuara për ndërmarrjet, ato kryesisht përbëhen nga kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë, e cila pasqyron mbështetjen e lartë të ekonomisë së Kosovës në sektorin e tregtisë.

Burimi kryesor i financimit për aktivitetet e sektorit bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat, të cilat përfaqësojnë 79 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar. Depozitat ishin burim kryesor dhe i qëndrueshëm i financimit për sektorin bankar të Kosovës edhe në kohën e evoluimit të krizës në tregjet globale. Kjo për faktin se depozitat në sektorin bankar të Kosovës në masën dërmuese përbëhen nga depozitat e mbledhura brenda vendit. Kjo ka bërë që sektori bankar i Kosovës të mos jetë i varur nga fondet në tregjet ndërkombëtare për t'i financuar operacionet. Në qershor 2010, vlera e depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 1.8 miliard euro (46 përqind e PBB-së), që paraqet një rritje vjetore prej 15.8 përqind.

Ngadalësimi i kredidhënies si dhe zvogëlimi i normave të interesit në tregun ndërbankar evropian në vitin 2009 rezultoi në një rënie të konsiderueshme të profitit të sektorit bankar. Zvogëlimi i rritjes së të hyrave nga interesi vazhdoi edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Mirëpo, bankat ndërmorën masa për të zvogëluar shpenzimet e tyre, posaçërisht shpenzimet e përgjithshme dhe administrative. Si rezultat, sektori bankar i Kosovës në qershor 2010 regjistroi një profit neto prej 17.1 milion euro, që paraqet një rritje prej 65.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Masat e ndërmarrja nga sektori bankar për shkurtimin e shpenzimeve kanë ndikuar në përmirësimin e disa indikatorëve të efikasitetit për këtë sektor, si raportin ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, vlerën mesatare të asetëve për një punëtor, etj.

Ngadalësimi i rritjes së kredive dhe sjellja e kujdesshme e bankave në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit çoi në një përmirësim të mëtejshëm të gjendjes së likuiditetit të sistemit bankar gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2010. Në këtë kontekst, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave të sektorit bankar në qershor 2010 ishte 80.2 përqind, normë kjo në pajtim me rekomandimet e Bankës Qendrore. Për më tepër, pjesëmarrja e aseteve likuide në gjithsej asetet e sistemit bankar në qershor 2010 u ngrit në 34.5 përqind, nga 29.4 përqind sa ishte në qershor 2009. Pozita e kënaqshme e likuiditetit të sektorit bankar tregohet edhe nga rezultatet e modelit 'Stress-Test', të cilat tregojnë se bankat janë mjaft mirë të përgatitura për t'i bërë ballë ndonjë tronditjeje të supozuar të likuiditetit, të konsideruar në skenarë hipotetik.

Reflektimi i krizës globale në ekonominë e Kosovës ndikoi negativisht cilësinë e portofolit kreditor të sektorit bankar. Në qershor 2010, kreditë joperformuese përfaqësuan 4.5 përqind të gjithsej kredive, krahasuar me 3.9 përqind në qershor 2009. Devijimi i cilësisë kryesisht u vërejt te kreditë e lëshuara për ndërmarrjet, të cilat edhe përfaqësojnë pjesën më të madhe të kredive joperformuese. Me gjithë rritjen, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara nga provizionet për humbje nga kreditë me një normë prej 130 përqind. Sektori bankar i Kosovës po ashtu ka një nivel të lartë të kapitalizimit, gjë që e zvogëlon rrezikun e solvencës së sektorit nga devijimi i cilësisë së portofolit kreditor ose nga zhvillime tjera të disfavorshme siç mund të jetë zvogëlimi i normave të interesit. Në qershor 2010, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në 18.7 përqind, përderisa minimumi i kërkuar nga Banka Qendrore për këtë tregues është 12 përqind. Aftësia e sektorit bankar për të ruajtur solventitetin kundrejt rritjes së kredive joperformuese, rënies së normave të interesit dhe zhvlerësimit të valutës euro është vlerësuar edhe përmes 'Stress-Testit', ku rezultatet sugjerojnë një nivel mjaft të lartë të qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj tronditjeve të supozuara në një skenar hipotetik.

Ky numër i Raportit të Stabilitetit Financiar po ashtu përmban disa analiza tematike, të cilat trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me efikasitetin dhe stabilitetin e sektorit bankar. Së pari, është paraqitur një analizë që mbi stabilitetin financiar dhe rritjen ekonomike në vendet e EJK-së, që konstaton se këto vende karakterizohen nga sektorë të qëndrueshëm financiarë, por duke theksuar potencialin për rritje më të lartë ekonomike, e cila mund të arrihet kryesisht me avancimin e kornizës institucionale. Së dyti, raporti prezenton një analizë mbi zbrëthimin e kostos së ndërmjetësimit financiar, ku është gjetur se shpenzimet operative dhe shpenzimet e rrezikut përfaqësojnë kontribuuesit më të mëdhenj në koston e ndërmjetësimit në Kosovë, ndryshe nga vendet e tjera në rajon, ku kostot e financimit përfaqësojnë komponentin më të madh të koston së ndërmjetësimit. Së treti, për të vlerësuar zbatimin e të drejtave të kreditorëve në Kosovë, BQK-ja zhvilloi një anketë me katër bankat komerciale më të mëdha në vend. Rezultatet nga anketa tregojnë se Kosova krahasohet mirë me ekonomitë tjera në tranzicion për sa i përket zbatimit të të drejtave të kreditorëve, por procesi i zbatimit ende vuan nga joefikasiteti, gjë që prolongon zbatimin e kontratave. Së fundi, është trajtuar problematika e qasjes së ndërmarrjeve në financa në Kosovë, bazuar në të dhënat nga anketa Business Environment and Enterprise Performance Survey e EBRD-së. Të dhënat nga kjo anketë sugjerojnë se qasja në financa në Kosovë nuk duket të jetë një pengesë substanciale për zhvillimin e biznesit në krahasim me pengesa të tjera, por nga ana tjetër, Kosova duket të jetë vendi me nivelin më të ulët të qasjes së firmave në financa.

### 3. Zhvillimet Makroekonomike dhe Financiare në Ekonominë Globale

Kriza financiare e shkaktuar nga kolapsi i tregjeve të patundshmërive në SHBA pati ndikim të madh në ekonominë botërore. Shumë vende u përfshinë nga recesioni, ndërsa në disa vende rritja ekonomike u ngadalësua shumë. Si rrjedhojë e krizës financiare, qeveritë e shumë vendeve u detyruan të rrisin shpenzimet publike për të stimuluar aktivitetin ekonomik ndërsa bankat qendrore aplikuan politika monetare ekspansioniste. Masat e ndërmarra kishin ndikim substancial në zbutjen e efekteve të krizës, duke kompensuar rënien e aktivitetit në sektorin privat me rritjen e pjesëmarrjes së sektorit publik në ekonomi.

Politikat monetare ishin mjaft ekspansioniste, ku në shumë vende normat e interesit u zvogëluan në nivel rekord. Veç kësaj, bankat qendrore u detyruan të injektojnë shuma të mëdha të mjeteve në sistemin financiar me qëllim që të përmirësohet pozita e likuiditetit. Gjatë kësaj periudhe, disa banka përdorën metoda të cilat nuk ishin përdorur më herët. Në këtë kontekst mund të veçojmë Bankën Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank: ECB), e cila për herë të parë u detyrua të blej fletëobligacione në tregjet financiare. Si rrjedhojë e këtyre intervenimeve, bilanci i gjendjes së bankave qendrore shënoi rritje, duke krijuar rreziqe potenciale për rritje spekulative të aseteve.

Në rrafshin fiskal, intervenimet qeveritare ishin vendimtare në parandalimin e krizës, mirëpo shumë vende u përballën me përkeqësim të financave publike. Si rezultat i këtyre intervenimeve, deficitit buxhetor në nivel botëror u ngrit në 9 përqind të PBB-së. Sipas projeksioneve të FMN-së, në vitin 2014, raporti ndërmjet borxhit publik dhe PBB-së në nivel botëror do të tejkalojë nivelin prej 100 përqind dhe do të jetë për 35 pp më i lartë se sa që ishte para se të fillonte kriza.

Sipas parashikimeve të FMN-së, gjatë vitit 2010 ekonomia botërore do të rritet për 4.25 përqind (Tabela 1). Ky parashikim është për 1pp më i lartë në krahasim me parashikimet e FMN-së në fund të vitit 2009. Parashikimet më të larta për rritjen ekonomike janë rezultat i disa zhvillimeve ekonomike gjatë vitit 2010, të cilat ndikuan në pritje më optimiste për performancën e ekonomisë gjatë vitit. Përmirësimi i tregjeve financiare gjatë vitit 2010 i tejkaloi parashikimet. Kreditimi i ekonomive po stabilizohet si dhe te ardhurat dhe konsumi i ekonomive familjare janë duke shënuar rritje. Zhvillime pozitive vërehen edhe në prodhimtarinë industriale dhe tregtinë në nivel botëror.

Edhe pse ekonomia globale pritet të ketë rritje pozitive, kjo rritje nuk do të jetë i balancuar ndërmjet vendeve. Vendet e zhvilluara do të vazhdojnë të përballen me rritje të ngadalshme ekonomike, të karakterizuara me deficit të lartë buxhetor dhe tregtar. Sipas FMN-së, rritja ekonomike gjatë vitit 2010 në vendet e zhvilluara pritet të jetë 2.3 përqind. Ndër vendet e zhvilluara, rritjen më të lartë pritet ta ketë SHBA (3.1 përqind), ndërsa Japonia dhe vendet e eurozonës pritet të kenë rritje prej 1.9, përkatësisht 1.0 përqind.



Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së botërore, në përqindje

Përshkrimi	2009	2010	2011
PBB-ja Botërore	-0.6	4.25	4.3
Vendet e zhvilluara	-3.2	2.3	2.4
SHBA	-2.4	3.1	2.6
Eurozona	-4.1	1.0	1.5
Japonia	-5.2	1.9	2
Mbretëria e Bashkuar	-4.9	1.3	2.5
Vendet në zhvillim	2.4	6.3	6.5
Rusia	-7.9	4.0	3.3
Kina	8.7	10.0	9.9
India	5.7	8.8	8.4

Burimi: FMN (2010a)

Vendet në zhvillim, veçanërisht Kina dhe India, do të vazhdojnë të kenë rritje të lartë ekonomike, e cila bazohet kryesisht në rritjen e eksporteve si rezultat i valutave të nënvlerësuara të këtyre vendeve. Për vitin 2010, FMN-ja parasheh që ekonomia e vendeve në zhvillim të rritet me mesatarisht 6.3 përqind. Rritjen më të lartë pritet ta regjistrojë Kina me 10 përqind, pasuar nga India me 8.8 përqind. Në këto vende, përveç përmirësimit të tregtisë globale, rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike ka pasur edhe rritja e kërkesës së brendshme.

Shpenzimet e mëdha publike të cilat u evidentuan gjatë krizës ndikuan në rritjen e deficitit buxhetor. Sipas të dhënave të FMN-së, borxhi në raport me PBB-në për vendet e grupit G7 ka arritur nivelin më të lartë në 60 vitet e fundit. Ky nivel i lartë i borxhit publik ndikon edhe në fleksibilitetin e këtyre qeverive për të reaguar në rast të përkeqësimit të situatës ekonomike. Problemet me deficit buxhetor janë më të theksuara në vendet e eurozonës. Greqia si vendi me problemet më të theksuara u detyrua të kërkojë përkrahje financiare nga FMN-ja dhe vendet tjera të Eurozonës. Si rezultat i përkeqësimit të pozitës fiskale, vendet e BE-së u përcaktuan për themelimin e një mekanizmi për Stabilitetin Financiar Evropian. Në mënyrë që ky mekanizëm të jetë funksional, FMN-ja dhe vendet e BE-së ndan një shumë prej 750 miliardë euro. Këto mjete në rast nevojë do të përdoren për t'i tejkaluar krizat e mundshme në lidhje me deficitin buxhetor.


Shumica e ekonomive të vendeve të zhvilluara janë duke operuar nën kapacitetet e mundshme, gjë që ka ndikuar në shkallë të ulët të inflacionit, ndërsa parashikimet sugjerojnë për shkallë të ulët të inflacionit edhe në të ardhmen e afërt. Veç kësaj, në disa vende të zhvilluara, rënia e aktivitetit ekonomik ka rezultuar në deflacion. Deri në qershor 2010, shkalla vjetore e inflacionit në SHBA ishte 1.1 përqind, dhe është me e ulët në krahasim me vitin 2009 kur ishte 2 përqind. Sipas të dhënave të publikuara nga EUROSTAT-i, shkalla vjetore e inflacionit për vendet e eurozonës në qershor 2010 ishte 1.4 përqind. Sa i përket normave të interesit, shumica e bankave qendrore të ekonomive të

zhvilluara nuk ndryshuan normat e interesit, përfshirë FED-in dhe ECB-në, ku normat bazë mbetën në 0.25 përkatësisht 1.0 përqind.

Përmirësimet në sektorin real të ekonomisë u reflektuan edhe në sistemin financiar global. Gjatë vitit 2010, shumica e indikatorëve në tregjet financiare (bursat, tregjet e parasë) shënuan përmirësim të performancës. Kjo rezultoi në kthimin e besimit tek investitorët dhe uljes së luhatshmërisë së tregjeve financiare, gjë e cila ishte mjaft evidente në vitet paraprake. Veprimet për mbështetje të likuiditetit, lehtësim të politikave kreditore si dhe garancionet qeveritare ndikuan mjaft pozitivisht në përmirësimin dhe rritjen e aktivitetit në tregjet monetare dhe të aksioneve. Këto zhvillime ndikuan në ngadalësimin dhe zbutjen e efekteve negative të krizës financiare.


Mirëpo, risku mbetet evident; prandaj, nevojitet vazhdimësi e politikave stimuluese nga bankat qendrore për të evituar rënien e aktivitetit ekonomik dhe kthimin e pasigurisë në tregjet financiare. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të borxhit publik në shumë vende të zhvilluara, sidomos brenda Eurozonës, hapësira për veprim është shumë e ngushtë. Kjo rritje e borxhit publik u manifestua me përkeqësim të rejtingut të shteteve gjë që u reflektua me rritjen e premive për letrat me vlerë të emetuara nga institucione publike. Sidoqoftë, vështirësitë fiskale mund të kenë efekte përcjellëse në sistemin bankar. Së pari, duke pasur parasysh se bankat komerciale investojnë fonde të konsiderueshme në fletëobligacionet qeveritare, dështimi i qeverive për të paguar detyrimet e tyre do të shkaktonte humbje të konsiderueshme për bankat. Së dyti, rejtingu i shteteve ka ndikim substancial edhe për koston e financimit për sektorin privat. Përkeqësimi i rejtingut për shtetet rritë koston e financimit të jashtëm për bankat komerciale dhe mund të ketë implikime negative për stabilitetin e sektorit bankar në përgjithësi. Një nga vendet që po e përjeton një skenar të tillë është Greqia, ku pozita e dobët fiskale, ka ndikuar në uljen e rejtingut shtetëror dhe rritjen e koston të financimit si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Përderisa aktiviteti ekonomik po shënon rritje, kredidhënia vazhdon të jetë më e ulët se para fillimit të krizës në shumë vende të zhvilluara. Përyjashtim janë vendet aziatike, ku kredidhënia vazhdimisht ka shënuar rritje. Në disa vende, siç është Kina, autoritetet rregullative kanë ndërmarrë masa shtrënguese për ngadalësimin e kreditimit, në mënyrë që të evitojnë

Figura 1. Normat e interesit EURIBOR dhe LIBOR



Burimi: Datastream

Figura 2. Ndryshimi vjetor i indeksave të tri bursave më të mëdha



Burimi: Datastream

ndonjë rritje spekulative të aseteve. Rritja e shpejtë ekonomike në vendet në zhvillim ishte faktor kyç për rritjen e fluksit të kapitalit si dhe për kthimin e besimit të investitorët në këto vende. Përkundër fluksit të lartë të kapitalit, valutat e vendeve të zhvilluara, sidomos Kinës, vazhdojnë të jenë të nënvlersuara në krahasim me vendet e zhvilluara.

Gjatë vitit 2009, aktiviteti kredidhënës në vendet e zhvilluara ka shënuar rënie, ndërsa, në fillim të vitit 2010, cikli i kredidhënies ka filluar të shfaqë shenjat e para të rikuperimit. Gjatë kësaj periudhe, rritje e aktivitetit është vënë re edhe në tregjet e fletëobligacioneve. Ky zhvillim i atribuohet faktit se rritja e kreditimit nga bankat është ende e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e financimit të ndërmarrjeve, të cilat rrjedhimisht i janë drejtuar tregjeve të fletëobligacioneve. Ky trend është më i theksuar sidomos në SHBA, ku fletëobligacionet janë përdorur gjerësisht si një burim financimit. Në vendet e eurozonës, fletëobligacionet përfaqësojnë një burim më pak të rëndësishëm të financave ndërsa kreditë bankare kanë një përdorim shumë më të gjerë.


Me përmirësimin e aktivitetit ekonomik humbjet e sistemit bankar në shumë vende u zvogëluan. Sipas parashikimeve të FMN-së, humbjet potenciale që nga fillimi i krizës deri në fund të vitit u zvogëluan nga 2.8 trilionë dollarë në 2.3 trilionë dollarë. Ndërsa gjatë kësaj periudhe humbjet e realizuara ishin 1.5 trilionë dollarë (Tabela 2; shih Kutinë 1 për performancën e grupeve bankare që operojnë në Kosovë).

### Kutia 1. Performanca e grupeve bankare të cilat operojnë në Kosovë <sup>1</sup>

Gjatë vitit 2009, ekonomia botërore vazhdoi të përballej me pasojat e krizës financiare. Në vitin 2009, sistemet bankare në vendet ku operojnë grupet bankare që kanë banka vartëse në Kosovë u karakterizuan me ngadalësim të rritjes, vështirësi në sigurimin e financimit si dhe përkeqësim të cilësisë së portfolit. Gjatë kësaj periudhe të gjitha bankat zhvendosën vëmendjen nga rritja e operacioneve bankare drejtë menaxhimit të krizës financiare. Treguesit e performancës për vitin 2009 shënuan rënie për të gjitha grupet bankare të përfshira në këtë analizë. Kontribuuesit kryesor në rënie e performancës ishin rritja e shpenzimeve për provizione për humbjet nga kreditë që i atribuohet përkeqësimit të portfolit kreditor.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, rritja e aktivitetit ekonomik në nivel botëror në përgjithësi ndikoi në përmirësimin e performancës së sektorit bankar. Kriza financiare ndiko që bankat të jenë më konservative në menaxhimin e aseteve. Në këtë periudhë bankat u fokusuan në përmirësimin e cilësisë së portfolios dhe si rezultat u aplikuan kritere më të shtrenguara për sa i përket zgjerimit të aktivitetit kredidhënës. Sidoqoftë, performanca e grupeve bankare që operojnë në Kosovë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 ishte e ndryshme. Përdërisa Raiffeisen International shënoi rritje të profitit në krahasim me vitin 2009, Procredit Group dhe NLB Group shënuan humbje.

Figura 3. Kthimi ndaj kapitalit për grupet bankare, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të bankave

<sup>1</sup> Grupet bankare të përfshira në analizë janë: Procredit Group, Raiffeisen International and NLB Group.

### Procredit Group (Gjermani)

Në fund të vitit 2009, të ardhurat nga interesi për Procredit Group (PCB) shënuan një rënie prej 5.8 përqind krahasuar me vitin 2008. Rënia e kësaj kategorie të të ardhurave kryesisht i atribuohet ngushtimit të margjinës së interesit në 7.9 përqind, që paraqet një rënie prej 2.2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2008.<sup>2</sup> Ndërsa, të ardhurat nga shërbimet tjera bankare shënuan rritje prej 3.8 përqind krahasuar me 2008.<sup>3</sup> Si rezultat i zvogëlimit të ardhurave gjatë vitit 2009, PCB Group ndërmori masa për reduktimin e shpenzimeve. Me gjithë se kishte racionalizim të shpenzimeve, raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave shënoi një ngritje prej 1pp duke arritur në 81.7 përqind, që kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve për provizionim të kredive të këqija, të cilat arritën në 111.7 milionë euro krahasuar me 98.2 milion euro në 2008. Profiti neto në vitin 2009 u zvogëlua në 11.5 milionë euro nga 30.0 milionë euro në vitin 2008, ndërsa kthimi në kapital (angl. Return on Equity: ROE) para tatimit u zvogëlua në 3.8 përqind (8.4 përqind në vitin 2008). Kjo rënie kryesisht pasqyron rritjen e shpenzimeve për provizione dhe rënien e të ardhurave operative.


Performanca e PCB Group shënoi rënie të mëtutjeshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Të ardhurat neto nga interesi shënuan rënie prej 2.1 përqind, ndërsa të ardhurat nga shërbimet tjera bankare u rritën me 5.9 përqind. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet operative shënuan rënie me 2.7 përqind, por ende ishin më të larta se sa të ardhurat operative. Rrjedhimisht, në gjysmën e parë të vitit 2010, PCB Group raportoi humbje që arrinin vlerën prej 5.1 milionë euro kundrejt fitimit prej 2.7 milionë euro që kishte regjistruar gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Ndikim negativ në fitim

kishte edhe rritja e shpenzimeve për provizione nga 111.6 milionë euro në qershor 2009 në 125.1 milionë euro në qershor 2010. Në qershor 2010, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR) për PCB Group ishte 16.2 përqind, që tregon një nivel të kënaqshëm të kapitalizimit. Në qershor 2010, ProCredit në Kosovë përbënte 5.5 përqind të gjithsej asetëve të PCB Group.

### Raiffeisen International (Austri)

Gjatë vitit 2009, Raiffeisen International (RI) ka shënuar një fitim pozitiv, pavarësisht kushteve të vështira si pasojë e krizës financiare. Të ardhurat neto nga interesi në vitin 2009 shënuan rënie prej 9 përqind në krahasim me vitin 2008. Rënia e të ardhurave i atribuohet zvogëlimit të ndërmjetësimit dhe mbi të gjitha zvogëlimit të margjinës së interesit me 0.26 pp, duke rënë në 3.73 përqind. Gjithashtu, të ardhurat nga shërbimet bankare shënuan rënie prej 18 përqind krahasuar me vitin 2008. Rënia e të ardhurave u shoqërua edhe me reduktim në anën e shpenzimeve të përgjithshme. RI ndërmori masa për të zvogëluar shpenzimet, të cilat shënuan rënie prej 14 përqind krahasuar me 2008. Këto masa kanë çuar në zvogëlimin e raportit ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhura në 52.5 përqind, që është për 1.5 pp më i ulët në krahasim me vitin 2008. Kriza shkaktoi përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor, gjë që çoi në një rritje prej 123 përqind në shpenzimet e provizionimit për humbje nga kreditë, të cilat arritën në 1.738 miliardë euro. Ky zhvillim në mënyrë të konsiderueshme ka ndikuar në zvogëlimin e fitimit neto, që në vitin 2009 ishte 287 milionë euro ose

Figura 4. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave për grupet bankare, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të bankave

<sup>2</sup> Margjina e interesit paraqet dallimin ndërmjet normave të interesit për kredi dhe depozita.

<sup>3</sup> Të ardhurat nga shërbimet tjera bankare përfshijnë tarifën për transfere dhe shërbimet tjera bankare.

për 73.4 për qind më i ulët se në vitin 2008. Performanca më e dobët ka ndikuar në rënien e ROE para tatimit për 5.7 për qind (22.0 për qind në vitin 2008).

Në gjysmën e parë të vitit 2010, të ardhurat neto nga interesi shënuan rënie prej 4 për qind, si rezultat i rritjes së kostos së financimit, ndërsa shpenzimet për provizione shënuan rënie prej 42 për qind si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor dhe ristrukturimit të kredive. Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave ishte 57.6 për qind në qershor 2010 ose për 6 pp më i lartë se sa në qershor 2009. Profiti neto në gjysmën e parë të vitit 2010 u ngrit në 171 milionë euro, që paraqet një dyfishim krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Rritja e profitit neto ka pasur një ndikim pozitiv në rritjen e ROE para tatimit, e cila u ngrit në 8.6 për qind nga 4.9 për qind sa ishte në qershor 2009. Gjatë kësaj periudhe, RI kishte një tregues të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 11 për qind. Në qershor 2010, Raiffeisen Bank Kosovo përbënte 0.85 për qind të gjithsej aseteve të Raiffeisen International.

### **NLB Group (Slloveni)**

Në fund të vitit 2009, të ardhurat neto nga interesi për NLB Group shënuan një rënie vjetore prej 11 për qind. Gjithashtu, të ardhurat nga shërbimet bankare shënuan një rënie prej 5.0 për qind. Kostoja më e lartë e financimit në tregjet financiare u reflektua në zvogëlimin e margjinës së interesit në 2.3 për qind, që paraqet një rënie prej 0.3 pp në krahasim me vitin 2008. Zvogëlimi i margjinës së interesit ka pasur ndikim të rëndësishëm në zvogëlimin e të ardhurave. Si pasojë, NLB Group mori masa për të zvogëluar shpenzimet e përgjithshme, të cilat rezultuan me një rënie prej rreth 1 për qind në krahasim me vitin 2008. Megjithatë, rezultatet e pafavorshme në vitin 2009 shkaktuan rritjen e raportit ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave në 65.2 për qind, që është për 1.5 pp më i lartë në krahasim me vitin 2008. Shpenzimet për provizionet arritën në 315.5 milion euro që është një rritje prej 49 për qind në krahasim me vitin e kaluar. NLB Group përfundoi vitin 2009 me humbje në shumën prej 85.9 milion euro, duke shënuar një rënie të konsiderueshme të performancës krahasuar me vitin 2008, kur profiti neto ishte 22.8 milion euro. Në vitin 2009, ROE para tatimit u zvogëlua në -6.6 për qind nga 3.1 për qind në vitin 2009.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, NLB Group vazhdoi të përballet me vështirësitë e krizës financiare. Gjatë kësaj periudhe, të ardhurat neto nga interesi u rritën me 10.2 për qind, ndërsa të ardhurat nga shërbimet bankare shënuan rënie prej 21 për qind. Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave në qershor të vitit 2010 qëndroi në 63.5 për qind, që është për 1.3 pp më i ulët krahasuar me qershor 2009. Shpenzimet për provizione arritën vlerën prej 159.1 milion euro nga 114.8 milion euro në qershor 2009. Në gjysmën e parë të vitit 2010, NLB Group regjistroi humbje (pas tatimit) në vlerë vlerë prej 34.6 milion euro, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kishte shënuar humbje prej 5.6 milion euro. Në qershor 2010, ROE (para tatimit) për NLB Group ishte -6.6 për qind, krahasuar me 1.1 për qind në qershor 2009. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2010, NLB Group kishte një CAR prej 10.6 për qind ose 0.1 për qind më të ulët në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009. Në qershor 2010, NLB Prishtina përfaqësonte 1.58 për qind të gjithsej aseteve të NLB Group.

Zvogëlimi i humbjeve ndikon edhe në zvogëlimin e kërkesës së bankave për kapital shtesë, që paraqet një zhvillim pozitiv për shumë vende, duke marrë parasysh shumën e fondeve që janë injektuar në forme të kapitalit. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik ka ndikuar edhe në përmirësimin e cilësisë së portfolios së kredisë në shumë vende të zhvilluara. Në Eurozonë, rritja ekonomike ka ndikuar në zvogëlimin e humbjeve të bankave nga kreditë joperformuese. Përmirësimi i portfolios së kredisë është raportuar edhe në Mbretërinë e Bashkuar, sidomos për sa i përket kategorive të patundshmërive private dhe komerciale. Ndërsa, në SHBA norma e lartë e papunësisë po ndikon në rritjen e mëtejshme të kredive joperformuese, sidomos për kreditë e lëshuara për sektorin e patundshmërisë.

**Tabela 2. Gjithsej humbjet e raportuara dhe kapitali shtesë për bankat, në miliard USD**

Përshkrimi	Gjithsej humbjet e raportuara	Vlera e rritjes së kapitalit	Kapitali i klasit të parë/ RWA në %
SHBA	680	329	11.3
Eurozona	415	256	9.1
Mbretëria e Bashkuar	355	222	11.5

Burimi: FMN (2010b)

Raportet e mjaftushmërisë së kapitalit po ashtu janë përmirësuar, që nga kulmi i krizës në fund të vitit 2008. Sipas të dhënave të FMN-së, bankat në SHBA kanë rritur treguesin e mjaftushmërisë së kapitalit për 1.5pp, duke e ngritur në 11.3 përqind. Në eurozonë ky tregues është rritur për 1.1pp, duke arritur në 9.1 përqind, ndërsa në MB nga 10.2 përqind është ngritur në 11.5 përqind. Rritja e kapitalit kryesisht ka ndodhur përmes injektimit të kapitalit nga ana e investitorëve si dhe nga normat pozitive të fitimit. Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar, një pjesë e madhe e bankave në SHBA dhe Evropë iu nënshtruan stres-testit, rezultatet e të cilit sugjerojnë se pjesa më e madhe e bankave ishin në gjendje të përballojnë një valë të re të krizës pa pasur nevojë për kapital shtesë.

### 3.1. Zhvillimet ekonomike në Evropën Juglindore

Aktiviteti ekonomik në vendet e Evropës Juglindore në gjysmën e parë të vitit 2010 ka treguar shenja për një përmirësim të moderuar. Rritja e kërkesës botërore gjatë kësaj periudhe ndikoi në rritjen e eksporteve të vendeve të EJL-së, duke mundësuar rimëkëmbjen e tyre ekonomike. Megjithatë, kërkesa e brendshme e vendeve të rajonit mbetet e ulët, duke u reflektuar në rritjen e papunësisë dhe shtrëngimin e kredidhënies. Përderisa pjesa më e madhe e vendeve të EJL-së janë karakterizuar me zhvillime pozitive ekonomike gjatë vitit 2010, Kroacia dhe Mali i Zi raportuan tkurrje ekonomike. Sipas parashikimeve të fundit të FMN-së, përpos Kroacisë dhe Malit të Zi, të gjitha vendet e EJL priten të karakterizohen me ritme pozitive të rritjes. Shkalla më e lartë e rritjes pritet të regjistrohet në Kosovë (4.6 përqind), pasuar nga Shqipëria (2.6 përqind), Serbia (1.5 përqind) dhe Maqedonia (1.2 përqind), përderisa Bosnja dhe Hercegovina pritet të ketë rritje modeste prej 0.5 përqind.

Përmirësimi i performancës së eksporteve dhe rënia e importeve gjatë vitit 2010 ndikuan në rënien e mëtejshme të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vendet e EJL. Parashikimet e FMN-së për vitin 2010 raportojnë normën më të ulët të deficitit të llogarisë rrjedhëse në Kroaci (3.8 përqind), Maqedoni (3.9 përqind) dhe Bosnje e Hercegovinë (5.5 përqind). Deficiti i llogarisë rrjedhëse pritet të mbetet i lartë në Kosovë (18.5 përqind), Mal të Zi (17.0 përqind), Serbi (9.6 përqind) dhe Shqipëri (9.2 përqind).

Të gjitha vendet e EJL-së e përfunduan vitin 2009 me bilanc negativ buxhetor, përderisa parashikimet e FMN-së sugjerojnë se vendet me deficitin më të lartë buxhetor në vitin 2010 do të jenë Mali i Zi me 7.1 përqind të PBB-së, dhe Bosnja dhe Hercegovina dhe Bullgaria me 4.9 përqind të PBB-së, respektivisht. Disa vende si Serbia, Kroacia dhe Kosova pritet të përballen me deficit më të lartë buxhetor në vitin 2010 krahasuar me vitin e kaluar.

Deficiti buxhetor si pjesëmarrje e PBB-së në Sërbi pritet të arrijë në 4,8 përqind, në Kroaci në 4.7 përqind dhe në Kosovë në 3.4 përqind. Maqedonia pritet të jetë vendi me deficitin më të ulët buxhetor në rajon (2.5 përqind të PBB-së në 2010). Në mënyrë që të tejkalojnë problemet e potenciale lidhur me deficitin buxhetor, në shkurt të vitit 2010, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Rumania kanë hyrë në marrëveshje me FMN për të siguruar mbështetje financiare nga ky institucion.

Rënia ekonomike në vitin 2009 pati ndikim të madh në rritjen e papunësisë në vendet e EJL-së. Rritja e normës së papunësisë në këto vende ka vazhduar edhe gjatë gjysmës së parë të 2010. Vendet e EJL-së që vazhduan të karakterizohen me normë të lartë të papunësisë mbeten Kosova (rreth 45 për qind), pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina (rreth 43.1 përqind) dhe Maqedonia (rreth 32.1 për qind).

Sa i përket kursit të këmbimit mes valutave të vendeve të vendeve të EJL-së dhe euros, leku shqiptar u vlerësua kundrejt euros me 1.8 për qind në qershor 2010, duke arritur në 136.07 lekë/euro, ndërsa dinari serb u zhvlerësua ndaj euros me 4.2 për qind, duke arritur në 104.70 dinar/euro. Kuna kroate (7.21 HKR/euro), dhe denari i Maqedonisë (61.52 den/euro), ishin më të qëndrueshme ndaj monedhës së euros gjatë kësaj periudhe. Rritja e çmimeve në eurozonë u reflektuan edhe në nivelin e çmimeve në EJL, ku normat e inflacionit në shumicën e vendeve ishin më të larta në tremujorin e dytë krahasuar me tremujorin e parë. Serbia dhe Shqipëria gjatë këtij tremujori kanë shënuar shkallën më të lartë të inflacionit vjetor (4.3 dhe 4.2 për qind, respektivisht), ndërsa Maqedonia dhe Mali i Zi ka shënuar nivelin më të ulët vjetor të inflacionit në këtë periudhë (0.5 dhe 0.8 përqind, respektivisht).

Përderisa në vitin 2009, sektori bankar në disa prej vendeve të EJL-së u karakterizua kryesisht me shtrëngim të kredidhënies dhe tërheqje të depozitave, gjysma e parë e vitit 2010 tregoi për një rritje të besimit në sektorin bankar. Edhe pse në shkallë të moderuar, norma e rritjes së depozitave dhe kredive ka shënuar rritje në disa nga vendet e rajonit, duke treguar për përmirësimin e vazhdueshëm të sektorit bankar në rajon. Vendet me rritjen më të lartë të kredisë në qershor 2010 kanë qenë Serbia (26.2 për qind), Kosova (9.7 përqind) dhe Shqipëria (8.5 përqind), ndërkohë që vendet që kanë raportuar rritje negative të kredisë kanë qenë Mali i Zi (11.4 për qind) dhe Bosnja dhe Hercegovina (2.0 përqind). Sa i përket depozitave, në tremujorin e dytë të vitit 2010, Serbia ka udhëhequr me normën më të lartë të rritjes në rajon (22,5 përqind), pasuar nga Kosova (15.8 për qind), Shqipëria (14.8 përqind) dhe Maqedonia (14.4 për qind). Sektori bankar në pjesën më të madhe të vendeve të EJL-së në tremujorin e dytë 2010 ishte profitabil, me përjashtim të Maqedonisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës që u karakterizuan me humbje. Krahasuar me tremujorin e parë 2010, cilësia e kredive në vitin 2010 është përkeqësuar në pothuajse të gjitha vendet e EJL-së. Nga vendet e rajonit, Mali i Zi e kishte shkallën më të lartë të kredive joperformuese prej 16.8 përqind (14.6 përqind në tremujorin e parë 2010), pasuar nga Shqipëria me 12.0 për qind (11.5 përqind në tremujorin e parë 2010), Serbia 12.0 për qind (10.6 përqind tremujorin e parë 2010) dhe Bosnja dhe Hercegovina 8.7 për qind (7.1 për qind në tremujorin e parë 2010). Kosova mbetet vendi me nivelin më të ulët të kredive joperformuese në rajon me 4.5 përqind në qershor 2010 (4.6 përqind në tremujorin e parë 2010).


## 4. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë

Stabiliteti makroekonomik vazhdoi të karakterizonte ekonominë e Kosovës edhe gjatë periudhës 2008-2009, përkundër tronditjeve të shkaktuara nga kriza globale. Me gjithë se me normë të moderuar, ekonomia e Kosovës ka realizuar norma pozitive të rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe. Rritja e vazhdueshme e shkallës së ndërmjetësimit financiar në vend si dhe dërgesat e emigrantëve kanë paraqitur burime të rëndësishme të financimit për konsumin dhe investimet e sektorit privat, me gjithë ndikimin negativ të krizës globale në këto kanale të financimit. Euroizimi i ekonomisë që nga viti 2002 ka minimizuar rrezikun e normës së këmbimit në ekonominë e vendit si dhe ka siguruar stabilitet të çmimeve. Diskrecioni i kufizuar i politikës fiskale, si pasojë e euroizimit, si dhe mungesa e ligjit për borxh publik deri në vitin 2009, si rezultat i statusit të pazgjidhur politik të vendit, kushtëzuan që politikat fiskale të jenë më të shtrënguara. Këto politika bënë që Buxheti i Kosovës në periudhën më të madhe të kohës të ketë tepriçë ose nivele të ulëta të deficitit, duke siguruar kështu stabilitet të financave publike në vend. Sidoqoftë, shkalla e ulët e prodhimit vendor dhe, si pasojë, mbështetja e lartë e ekonomisë në importe kanë bërë që Kosova në vazhdimësi të ketë deficit të lartë të llogarisë rrjedhëse. Sfidë e vazhdueshme për ekonominë e Kosovës vazhdon të jetë norma e lartë e papunësisë, e cila paraqet nevojën për normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe gjenerim më të madh të vendeve të punës dhe absorbimit të fuqisë punëtore e cila karakterizohet me një normë të lartë të rritjes.

Kosova, si një ekonomi e vogël dhe e hapur, po ashtu u ndikua nga kriza globale e cila në masën më të madhe evuloi në vitin 2008 dhe 2009. Kanalet kryesore përmes të cilave kriza u reflektua në ekonominë e Kosovës janë të hyrat nga jashtë, kryesisht dërgesat e emigrantëve dhe investimet e huaja direkte, të cilat u zvogëluan gjatë kësaj periudhe për 5.5 përkatësisht 23.3 përqind. Po ashtu, rënia e eksporteve, të cilat edhe ashtu kishin nivel të ulët, ndikoi negativisht aktivitetin ekonomik në vend. E tërë kjo ngriti pasigurinë rreth performancës së sektorit real të vendit, gjë që shtyri bankat komerciale të shtrëngojnë kredhënien si formë preventive

ndaj efekteve të mundshme negative që do të mund të reflektoheshin nga sektori real në portfoliot kreditore të bankave komerciale. Kjo sforcioi edhe më tepër efektin e rënies së të hyrave nga jashtë mbi konsumin dhe investimet e sektorit privat. Mirëpo, duhet të ceket se gjatë vitit 2009 u ndërморën disa ndryshime në politikat fiskale të cilat kontribuan në zvogëlimin e efekteve të krizës. Kontributi i politikës fiskale në zbutje të krizës ekonomike mund ti atribuohet rritjes së shpenzimeve publike të cilat edhe konsiderohen si bartës kryesor të rritjes ekonomike për vitin 2009. Përveç kësaj, ulja e tatimit mbi korporatat gjithashtu mund të ketë stimuluar investimet të cilat në vitin 2009 janë rritur në masë të konsiderueshme. Në anën tjetër, zvogëlimi i normës së tatimit në të ardhurat personale

Figura 5. Rritja reale e PBB-së



Burimi: FMN (2010c), dhe ESK (2010a)




mund të ketë minimizuar efektet negative të krizës në konsumin e përgjithshëm në Kosovë, mirepo, rritja e TVSH-se mund të ketë menjanuar deri në një masë efektin e zvogelimit të normës tatimore në të ardhurat personale duke bërë presion në nivelin e përgjithshëm të çmimeve

Bazuar në të dhënat e ESK-së, konsumi gjatë vitit 2009 shënoi rënie në terma nominal, mirepo, si rezultat i deflacionin, në terma real konsumi shënoi rritje krahasuar me vitin paraprak. Në anën tjetër, investimet gjatë vitit 2009 shënuan rritje në terma real. Prandaj, rritja ekonomike gjatë vitit 2009 ishte pozitive krahasuar me vitin paraprak në normën prej 2.9 përqind bazuar në vlerësimet e ESK-së, ndërsa, vlerësimet e FMN-së tregojnë për normë reale të rritjes ekonomike prej 3.8 përqind (Figura 5).

Fillimi i rikuperimit të ekonomive të vendeve të zhvilluara nga kriza ka filluar të reflektohet edhe në ekonominë e Kosovës, ku vërehen zhvillime pozitive për sa i përket konsumit dhe investimeve. Në këtë kontekst, në gjashtëmuorin e parë të vitit është vërejtur rritje e dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja direkte, përderisa eksportet janë dyfishuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo ka ndikuar që edhe bankat komerciale të përmirësojnë perceptimet mbi ambientin afarist në vend, duke filluar kështu rritjes graduale të kredidhënies. Po ashtu, rritja e vazhdueshme e shpenzimeve publike paraqet një kontribues të rëndësishëm për ngritjen e konsumit dhe investimeve në vend. Rrjedhimisht, rritja reale e PBB-së gjatë vitit 2010 është parashikuar të arrijë në 4.6 përqind sipas projeksioneve të FMN-së, ndërsa MEF parashikon rritje reale prej 4.8 përqind (IMF, 2010; MEF, 2010).

Çmimet gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 mund të konsiderohen stabile (Figura 6). Rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit deri në qershor 2010 ishte 2.2 përqind, edhe pse mesatarja vjetore vazhdon të jetë në deflacion prej 0.4 përqind. Ndikimin më të madh në nivelin e përgjithshëm të çmimeve gjatë gjashtëmuorit të parë 2010 kishin çmimet e produkteve ushqimore dhe të shërbimeve të transportit personal, të ndikuara nga çmimet e karburanteve në tregjet ndërkombëtare. Ndikimi i madh i çmimeve të importit në njërën anë dhe mungesa e instrumentet të politikës monetare në vend si pasojë e euroizimit, bëjnë që autoritetet vendore të mos kenë mundësi ndikimi në çmime. Prandaj, ecuria e çmimeve në ekonominë e Kosovës kryesisht diktohet nga lëvizjet e çmimeve në sektorin e jashtëm. Për shembull, çmimet e importit deri në qershor 2010, krahasuar me qershorin 2009 shënuan ngritje për 3.8 përqind gjë që reflekton ndikimin e madh të çmimeve nga tregjet ndërkombëtare në çmimet në Kosovë. Ndërsa, sa i përket çmimeve të prodhimit, mund të konsiderohet se nuk ka pasur lëvizje të mëdha (0.2 përqind rritja në qershor 2010 krahasuar me qershor 2009).


Figura 6. Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor



Burimi: ESK (2010)

Niveli i lartë i papunësisë vazhdon të jetë njëra ndër sfidat kryesore të ekonomisë së Kosovës. Sipas Anketës së Tregut të Punës e realizuar nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK), norma e papunësisë në Kosovë është rreth 45 përqind të fuqisë punëtore në vitin 2009. Për dallim nga shumë vende të rajonit dhe të BE-së, ku kriza globale ndikoi në rritjen e normës së papunësisë, norma edhe ashtu e lartë e papunësisë në Kosovë nuk paraqitet të jetë ndikuar nga kriza, përkundrazi, papunësia në Kosovë gjatë vitit 2009 shënoi rënie për 2pp. Megjithatë, Kosova vazhdon të jetë vendi me normën më të lartë të papunësisë në rajon (Figura 7).

Figura 7. Papunësia në Kosovë, rajon dhe Evropë, në përqindje



Politika fiskale në Kosovë në periudhën e pasluftës ka qenë mjaftë konzervative, e kryesisht e karakterizuar me tepricë buxhetore ose nivele të ulëta të deficitit. Kjo qasje e politikës fiskale deri diku reflekton kufizimet e qeverisë për të financuar deficitet buxhetore për shkak të mungesës së instrumenteve (p.sh. mungesa e ligjit për borxh publik deri në vitin 2009). Rrjedhimisht, burimet e vetme për financimin e deficitit buxhetor ishin rezervat e grumbulluara nga periudhat me tepricë buxhetore si dhe donacionet direkte buxhetore nga komuniteti ndërkombëtar.

Ngjashëm me vendet tjera, shpenzimet publike kishin një rol të rëndësishëm për të zbutur efektet e krizës globale edhe në Kosovë. Mirëpo, për dallim nga shumë vende ku buxheti i vendit u shfrytëzua për ndihmë direkte institucioneve financiare apo sektorëve tjerë të ekonomisë përmes formave të ndryshme të transfereve, rritja e shpenzimeve publike në Kosovë kishte për qëllim stimulimin e nivelit të përgjithshëm të konsumit dhe investimeve në vend, përmes rritjes së shpenzimeve për kategori të ndryshme, posaçërisht për investimet në infrastrukturë.

Buxheti i Kosovës në vitin 2009 u karakterizua me një deficit prej 2.2 përqind të PBB-së, si rrjedhojë e normës më të lartë të rritjes së shpenzimeve krahasuar me normën vjetore të rritjes së të hyrave. Shpenzimet buxhetore në vitin 2009 shënuan një normë të rritjes prej 29.7 përqind, ndërsa të hyrat buxhetore përkundër ndikimit nga efektet e krizës u rritën për 21.7 përqind. Si rezultat i mbështjetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importin e mallrave nga jashtë, burimi kryesor i të hyrave buxhetore vazhdojnë të hyrat e mbledhura në kufi (55.3 përqind e gjithsej të hyrave). Varësia e lartë e buxhetit në të hyrat nga një burim bënë që buxheti i vendit të ketë ndjeshmëri të lartë ndaj tronditjeve në tregtinë me jashtë. Në këtë kontekst, në vitin 2009 është vërejtur ngadalësim i rritjes së të hyrave të mbledhura në kufi si pasojë e zvogëlimit të importit gjatë kësaj periudhe, ndërsa kontribut pozitiv në rritjen e këtyre të hyrave ka pasur rritja e normës së TVSH-së nga 15 në 16 përqind që nga fillimi i vitit 2009. Sidoqoftë, ndikimin kryesor në rritjen e të hyrave buxhetore e kishte transferimi i dividendës së PTK-së.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Buxheti i Kosovës u karakterizua me suficit prej 67.3 milionë euro. Gjatë kësaj periudhe të hyrat buxhetore ndoqën një trend më të shpejtë të rritjes krahasuar me shpenzimet. Përderisa të hyrat shënuan një rritje vjetore prej 27


përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet buxhetore u rritën për 8.4 përqind, që paraqet një normë më të ulët të rritjes krahasuar me normën vjetore prej 18.1 përqind të realizuar në gjashtëmujorin e parë 2009. Sipas buxhetit të rishikuar, viti 2010 pritet të mbyllet me një deficit buxhetore prej 3.7% të PBB-së.

Aprovimi i ligjit për huamarrjen publike si dhe anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore paraqesin zhvillime me rëndësi për financat publike në vend dhe për zhvillimet ekonomike në përgjithsi. Në qershor 2010, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për herë të parë miratoi aranzhmanin 'stand-by' për Kosovën në vlerë prej 108.9 milionë euro (SDR 92.9 milionë) që përbën 157 përqind të gjithsej kuotës së Kosovës në FMN. Ky aranzhman është aprovuar për një periudhë kohore prej 18 muajsh. Fillimisht Kosova mund të tërheqë 22.1 milionë euro, ndërsa tërheqja e kësteve tjera do të bëhet sipas rishikimeve tremujore. Njëherit, aprovimi i programit financiar me FMN-në ka hapur mundësinë e shfrytëzimit të donacioneve buxhetore të zotuar nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore. Megjithatë, gjatë tremujorit të dytë, Kuvendi i Kosovës nuk ratifikoi kredinë e aprovuar nga Banka Botërore, në vlerë prej 20 milionë dollarë, që kishte për qëllim modernizimin e administratës publike.

Kanalet më të rëndësishme të transmetimit të krizës globale në ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2009 kishin burimin në sektorin e jashtëm. Në këtë kontekst, është vërejtur rënie e theksuar e eksporteve dhe po ashtu rënie e dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja direkte, të cilat paraqesin burime të rëndësishme të financimit për ekonominë e Kosovës. Në vitin 2009 është vërejtur edhe rënie e lehtë e importeve, për herë të parë që nga periudha e pasluftës. Mirëpo, ndikimin kryesor në rënien e importit në Kosovë e kanë pasur çmimet më të ulëta gjatë vitit 2009. Mbështjettja e lartë e ekonomisë së Kosovës në importin e mallrave nga jashtë dhe niveli i ulët i prodhimit vendor ka bërë që bilanci i pagasave të karakterizohet me një deficit të lartë tregtar (44.5 përqind e PBB-së në vitin 2009), që paraqet kontribuesin kryesor për deficitin e llogarisë rrjedhëse prej 16 përqind të PBB-së.

Fillimi i rikuperimit të ekonomive të zhvilluara gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 ka pasur ndikim pozitiv edhe në ekonominë e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, dërgesat e emigrantëve shënuan një rritje vjetore prej 1.4 përqind dhe arritën vlerën e 225.8 milionë euro (222.8 milionë euro deri në qershor 2009), ndërsa investimet e huaja direkte u rritën për 13.0 përqind duke shënuar vlerën prej 125.1 milionë euro (117.7 milionë euro deri në qershor 2009). Po ashtu, importet u rritën për 9.5 përqind, duke arritur vlerën prej 938.7 milionë euro, gjë që sugjeron se kërkesa e brendshme gjatë kësaj periudhe ka shënuar ngritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 8). Ndikim më i theksuar është vërejtur në vëllimin e eksporteve, të cilat në qershor 2010 arritën vlerën prej 141.7 milionë euro, rritje vjetore prej 121.6 përqind. Rritja e eksporteve në masën më të madhe i atribuohet rritjes së eksportit të metaleve bazë, të cilat pëfaqësojnë pjesën më të madhe të eksporteve (64.5 përqind e gjithsej eksporteve).

Figura 8. Bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: BQK

Eksporti i metaleve bazë kryesisht mbështetet në eksportin e nikelit (76 përqind e eksportit të metaleve bazë). Koncentrimi i lartë i eksporteve të Kosovës vetëm në disa produkte e ngritë ndjeshmërinë e performancës së eksporteve ndaj tronditjeve në sektor të veçantë industrial në sektorin e jashtëm siç ishte rasti gjatë vitit 2009 kur eksporti i metaleve bazë shënoi rënie afër 20 përqind. Këto efekte, përkundër nivelit të ulët të eksporteve, ndikojnë në rritje të brishtësisë dhe performancës së përgjithshme të ekonomisë së vendit.

## 5. Sektori Financiar i Kosovës

### 5.1. Karakteristikat e përgjithshme

Në qershor të vitit 2010, asetet e sektorit financiar arritën në 2.9 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 17.5 përqind që është e ngjashme me normën vjetore të rritjes së regjistruar vitin e kaluar (18.4 përqind në qershor 2009), përkundër ngadalësimit të ritmit të rritjes së asetetve të sektorit bankar që kanë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit financiar. Kontribut të rëndësishëm në rritjen e aseteteve të sektorit financiar kanë dhënë asetet e kompanive të sigurimeve dhe fondeve pensionale, të cilat shënuan rritje vjetore prej 35.8 përqind përkatësisht 20.1 përqind.

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	Qershor 2007	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010
Bankat komerciale	7	8	8	8
Kompanitë e sigurimeve	10	12	11	11
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	30	29	28	29
Institucionet mikrofinanciare	16	16	19	17

Burimi: BQK (2010)

Numri i institucioneve financiare që operuan në vend deri në qershor 2010 ishte 68, ngjashëm me qershorin 2009 kur sistemi financiar përbëhej nga 67 institucione. Gjatë kësaj periudhe, Banka Qendrore revokoi licencën e dy institucioneve mikrofinanciare, ndërsa në treg hyri një institucion i ri që vepron si ndihmës financiar (Tabela 3).

Sektori bankar vazhdon të përfaqësojë sektorin më të madh në kuadër të sektorit financiar të Kosovës, mirëpo pjesëmarrja e tij në gjithsej asetet e sektorit financiar ka shënuar një rënie të lehtë. Në qershor 2010, asetet e sektorit bankar arritën vlerën prej 2.2

Figura 9. Struktura e aseteteve e sektorit financiar




Burimi: BQK (2010)

miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind. Sidoqoftë, duke qenë se asetet e sektorit bankar dominohen kryesisht nga kreditë, ngadalësimi i rritjes së normës së kredisë ndikoi në zvogëlimin e pjesëmarrjes së aseteve të sektorit bankar në gjithsej asetet e sektorit financiar. Në qershor 2010, pjesëmarrja e aseteve të sektorit bankar në gjithsej asetet e sektorit financiar u zvogëlua në 77.5 përqind, nga 79.1 përqind sa ishte në qershor 2009 (Figura 9). Ngadalësimi i rritjes së kredidhënies ishte prezent edhe në institucionet mikrofinanciare, gjë që u reflektua në rënien e lehtë të pjesëmarrjes së aseteve të këtyre institucioneve. Ne anën tjetër, normat pozitive të kthimit në investimet e TKPK-së kontribuuan në rritjen e vlerës së aseteve të këtij sektori, duke bërë që pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sektorit financiar të rritet në 14.4 përqind në qershor 2010 (12.5 përqind në qershor 2009). Struktura e tregut në sistemin financiar të Kosovës dallon ndërmjet sektorëve të ndryshëm (Figura 10). Përderisa sektori i sigurimeve dhe ai i institucioneve mikrofinanciare kanë një shkallë të moderuar të koncentrimit të tregut, tregu bankar vazhdon të karakterizohet me normë të lartë të koncentrimit. Shprehur përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), tregu i sigurimeve ka një shkallë të koncentrimit prej 1061 pikë, ndërsa në sektorin e institucioneve mikrofinanciare, shkalla e koncentrimit të tregut është 1643 pikë. Për sa i përket sektorit bankar, shkalla e koncentrimit të tregut në qershor 2010 ishte ekuivalente me 2371 pikë. Sidoqoftë, shkalla e koncentrimit në këtë sektor ka ndjekur rënie të vazhdueshme që nga viti 2008. Në qershor 2010, shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar të Kosovës ishte për 252 pikë të IHH më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Rënia e shkallës së koncentrimit ishte kryesisht rezultat i ngadalësimit më të theksuar të kredidhënies në bankat e mëdha, përderisa kreditë e bankave më të vogla shënuan një normë më të lartë të rritjes. Rënia e shkallës së koncentrimit në sektorin bankar të Kosovës është shprehur edhe përmes rënies së pjesëmarrjes së aseteve të tri bankave të mëdha nga 82.8 përqind sa ishte në qershor 2009 në 78.9 përqind në qershor 2010.

Sektori financiar i Kosovës (përfshirë BQK-në) vazhdon të investojë një pjesë të konsiderueshme të aseteve në sektorin e jashtëm. Në qershor 2010, Asetet e Jashtme Neto (AJN) arritën vlerën 1.74 miliard euro (43.4 përqind të PBB-së), që përbën një rritje vjetore prej 8.6 përqind. Kërkesat e sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm shënuan një rritje vjetore prej 17.3 përqind në qershor 2010, duke arritur vlerën prej 2.1 miliard euro. Sa i përket sektorëve, struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm dominohet kryesisht nga kërkesat e BQK-së që në qershor 2010 përfaqësuan 57 përqind të gjithsej kërkesave, pasuar nga kërkesat e bankave komerciale (26.0 përqind) dhe fondeve pensionale me 16.7 përqind (Figura 11).

Në qershor 2010, detyrimet e sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm ishin 349.3 milion euro (178.6 milion euro në qershor 2009). Rritja e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm i atribuohet kryesisht anëtarësimit të Republikës së Kosovës në FMN (Ilogaria në


Figura 10. IHH për sektorin financiar në Kosovë



Burimi: BQK (2010)

FMN dhe SDR-të) gjë që ndikoi në rritjen e detyrimeve të BQK-së ndaj sektorit të jashtëm.<sup>4</sup> Struktura e detyrimeve të sektorit financiar përbëhet kryesisht nga detyrimet e sektorit bankar (40.8 përqind të gjithsej detyrimeve). Kreditë që bankat komerciale në Kosovë kanë marrë nga institucionet financiare jashtë vendit përfaqësojnë 44.4 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, pasuar nga depozitat e jorezidentëve në bankat komerciale të Kosovës 21.7 përqind. Sektori financiar i Kosovës nuk ka kërkesa ndaj qeverisë, përderisa, detyrimet ndaj këtij sektori, të cilat kryesisht përbëhen nga depozitat e qeverisë në BQK, arritën vlerën prej 940.7 milion euro në qershor 2010 (900.6 milion euro në qershor 2009). Vlera e depozitave të qeverisë në BQK (përfshirë depozitat e Agjencionit Kosovar të Privatizimit) në periudhën raportuese u zvogëlua në 805.1 milion euro (899.1 milion euro në vitin 2009), gjë që reflekton rritjen e shpenzimeve qeveritare në vend. Që nga tetori i vitit 2009, është vënë re një rritje e detyrimeve të sektorit bankar në Kosovë ndaj qeverisë, që kryesisht ishte pasojë e bartjes së dividendës së PTK-së tek qeveria. Në mënyrë që të shmanget një rrezik i mundshëm për qëndrueshmërinë e likuiditetit në sektorin bankar, vlera e transferuar tek qeveria vazhdoi të mbahet si depozita në bankat komerciale. Kërkesat e sektorit financiar në Kosovë ndaj sektorit real vazhduan të dominohen nga kreditë e bankave komerciale. Këto kërkesa arritën vlerën 1.5 miliard euro, një rritje vjetore prej 10.0 përqind. Detyrimet ndaj sektorit real përbëhen kryesisht nga depozitat në banka komerciale.

Figura 11. Struktura e investimeve e sektorit financiar



Burimi: BQK (2010)

## 5.2. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj institucioneve tjera financiare

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorëve të tjerë që operojnë në sistemin financiar në Kosovë vazhdon të konsiderohet i ulët, përderisa tregu ndërbankar pothuajse nuk egziston. Depozitat e institucioneve tjera financiare në bankat komerciale që operojnë në Kosovë përfaqësojnë vetëm 4.8 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar. Pjesa më e madhe e këtyre depozitave përbëhet nga depozitat që kompanitë e sigurimeve kanë në bankat komerciale. Po ashtu, ekspozimi kreditor i bankave komerciale ndaj këtyre institucioneve vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët, me vetëm 0.3 përqind të gjithsej kredive të lëshuara nga sektori bankar të pranuar nga institucionet tjera financiare. Në kuadër të kredive të lëshuara nga sektori bankar për institucionet tjera financiare, pjesa më e madhe përbëhet nga kreditë për institucionet mikrofinanciare të cilat marrin pjesë me 68.6 përqind, pasuar nga kreditë e lëshuara për kompanitë e sigurimeve (29.2 përqind).

Niveli i ulët i lidhshmërisë ndërmjet institucioneve financiare vërehet edhe për sa i përket strukturës së pronësisë së institucioneve financiare. Bazuar në strukturën e aksionarëve të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, janë identifikuar vetëm tri raste kur individët kanë aksione në banka komerciale dhe kompani të sigurimeve.

<sup>4</sup> Sipas standardeve statistikore, vlera e SDR-ve si dhe kuota në FMN regjistrohen në bazë bruto, në anën e aseteve dhe të detyrimeve.

Shkalla e ulët e ndërvarësisë ndërmjet institucioneve financiare që operojnë në Kosovë bënë që rreziku sistemik në sektorin financiar të jetë i ulët. Me fjalë të tjera, vështirësitë financiare në njërin nga sektorët nuk do të reflektoheshin në masë të madhe në sektorët tjerë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh performancën e mirë dhe stabilitetin që kanë treguar institucionet financiare që operojnë në Kosovë, një ndërveprim më i lartë ndërmjet tyre do të kontribuonte në zgjerimin më të shpejtë të aktivitetit të tyre, pa shkaktuar rritje substanciale të rrezikut në sektorin financiar.


## 6. Sektori Bankar

### 6.1. Karakteristikat e përgjithshme të sektorit bankar

Struktura e sektorit bankar të Kosovës në qershor të vitit 2010 ishte e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si për nga numri i bankave ashtu edhe për nga struktura e pronësisë së bankave. Në këtë periudhë, sektori bankar i Kosovës kishte tetë banka komerciale, prej të cilave gjashtë ishin me pronësi të huaj ndërsa dy me pronësi vendore (Figura 12). Dominimi i bankave me pronësi të huaj në sektorin bankar të Kosovës shprehet edhe përmes pjesëmarrjes së aseteve të këtyre bankave në gjithsej asetet e sektorit bankar. Në qershor 2010, asetet e këtyre bankave përfaqësonin 89.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, përderisa bankat me pronësi vendore menaxhonin pjesën e mbetur prej 10.2 përqind.

Bankat komerciale kanë vazhduar zgjerimin e infrastrukturës së tyre, duke krijuar kushte për qasje më të lehtë të klientëve në shërbimet bankare. Megjithatë, ngadalësimi i aktivitetit ndërmjetësues të sektorit bankar që filloi gjatë vitit 2009 dhe vazhdoi gjatë vitit 2010 ndikoi negativisht nivelin e të hyrave të sektorit bankar, gjë që kushtëzoi edhe ndërmarrjen e masave për kufizimin e shpenzimeve në këtë sektor. Si pasojë, bankat u kushtëzuan të ndërmarrin masa për kufizimin e shpenzimeve, gjë që ndikoi në ngadalësimin e zgjerimit të infrastrukturës së këtij sektori (Tabela 4). Në qershor 2010, numri i degëve dhe nëndegëve bankare arriti në 296, që paraqet një rritje prej vetëm 7 njësi krahasuar me qershor 2009. Trend më i ngadalshëm i zgjerimit është vërejtur edhe për sa i përket numrit të ATM-ve dhe POS-ve të instaluar gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, përkundër këtij ngadalësimi, shpërndarja e infrastrukturës së sektorit bankar në Kosovë është e përafërt me vendet në rajon. Numri i degëve të bankave në 1000 km<sup>2</sup> në Kosovë është 26.8, ndërkaq mesatarja e degëve në 1000 km<sup>2</sup> në rajon ishte 23.8. Ngjashëm, edhe numri i ATM-ve në 1000 km<sup>2</sup> në Kosovë ishte 37.6 në vitin 2009 përderisa mesatarisht në rajon është 37.6.

Figura 12. Numri i bankave, dhe struktura e pronësisë



Burimi: BQK (2010)

Tabela 4. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2007	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010
Numri i degëve dhe nëndegëve	225	246	289	296
Numri i të punësuarëve	2,771	3,421	3,827	3,727
Numri i ATM-ve	155	219	282	380
Numri i POS-ve	0	2,837	4,612	5,493
Numri i llogarive 'e-banking'	0	11,242	17,496	49,188

Burimi: BQK (2010)

Masat e ndërmarra nga bankat komerciale në Kosovë për zvogëlimin e shpenzimeve janë karakterizuar edhe me zvogëlimin e numrit të të punësuarve në këtë sektor. Përderisa në qershor 2009, ishin të punësuar gjithsej 3,827 punëtorë, në qershor 2010 ky numër u zvogëluar në 3,727. Në mesin e shërbimeve bankare që kanë ndjekur një trend të shpejtë të zhvillimit në periudhën e fundit mund të veçohen llogaritë 'e-banking', shkalla e përdorimit të të cilave ka ndjekur trend të shpejtë të rritjes. Në qershor 2010, numri i llogarive 'e-banking' në sektorin bankar të Kosovës arriti në 49,188 nga 17,496 sa ishte në qershor 2009. Këto shërbime kanë rol të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit të sektorit bankar si dhe lehtësojnë qasjen e klientëve në shërbimet bankare. Në qershor 2010, sistemi i pagesave në sektorin bankar në Kosovë ka shënuar rritje në numrin dhe vlerën e gjithsej transaksioneve, duke reflektuar besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit bankar në Kosovë. Numri i gjithsej transaksioneve arriti 1.87 milion në qershor 2010, një rritje prej 3.0 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009. Duke arritur vlerën prej 1.94 miliard euro në qershor 2010, vlera e gjithsej transaksioneve të pagesave bankare shënoi një rritje vjetore prej 18.9 përqind.

## 6.2. Bilanci i gjendjes së sektorit bankar

### 6.2.1 Asetet

Sektori bankar ka vazhduar të zgjeroj aktivitetin edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, me ç'rast asetet arritën në 2.2 miliard euro në qershor të vitit 2010 (55.1 përqind të PBB-së), që përbën një rritje vjetore prej 15.1 përqind. Kategoritë që kontribuan më shumti në rritjen e përgjithshme të aseteve janë kreditë dhe letrat me vlerë (Figura 13). Veprimtaria e bankave komerciale që operojnë në Kosovë është e dominuar nga aktiviteti i ndërmjetësimit brenda vendit, ndërkaq 24.5 përqind e gjithsej aseteve janë të ekspozuara ndaj sektorit të jashtëm. Krahasuar me qershorin e vitit 2009, asetet e sektorit bankar të investuara jashtë vendit kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej asetet për 5pp. Këto asete janë kryesisht të depozituara në bankat komerciale dhe një pjesë më e vogël është e investuar në letra me vlerë.

Aktiviteti i sektorit bankar të Kosovës vazhdon të jetë në masë dërmuese i koncentruar në kreditimin e ekonomisë vendore, ku kreditë përfaqësojnë rreth 63.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar (Tabela 5). Trendi i kreditimit të ekonomisë vendore nga bankat shënoi ngadalësim këtë vit krahasuar me vitin paraprak, përderisa investimet në ekonomitë jashtë vendit, konkretisht investimet në letra me vlerë shënuan rritje. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e kredisë në gjithsej asetet e sektorit ishte më e ulët për 3.2pp



krahasuar me qershorin 2009, përderisa një pjesëmarrje më e madhe e aseteve të sektorit bankar u alokuan në investime në letra me vlerë (3.4pp).


Tabela 5. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2007		Qershor 2008		Qershor 2009		Qershor 2010	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	152.8	12.4	184.5	11.5	241.9	12.6	268.1	12.1
Bilanci me bankat komerciale	211.1	17.1	200.4	12.5	286.7	14.9	351.6	15.8
Letrat me vlerë	46.6	3.8	43.4	2.7	34.1	1.8	114.0	5.1
Kreditë dhe lizingu	784.4	63.4	1089.7	68.1	1280.9	66.5	1404.6	63.3
Asetet fikse	23.1	1.9	33.4	2.1	40.1	2.1	42.6	1.9
Asetet tjera	18.6	1.5	48.2	3.0	43.5	2.3	37.8	1.7
Gjithsej	1236.6	100.0%	1599.6	100.0%	1927.1	100.0%	2218.8	100.0%

Burimi: BQK (2010)

Pas rënies që filloi në vitin 2008, investimet në letra me vlerë shënuan rritje përsëri, duke arritur vlerën 114 milion euro në qershor 2010 (34.1 milion euro në qershor 2009). Rënia e investimeve në letra me vlerë në periudhën e kaluar ka qenë kryesisht pasojë e zgjerimit të shpejtë të kreditimit nga sektori bankar, pasi që normat e larta të interesit që mbizotërojnë në treg kanë ofruar normë më të lartë të kthimit. Për më tepër, tronditjet e tregut financiar gjatë vitit 2008 dhe 2009 ndikuan në rritjen e hezitimit të bankave për të investuar në letrat me vlerë jashtë vendit. Megjithatë, ngadalësimi i rritjes së kredisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 si dhe përmirësimi i kushteve në tregjet financiare ndërkombëtare gjatë vitit 2010 ndikoi në rritjen e theksuar të investimeve në letrat me vlerë gjatë kësaj periudhe. Këto zhvillime tregojnë se bankat kanë zhvendosur një pjesë të burimeve të tyre nga kreditimi i ekonomisë së vendit në investime në letra me vlerë në sektorin e jashtëm. Struktura e investimeve të bankave në letra me vlerë përbëhet kryesisht nga investimet në letra me vlerë të qeverive, korporata financiare dhe korporata jo-financiare.

Figura 13. Kontributi në rritjen e aseteve sipas burimeve, në përqindje



Burimi: BQK (2010)


## 6.2.2 Kreditë

Zvogëlimi i të hyrave nga jashtë dhe implikimet e mundshme në rritjen ekonomike krijuan pasiguri te sektori bankar mbi aftësinë paguese të kredimarrësve. Kjo rezultoi në ngadalësim të kredihënjes, përderisa burimet e financimit të bankave komerciale (kryesisht depozitat) vazhduan të rriten me trend të ngjashëm me periudhat e kaluara.

Në qershor të vitit 2010, kreditë e lëshuara nga sektori bankar në Kosovë arritën vlerën prej 1.4 miliardë euro, një rritje vjetore prej 9.6 përqind krahasuar me rritjen prej 17.5 përqind në qershor 2009. Shtrëngimi i kredihënjes nga sektori bankar ka peshuar më shumë në kreditë për ndërmarrjet, të cilat u rritën me një ritëm shumë të ulët krahasuar

me periudhat e mëparshme. Në gjysmën e parë të vitit 2010, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet shënuan një rritje vjetore prej vetëm 2,3 përqind, krahasuar me rritjen prej 13.9 përqind në qershor 2009 dhe 38.5 përqind qershor 2008, respektivisht. Nga ana tjetër, norma e rritjes së kredive të lëshuara për ekonomitë familjare duket se nuk është ndikuar nga shtrëngimi i kreditimit. Kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare regjistruan një rritje vjetore prej 31.4 përqind në qershor 2010 (30.4 përqind në qershor 2009). Si rrjedhojë, pjesëmarrja e kredive për ndërmarrjet në gjithsej kreditë ka rënë në 70.9 përqind (75.7 përqind në qershor 2009), ndërsa kreditë për ekonomitë familjare kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në 29.1 përqind (Figura 14).

Figura 14. Struktura e kredive, në përqindje




Burimi: BQK (2010)

Hezitimi i bankave për të zgjeruar në masë më të madhe kreditimin e ndërmarrjeve pasqyron pasigurinë e bankave rreth performancës së këtij sektori, i cili karakterizohet me nivel më të lartë të ndjeshmërisë ndaj lëvizjeve në ekonominë e vendit dhe atë globale. Në anën tjetër, kreditimi i ekonomive shtëpiake përbën rrezik më të vogël kryesisht për shkak se të ardhurat e ekonomive shtëpiake konsiderohen më të qëndrueshme duke qenë se sektori publik punëson një pjesë të madhe të tyre. Për më tepër, dërgesat nga jashtë që pranojnë ekonomitë shtëpiake ulin edhe më tej rrezikun dhe pasigurinë e bankave në kreditimin e këtij sektori.

Përmirësimi i performancës së ekonomisë globale gjatë vitit 2010 është reflektuar pozitivisht edhe në ekonominë e Kosovës. Përceptimet e bankave për ambientin ekonomik në vend u përmirësuan, gjë që u shpreh përmes normës më të lartë të rritjes së kredisë gjatë kësaj periudhe. Rritja vjetore prej 9.7 përqind në qershor 2010 ishte më e lartë krahasuar me rritjen prej 8.9 përqind në qershor 2009, që tregon për një përmirësim të lehtë të normës vjetore të rritjes së kredisë arriti në 9.7 përqind. Për më tepër, kreditë e reja të lëshuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 shënuan një rritje vjetore prej 5.6 përqind. Rritja e kredive të reja në këtë periudhë kryesisht i atribuohet rritjes së kredive të lëshuara për ekonomitë shtëpiake, ndërsa kreditimi i ndërmarrjeve mbetet i shtrënguar. Shtrëngimi i kreditimit për ndërmarrjet mund të kufizojnë në masë të madhe potencialet investuese në vend, me pasoja negative për performancën e përgjithshme të ekonomisë.

Figura 15. Struktura e kredive sipas industrisë, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

Struktura e kredive të lëshuara për ndërmarrjet vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e shërbimeve, që përfaqëson 67.1 përqind të gjithë kredive për ndërmarrjet. Brenda sektorit të shërbimeve, pjesa më e madhe e kredive i takojnë sektorit të tregtisë (51 përqind të gjithë kredive për ndërmarrjet), që reflekton mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në këtë sektor (Figura 15). Rritjen më të madhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 raportuan kreditë e lëshuara për sektorin e industrisë prodhuese dhe ndërtimtarisë, një rritje vjetëre prej 33.6 dhe 59.7 përqind, respektivisht. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e kredive në sektorin e prodhimit u rrit në 14.7 përqind të gjithë kredive të ndërmarrjeve (11.8 përqind në qershor 2009), ndërsa kreditë për ndërtimtarinë përfaqësuan 11.2 përqind të kredive në qershor 2010 (8.1 përqind në qershor 2009). Kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë vazhdojnë të përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të gjithë kredive të lëshuara për ndërmarrjet. Në qershor të vitit 2010, kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë arritën vlerën prej 39.9 milion euro, duke përfaqësuar vetëm për 4 përqind të gjithë kredive. Pjesëmarrja e vogël e kredive të lëshuara për sektorin e bujqësisë mund të atribuohet deri në një masë normave të larta të interesit për kreditë e këtij sektori, gjë që mund të dekurajojë fermerët për të aplikuar për kredi. Përveç kësaj, disa nga specifikat që karakterizojnë sektorin e bujqësisë, si pasiguria mbi të drejtat pronësore si dhe numri i vogël i fermave të organizuara në formë të bizneseve të rregullta me llogari-mbajtje mund të ndikojnë në rritjen e rrezikut për këto kredi, që rezultojnë në norma më të larta të interesit dhe kritere më të rrepta të kreditimit.

Kreditë me afat më të gjatë të maturimit kanë vazhduar të rrisin pjesëmarrjen e tyre në gjithë kredite. Në qershor 2010, kreditë me maturitet më të gjatë se dy vite përfaqësuan 71.8 përqind të gjithë kredive, një rritje e vazhdueshme e këtyre kredive gjatë viteve të fundit (67.2 përqind të gjithë kredive në 2009 dhe 65.6 përqind të gjithë kredive në vitin 2008, respektivisht). Në anën tjetër, pjesëmarrja e kredive me afat maturimi deri në dy vite është karakterizuar me një trend rënës. Kreditë me maturitet deri në dy vite përfaqësuan 28.2 përqind të gjithë kredive në qershor të vitit 2010 (32.8 përqind të totalit të kredive në 2009 dhe 34.4 përqind të gjithë kredive në 2008, respektivisht).

### 6.2.3 Detyrimet

Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga burime vendore të financimit, çka ka kontribuar që sektori bankar i Kosovës të ketë ndjeshmëri të ulët ndaj ndryshimit të kushteve të financimit në sektorin e jashtëm gjatë periudhës së evoluimit të krizës financiare. Depozitat e mbledhura brenda vendit vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit për bankat, duke përfaqësuar 79.0 përqind të gjithë detyrimeve të sektorit bankar (Tabela 6). Burim tjetër i rëndësishëm i financimit të bankave komerciale në Kosovë janë mjetet vetanake, që përfaqësojnë 10.1 përqind të gjithë detyrimeve të sektorit bankar. Në qershor 2010, vlera e mjeteve vetanake shënoi një rritje vjetëre prej 10.3 përqind, që kryesisht rezultoi nga rritja e kapitalit aksionar të bankave, që përbën rreth 73.3 përqind të gjithë mjeteve vetanake.

Me gjithë dominimin e burimeve vendore të financimit në strukturën e detyrimeve të sektorit bankar të Kosovës, në periudhat e fundit është vërejtur një tendencë e rritjes së shfrytëzimit të financimit nga jashtë, gjë që rritë burimet e financimit për bankat, duke kontribuar kështu edhe në rritjen e kapaciteteve të tyre për të zgjeruar kredidhënien. Në qershor 2010, vlera e detyrimeve të sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm në formë të borxhit të ndërvarur arriti vlerën prej 24.4 milion euro nga 16.9 milion euro sa ishte në qershor 2009. Përkundër rritjes vjetëre prej 44.3 përqind, pesha e borxhit të ndërvarur në

gjithsej detyrimet e sektorit bankar në Kosovë vazhdon të jetë e ulët me një pjesëmarrje prej vetëm 1.1 përqind në gjithsej detyrimet.

**Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar**

Përshkrimi	Qershor 2007		Qershor 2008		Qershor 2009		Qershor 2010	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	25.0	2.0	32.6	2.0	41.8	2.2	48.5	2.2
Depozitat	981.6	79.4	1264.4	79.0	1513.0	78.5	1751.7	79.0
Huatë tjera	3.2	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Detyrimet tjera	94.3	7.6	112.4	7.0	152.1	7.9	168.7	7.6
Borxhi i ndërvarur	7.0	0.6	7.0	0.4	16.9	0.9	24.4	1.1
Mjetet vetanake	125.6	10.2	183.2	11.5	203.3	10.5	224.3	10.1
Gjithsej detyrimet	1236.7	100%	1599.6	100%	1927.1	100%	2217.6	100%

Burimi: BQK (2010)

### 6.2.4 Depozitat


Në qershor 2010, depozitat arriten vlerën 1.8 miliard euro, që përbën rritje vjetore prej 15.8 përqind. Edhe pse norma vjetore e rritjes së depozitave në këtë periudhë ishte më e ulët krahasuar me vitin 2009 për 3.9 pp, mund të konstatohet se depozitat u treguan më pak të ndjeshme ndaj efekteve të krizës kryesisht për shkak se sektori bankar në Kosovë dominohet nga depozitat e gjeneruara brenda vendit. Rritja e gjithsej depozitave të sektorit bankar është kryesisht rezultat i rritjes së depozitave të mbledhura nga ekonomitë familjare, që në qershor 2010 arritën vlerën 1.13 miliard euro dhe kontribuuan kështu në rritjen e depozitave me 15.6 pp.

Duke arritur vlerën prej 306.2 milion euro, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 36.1 përqind në qershor 2010. Rënia e depozitave të ndërmarrjeve kryesisht i atribuohet rënies së depozitave të ndërmarrjeve publike nga 270.4 milion euro në qershor 2009 në 138.1 milion euro në qershor 2010.

Rënia e thekësuar e depozitave të ndërmarrjeve publike, dhe në të njëjtën kohë rritja e konsiderueshme e depozitave të qeverisë (nga 1.5 milionë euro në qershor 2009 në 138.1 milion euro në qershor 2010) është kryesisht rezultat i transferimit të dividendës së Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) të qeveria në tetor 2009, në vlerë prej 200 milionë euro. Nga ana tjetër, depozitat e ndërmarrjeve private në qershor 2010 arritën vlerën prej 230.5 milion euro, rritje vjetore prej 10.5 përqind.

Struktura e depozitave në sektorin bankar mbetet e ngjashme me periudhat e mëparshme, ku burimi kryesor i depozitave të sektorit bankar në vend mbeten depozitat e ekonomive familjare (65 përqind të gjithsej depozitave), pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve që përfaqësojnë 17.5 përqind të gjithsej depozitave (Figura 16). Në qershor

**Figura 16. Struktura e depozitave sipas sektorëve**



Burimi: BQK (2010)


2010, depozitat e qeverisë dhe depozitat e institucioneve të tjera financiare janë të përfaqësuar me 7.9 përqind dhe 5.0 përqind, respektivisht.

Depozitat e jorezidentëve në sektorin bankar të Kosovës përfaqësuan 4.3 përqind të gjithë depozitave (3.6 përqind në qershor 2009), që tregon për një trend rritës të këtyre depozitave në vitet e fundit. Normat e favorshme të interesit në depozita si dhe rritja e besimit të publikut në sektorin bankar të Kosovës kanë ndikuar deri në një masë rritjen e depozitave të jorezidentëve. Lëvizshmëria e normës së këmbimit do të rrezikonte minimalisht depozitat në sektorin bankar në Kosovë, duke qenë se rreth 94.4 përqind të depozitave mbahen në valutën euro dhe vetëm 5.8 përqind janë në valuta tjera.

Struktura e depozitave në sektorin bankar vazhdoi të jete e jetë e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesëmarrjen më të lartë në gjithë depozitat vazhdojnë ta kenë depozitat e ekonomive familjare (65.0 përqind), pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve (17.5 përqind). Pjesa e mbetur i takon depozitave të qeverisë dhe depozitave të institucioneve tjera financiare (12.7 përqind).

Struktura e depozitave mbeti e pandryshuar edhe sa i përket afatit të maturimit. Depozitat e afatizuara përbëjnë rreth 52.7 përqind të totalit të depozitave, të pasuara nga depozitat e transferueshme që përfaqësojnë 30.0 përqind të depozitave. Pjesa e mbetur i takon depozitave të kursimeve, që në qershor 2010 përfaqësuan 17.3 përqind të depozitave. Në kuadër të depozitave të afatizuara, 39.5 përqind përfaqësohen nga depozitat me afat maturimi deri në një vit, 7.6 përqind me afat maturimi mbi dy vite, dhe pjesa e mbetur me afat maturimi një deri në dy vite (Figura 17). Rritja e vazhdueshme e depozitave me afat më të gjatë maturimi do të ndikojë pozitivisht në qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe sigurimin e kreditimit afatgjatë, kur kemi parasysh që asetet e sektorit bankar në Kosovë kryesisht financohen nga depozitat.

Figure 17. Struktura e depozitave të afatizuara




Burimi: BQK (2010)

### 6.3. Performanca e sektorit bankar

Pas një periudhe të karakterizuar me rënie të profitit, në qershor 2010 sektori bankar i Kosovës realizoi profit neto në vlerë prej 19.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 56.8 përqind (Figura 1). Rritja e profitit të sektorit bankar kryesisht është rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të këtij sektori, gjë që reflekton masat e ndërmarra nga

Figura 18. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve operacionale, në milionë euro




Burimi: BQK (2010)

bankat komerciale për të ruajtur efikasitetin nën kushtet e ngadalësimit të aktivitetit ndërmjetësues financiar, përdërisa të hyrat vazhduan të rriten me normë më të ulët se sa në periudhat e kaluara.

Si rezultat i rritjes së profitit neto, pas dy viteve të rënies së profitabilitetit në sektorin bankar, u vërejt rritje e indikatorëve të profitabilitetit, siç janë kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Asset: ROAA) dhe kthimi mesatar në kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE) (Figura 20). Trendi i rritjes së kthimit mesatar në asete dhe kthimit mesatar në kapital kryesisht erdhi si pasojë e rritjes së profitit të tri bankave më të mëdha në vend.

Figura 19. Treguesit e performancës, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

### Kutia 2. Zbërthimi i faktorëve kontribues në Kthimin Mesatar në Kapital


Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE) paraqet një tregues të rëndësishëm që matë profitabilitetin e sektorit bankar. Pas tri viteve të rënies së vazhdueshme, në qershor 2010, është vërejtur trend pozitiv i këtij treguesi krahasuar me vitin paraprak. Faktorët të cilët kanë ndikuar në ndryshimin e ROAE-s mund të zbërthehen përmes formulës së mëposhtme, e cila paraqet këtë tregues si produkt të katër faktorëve.

$$KMK = \left( \frac{\text{Profitti para tatimit}}{\text{Profitti Operacional}} \right) \times \left( \frac{\text{Profitti Operacional}}{\text{Asetet e Peshuara me Rrezik}} \right) \times \left( \frac{\text{Asetet e Peshuara me Rrezik}}{\text{Totalit i Aseteve}} \right) \times \left( \frac{\text{Totalit i Aseteve}}{\text{Kapitali}} \right)$$

Margjina e profitit
Profiti i përshtatur ndaj riskut
Niveli i riskut
Shkalla e levës

Rritja e ROAE-s si rezultat i rritjes së *marginës së profitit* para tatimit nënkupton se të hyrat janë rritur më tepër se shpenzimet dhe efekti për qëndrueshmërinë e sistemit bankar është pozitiv. Efekti për qëndrueshmërinë e sistemit bankar po ashtu është pozitiv nëse ROAE rritet si rezultat i rritjes së *profitit të përshtatur ndaj riskut*, që nënkupton se profiti i sektorit bankar po rritet më shpejtë se sa asetet e peshuara ndaj rrezikut. Në anën tjetër, rritja e ROAE si rrjedhojë e rritjes së *niveleit të riskut* ka implikime negative për qëndrueshmërinë e sektorit bankar, pasi që tregon se struktura e aseteve të sektorit bankar po ndryshon në favor të aseteve që bartin nivel më të lartë të riskut. Qëndrueshmëria e

Figura 20. Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e KMK-së



Burimi: BQK (2010)


sektorit bankar mund të ndikohet negativisht edhe nëse profitabiliteti i tij rritet si rezultat i *shkallës së levës*, pasi që nënkuptohet se asetet e sektorit bankar po rriten më shpejtë se sa kapitali, gjë që nënkupton se sektori bankar ka një proporcion më të ulët të kapitalit në raport me asetet për të absorbuar tronditjet e mundëshme.

Figura 19 paraqet kontribuesit kryesorë në ndryshimin e ROAE për sektorin bankar të Kosovës. Rritja e ROAE në qershor 2010 duket të ketë rezultuar kryesisht nga rritja e magjinës së profitit, duke reflektuar kështu zvogëlimin e shpenzimeve të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe. Margjina e profitit ka qenë përcaktuesi më i rëndësishëm për profitabilitetin e sektorit bankar të Kosovës edhe në vitin 2009, kur ROAE kishte shënuar rënie. Një tjetër faktor që ka kontribuar në rritjen e ROAE në qershor 2010 ka qenë rritja e shkallës së levës, gjë që tregon se asetet janë rritur më shpejtë se sa kapitali i sektorit bankar. Nga ana tjetër, niveli i riskut kishte ndikim negativ në profitabilitetin e sektorit bankar. Kjo reflekton normën më të ulët të rritjes së aseteve të peshuara ndaj riskut për shkak të normës më të ulët të rritjes së kredive, të cilat paraqesin komponentin kryesor të aseteve të peshuara ndaj riskut. Norma më e ulët e rritjes së kredisë ka pasur ndikim negativ në profitabilitetin e sektorit bankar, por konsiderohet të ketë zvogëluar nivelin e riskut të ndërmarrë nga bankat.

Ngadalësimi i trendit të rritjes së të hyrave të sektorit bankar, i cili filloi që nga fillimi i vitit 2009, vazhdoi edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Deri në qershor 2010, të hyrat e sektorit bankar shënuan vlerën prej 103.2 milionë euro, duke regjistruar një rritje vjetore prej 1.2 përqind (qershor 2008: 36.5 përqind; qershor 2009: 10.0 përqind). Norma më e ulët e rritjes së të hyrave të sistemit bankar, është pasojë e ngadalësimit të rritjes së kredive, gjë që shkaktoi ngadalësimin e të hyrave nga interesi në kredi, të cilat paraqesin burimin kryesor të të hyrave për sektorin bankar. Ngadalësimi i gjithsej të hyrave po ashtu u shkaktua nga niveli më i ulët i të hyrave nga interesi në plasmanet e bankave jashtë vendit (Figura 21). Megjithë rritjen e vëllimit të plasmaneve të bankave jashtë vendit, rënia e normave të interesit në tregun ndërbankar evropian si pasojë e zbritjes së normës bazë të interesit nga BQE ndikoi në rënien e të ardhurave nga interesi nga këto plasmane. Të hyrat e sektorit bankar gjatë gjashtëmujorit të parë të 2010 janë ndikuar negativisht edhe nga të hyrat tjera që shënuan një rënie vjetore prej 80 përqind në qershor 2010 (Figura 22). Nga ana tjetër, investimet e sektorit bankar në letra me vlerë përcollën një trend rritës gjatë vitit 2010, që ndikoi pozitivisht në nivelin e përgjithshëm të të hyrave.

Sa i përket strukturës së të hyrave të


Figura 21. Trendi i të hyrave nga interesi, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

ngadalësimi i trendit të rritjes së të hyrave nga interesi në plasmanet e bankave jashtë vendit, rënia e normave të interesit në tregun ndërbankar evropian si pasojë e zbritjes së normës bazë të interesit nga BQE ndikoi në rënien e të ardhurave nga interesi nga këto plasmane. Të hyrat e sektorit bankar gjatë gjashtëmujorit të parë të 2010 janë ndikuar negativisht edhe nga të hyrat tjera që shënuan një rënie vjetore prej 80 përqind në qershor 2010 (Figura 22). Nga ana tjetër, investimet e sektorit bankar në letra me vlerë përcollën një trend rritës gjatë vitit 2010, që ndikoi pozitivisht në nivelin e përgjithshëm të të hyrave.

Figura 22. Trendi i të hyrave nga jointerisi, në përqindje




Burimi: BQK (2010)

sektorit bankar, të hyrat nga interesi në kredi vazhdojnë të jenë kategoria dominuese me pjesëmarrje prej 79.3 përqind në gjithsej të hyrat e sektorit bankar (Figura 23). Struktura e të hyrave të sektorit bankar reflekton strukturën e bilancit të saj, ku kreditë përfaqësojnë pjesën dërmuese të aseteve të këtij sektori. Sidoqoftë, varësia e lartë e të hyrave nga një burim bënë që sektori të jetë më i ndjeshëm ndaj zhvillimeve në segmente të caktuara të tregut. Kjo ishte e evidente në dy vitet e fundit, kur ngadalësimi i kredidhënies shkaktoi ngadalësim të theksuar të trendit të rritjes së të hyrave. Burim tjetër i rëndësishëm i të hyrave të sistemit bankar janë edhe tarifat dhe komisionet e ndryshme në produktet bankare, të cilat në gjashtëmuorin e parë të vitit gjeneruan 16.8 përqind të gjithsej të hyrave.


Që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar të Kosovës, shpenzimet e këtij sektori për herë të parë shënuan rënie gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Në qershor 2010, shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën prej 83.8 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 6.5 përqind. Zvogëlimi i shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht u bazua në zvogëlimin e shpenzimeve operative, me qëllim të ruajtjes së efikasitetit të sektorit. Në këtë kontekst, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të sektorit bankar në qershor 2010 shënuan një rënie vjetore prej 11.6 përqind (Figura 24). Në kuadër të këtyre shpenzimeve, shkurtim më i theksuar u vërejt në shpenzimet tjera jo-interes të cilat u zvogëluan për 50 përqind, përderisa shpenzimet e personelit u rritën me vetëm 0.6 përqind (20.4 përqind në qershor 2009). Në kuadër të shpenzimeve jo-interes, në masën më të madhe u zvogëluan shpenzimet e provizioneve për humbje nga kreditë, të cilat shënuan një rënie vjetore prej 33.2 përqind. Zvogëlimi i këtyre shpenzimeve ka ndodhur përkundër faktit se pjesëmarrja e kredive jo-performuese në gjithsej kreditë në qershor 2010 ishte më e lartë se sa në qershor 2009. Kjo ka ndodhur për shkak që rritja e kredive jo-performuese ka ndodhur gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, kur edhe janë ndarë provizionet për humbje nga kreditë. Në anën tjetër, shpenzimet e interesit shënuan ngritje, e cila kryesisht i atribuohet shpenzimeve për interes në depozita që shënuan një ngritje vjetore prej 13.3 përqind. Rritja e shpenzimeve për interes në depozita ka rezultuar nga rritja e vlerës së depozitave gjatë kësaj periudhe, përderisa normat e interesit në depozita shënuan një rënie të lehtë.

Figura 23. Struktura e të hyrave e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

Figura 24. Trendi i shpenzimeve i sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2010)




Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2010 vazhdoi të jetë e ngjashme me periudhat e kaluara (Figura 25). Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative vazhdojnë të përbëjnë kategorinë më të madhe, me një pjesëmarrje prej 50.3 përqind në gjithsej shpenzimet e sektorit bankar (53.2 përqind në qershor 2009). Kategoria e dytë e shpenzimeve të sektorit bankar për nga madhësia janë shpenzimet e interesit, të cilat gjatë kësaj periudhe ngritën pjesëmarrjen në 33.9 përqind të gjithsej të hyrave (27.4 përqind në qershor 2009). Ndërsa, pjesëmarrja e shpenzimeve jo-interes u zvogëlua në 15.8 përqind të gjithsej shpenzimeve (19.3 përqind në qershor 2009).

Masat e ndërmara nga sektori bankar për shkurtimin e shpenzimeve kanë ndikuar në përmirësimin e disa indikatorëve të efikasitetit për këtë sektor. Në këtë kontekst, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave të sektorit bankar, në qershor 2010, u zvogëlua në 81.2 përqind nga 87.9 përqind në qershor 2009 (Figura 26). Po ashtu, zvogëlimi i numrit të të punësuarve në sektorin bankar ndikoi që vlera mesatare e aseteve të menaxhuara nga një punëtor të rritet në 638 mijë euro nga 504 mijë euro sa ishte në qershor 2009 (Tabela 7). Efikasiteti i sektorit bankar u përmirësua edhe për sa i përket numrit mesatar të kredive të lëshuara për një punëtor. Sidoqoftë, norma më e ulët e rritjes së të hyrave të sektorit bankar krahasuar me normën e rritjes së gjithsej aseteve mund të interpretohet si rënie e efikasitetit. Raporti ndërmjet të hyrave të sektorit bankar dhe gjithsej vlerës së aseteve, në qershor 2010, u zvogëlua në 4.6 përqind nga 5.3 përqind në qershor 2009. Rënia e këtij treguesi sugjeron se sektori bankar ka qenë më pak efikas në gjenerimin e të hyrave nga shfrytëzimi i aseteve.


Norma më e lartë e rritjes së shpenzimeve të interesit krahasuar me normën e rritjes së të hyrave nga interesi ka ndikuar në rënien e Margjinës Neto të Interesit (MNI), që paraqet dallimin ndërmjet të hyrave nga interesi dhe shpenzimeve të interesit në raport me asetet e bankave që sjellin interes. MNI ka shënuar rënie në 3.0 përqind në qershor 2010 nga 3.5 përqind në qershor 2009 (Tabela 7). Zvogëlimi i MNI-së pasqyron normën më të lartë të rritjes së vlerës së depozitave krahasuar me vlerën e rritjes së kredisë, përdërisa normat e interesit në kredi dhe depozita ishin kryesisht stabile.

Figura 25. Struktura e shpenzimeve e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

Figura 26. Trendet e të hyrave dhe shpenzimeve, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

Tabela 7. Treguesit e efikasitetit të sektorit bankar, në mijëra euro, vetëm nëse çeket ndryshe

Përshkrimi	qershor 2007	qershor 2008	qershor 2009	qershor 2010
Asete/Nr. i punëtorëve	446.3	467.6	503.6	637.9
Profiti për nr. të punëtorëve	7.1	6.9	3.2	5.4
Numri i kredive/nr. i punëtorëve	45.4	68	66.6	75.8
Margjina Neto e Interesit (në përqindje)	3.9	4.1	3.4	3.0


Burimi: BQK (2010)

## 6.4 Normat e interesit

Norma mesatare e interesit në kredi (mesatarja lëvizëse 12 mujore) ka ndjekur një trend stabil, duke qëndruar në nivelin prej 14.3 përqind në qershor 2010 krahasuar me 14.4 përqind sa ishte në qershor 2009 (Figura 27).<sup>5</sup> Kreditë për ndërmarrje edhe më tej përmbajnë norma më të larta të interesit se sa kreditë për ekonomitë familjare. Një prej arsyeve që mund të ketë ndikuar në qasje më konzervative të bankave ndaj bizneseve, është ndjeshmëria më e lartë e bizneseve ndaj tronditjeve në ekonomi si dhe profili më i lartë i rrezikut të projektet që ndërmarrin bizneset. Në qershor 2010, norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve në qershor 2010 ishte 16.7 përqind, ndërsa norma mesatare e interesit për kreditë e ekonomive familjare ishte 12.2 përqind. Në kuadër kredive për ndërmarrjet, normat më të larta të interesit vërehen te kreditë për qëllime investuese.

Pas një periudhe me rritje të vazhdueshme, normat e interesit në depozita shënuan rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Norma mesatare e interesit në depozita (mesatarja lëvizëse 12 mujore) në qershor 2010 ishte 4.0 përqind, krahasuar me 4.4 përqind në qershor 2009. Zvogëlimi i normës së interesit në depozita mund të jetë rezultat i ngadalësimit të kredidhënies nga sektori bankar, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e kërkesës për depozita. Sektori bankar i Kosovës ofron norma më të larta të interesit për depozitat e ndërmarrjeve gjë që mund të jetë rezultat i shumave më të larta të depozitave që pranohen nga ky sektor. Norma mesatare më e lartë për depozitat e ndërmarrjeve në qershor 2010 ishte 5.27 përqind, që ofrohet për depozitat e ndërmarrjeve në vlerë deri në 250 mijë euro dhe me afat maturimi 6 deri 12 muaj. Sa i përket depozitave të ekonomive familjare, norma më e lartë mesatare arrinë në 5.22 përqind për depozitat me afat maturimi mbi dy vite.

Figura 27. Mesatarja lëvizëse 12 mujore e normave të interesit



Burimi: BQK

<sup>5</sup> Normat e interesit të kredive dhe depozitave paraqesin mesataret lëvizëse 12 mujore.

Dallimi ndërmjet normave të interesit në depozita në përgjithësi është karakterizuar me trend rënës që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të normave të interesit në kredi, por edhe rritjes së normave të interesit në depozita. Ecuria e normave të interesit në Kosovë diktohet nga një numër i faktorëve, të cilët në radhë të parë përbëhen nga relacionet ndërmjet ofertës dhe kërkesës për kredi dhe depozita në treg. Normat e interesit, posaçërisht ato në kredi, në masë të madhe varen po ashtu nga faktorë të cilët janë nën kontrollin e bankave si dhe nga faktorë jashtë kontrollit të tyre. Ndërsa, ndikimi i Bankës Qendrore përmes instrumenteve të politikës monetare është shumë i kufizuar si pasojë e euroizimit të ekonomisë, gjë që ka eliminuar instrumentet tradicionale të bankave qendrore emetuese për të ndikuar mbi normat e interesit. Andaj, zvogëlimi i mëtutjeshëm i kostos së financimit në Kosovë para se gjithash varet nga faktorët që janë nën kontrollin e sektorit bankar, siç janë rritja e efikasitetit në këtë sektor që kontribuon në zvogëlimin e shpenzimeve të bankave dhe rrjedhimisht në zvogëlimin e çmimeve të produkteve bankare. Ndikim të rëndësishëm në normat e interesit në kredi ka edhe ambienti në të cilin operon sektori bankar, që në masë të madhe dikton shkallën e rrezikut të perceptuar nga bankat. Përmirësimi i ambientit të përgjithshëm afarist në vend është faktor themelor për zvogëlimin e rrezikut kreditor, që paraqet një ndër faktorët kryesor për përcaktimin e normës së interesit në kredi. Në këtë drejtim, rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor do lehtësonte ekzekutimin e kolateralit, duke ndikuar kështu në rritjen e efikasitetit të bankave dhe zvogëlimin e rrezikut kreditor. Po ashtu, përmirësimi i raportimit financiar nga ana e bizneseve do të ndikonte pozitivisht në rritjen e besimit të bankave ndaj këtyre raporteve, duke zvogëluar kështu kostot e monitorimit të bankat. Një faktor tjetër i rëndësishëm për zvogëlimin e rrezikut kreditor është edhe avancimi i qeverisjes korporative të bizneseve, përfshirë këtu ngritjen e kapaciteteve planifikuese.


## 6.5. Risqet e sektorit bankar

### 6.5.1. Risku i likuiditetit

Burimi kryesor i financimit për sistemin bankar të Kosovës mbeten depozitat. Në qershor 2009, depozitat përfaqësuan 79 përqind të gjithë detyrimeve të sektorit bankar. Ndërsa, pjesa tjetër e financimit të operacioneve bankare përbëhet nga burimet vetanake që përfaqësojnë 10 përqind të gjithë detyrimeve, si dhe borxhi i ndërvarur 1.1 përqind. Bankat që operojnë në Kosovë pjesën më të madhe të fondeve e sigurojnë nga burimet vendore dhe rrjedhimisht nuk janë të varura nga fondet jashtë vendit. Rrjedhimisht, mungesa e likuiditetit në tregjet financiare ndërkombëtare, si pasojë e krizës globale, nuk kishte ndonjë ndikim substancial në sektorin bankar të Kosovës.

Shkalla e likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës në vazhdimësi është karakterizuar me nivel të kënaqshëm. Të gjitha bankat që operojnë në vendin tonë kanë raportuar përmirësim të treguesve të likuiditetit, gjë që paraqet një zhvillim pozitiv

Figura 28. Kredit dhe depozitat e sektorit bankar



Burimi: BQK (2010)


për qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Norma më e lartë e rritjes së depozitave krahasuar me normën e rritjes së kredisë ka bërë që raporti kredi-depozita të shënojë rënie. Në qershor 2010, raporti kredi-depozita qëndroi në 80.2 përqind, përderisa në qershor 2009 ky raport ishte 84.7 përqind (Figura 28). Raporti aktual ndërmjet kredive dhe depozitave është në pajtim me udhëzimet e Bankës Qendrore, të cilat rekomandojnë që bankat komerciale që operojnë në Kosovë mesatarisht të kenë një raport kredi-depozita prej rreth 80 përqind. Niveli i tanishëm i raportit kredi-depozita zvogëlon nevojën e bankave për të huazuar fonde afatshkurtra për të ngritur likuiditetin, fonde këto që bartin edhe kosto më të lartë të financimit.

Ngadalësimi i rritjes së kredisë është reflektuar në pjesëmarrjen e asetëve likuide në gjithsej asetet e sektorit bankar. Në qershor 2010, pjesëmarrja e asetëve likuide në gjithsej asetet qëndronte në 34.4 përqind, që paraqet një rritje prej 5pp krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky nivel i pjesëmarrjes së asetëve likuide në gjithsej asetet tregon për një situatë kënaqshme të likuiditetit në sektorin bankar. Në qershor 2010, raporti ndërmjet asetëve likuide dhe detyrimeve afatshkurtëra ishte 67 përqind, kundrejt 64 përqind sa ishte në qershor të vitit 2009. Ky tregues tregon aftësinë e sektorit bankar për të mbuluar detyrimet afatshkurtëra përmes asetëve likuide. Përmirësimi i këtij treguesi ishte si rezultat i rritjes më të shpejtë të asetëve likuide, të cilat shënuan rritje vjetore prej 35.4 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 29.2 përqind për detyrimet afatshkurtaëra.

Rritja e asetëve likuide në sektorin bankar të Kosovës në masë të madhe reflekton ngadalësimin e kredidhënies nga sektori bankar, që nënkupton se një pjesë e fondeve që do të mund të shfrytëzohej për të kredituar ekonominë vendore, tani po investohet në asete siç janë letrat me vlerë dhe plasmanet në bankat komerciale jashtë vendit, asete këto që konsiderohen të jenë më likuide se sa kreditë. Një faktor që mund të ketë ndikuar në rritjen e likuiditetit të bankave ishte edhe anticipimi i tërheqjes së depozitave të PTK-së nga sektori bankar. Që nga tetori i vitit 2009, një pjesë e konsiderueshme e këtyre depozitave janë transferuar nga llogaria e PTK-së në llogaritë e Qeverisë së Kosovës në bankat komerciale. Mundësia e tërheqjes së menjëhershme të këtyre mjeteve krijonte risk potencial për likuiditetin e disa bankave. Kështu, bankat u treguan të kujdesshme duke ndarë mjete shtesë si rezerva në BQK. Në fund të vitit 2009, rezervat e bankave komerciale në BQK tejkalonin për 126.2 milion euro nivelin e rezervës së detyrueshme. Në qershor 2010, bilanci me BQK-në ishte 216.9 milionë euro ose 57 milionë më shumë se rezerva e detyrueshme sipas rregullave në fuqi (Figura 29).


Struktura e asetëve likuide të sektorit bankar të Kosovës përbëhet nga paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, bilanci me bankat komerciale jashtë vendit si dhe investimet në letra me vlerë (Figura 30). Gjatë periudhës qershor 2009-qershor 2010, kategoria 'paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në' nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar. Ndryshim më i theksuar në strukturën e asetëve ishte zhvendosja e fondeve nga kategoria bilanci me

Figure 29. Rezervat e sektorit bankar



bankat komerciale drejtë investimeve në letra me vlerë. Asetet në kategorinë bilanci me bankat komerciale u rritën nga 200 milionë euro sa ishin në qershor 2009 në 351 milionë euro në qershor 2010, që paraqet një rritje prej 22 përqind. Në mungesëtë tregut ndërbankar në Kosovë, mjetet në kategorinë bilanci me bankat komerciale janë të investuara si plasmane në bankat jashtë vendit. Megjithatë rritja ishte më e theksuar në investimet në letra me vlerë. Në qershor 2010, investimet në letra me vlerë arritën vlerën prej 114 milion euro nga 13.3 milionë euro sa ishin në qershor 2009. Pritjet më optimiste për performancën e tregjeve financiare ishin faktor determinues për rritjen e investimeve në letra me vlerë nga ana e bankave. Ky zhvillim është i arsyeshëm duke marrë parasysh se tregjet financiare ndërkombëtare u karakterizuan me rimëkëmbje gjatë kësaj periudhe. Mirëpo, duhet të potencohet se rritja e këtyre investimeve kufizon mjetet e sektorit bankar në dispozicion për kreditimin e ekonomisë vendore.


Figura 30. Asetet likuide, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

Struktura e investimeve të bankave në letra me vlerë kryesisht përqendrohet në tri kategori kryesore, të cilat përbëhen nga investimet në fletëobligacione të qeverive, të korporatave financiare dhe të korporatave jo-financiare. Në Figurën 31 mund të vërehet se kemi një zhvendosje nga investimet në letra me vlerë të korporatave financiare në letra me vlerë të qeverive. Përderisa në vitin 2009, 98.1 përqind e investimeve të bankave komerciale në letra me vlerë përbëheshin nga fletëobligacionet e korporatave financiare, në qershor 2010, 81.5 përqind e këtyre investimeve përbëheshin nga fletëobligacionet qeveritare. Pjesëmarrja e fletëobligacioneve të korporatave financiare në gjithsej letrat me vlerë, në qershor 2010 ishte vetëm 18.2 përqind. Ndërsa, investimet e bankave në fletëobligacione të korporatave jo-financiare përfaqësojnë vetëm 0.3 përqind të gjithsej investimeve të tyre në letra me vlerë. Zhvendosja e investimeve të bankave nga fletëobligacionet e korporatave financiare drejtë atyre qeveritare mund ti atribuohet rritjes së premieeve për fletëobligacionet e disa qeverive të jashtme gjatë kësaj periudhe.

Figura 31. Struktura e letrave me vlerë




Burimi: BQK (2010)

Mospërputhja e afatit të maturimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve përfaqëson një tjetër aspekt të rëndësishëm të rrezikut të likuiditetit. Një mospërputhje e më e theksuar e afatit të maturimit është vënë re te afati i maturimit prej 'më shumë se 1 vit', ku vlera e aseteve që kanë këtë afat maturimi në masë të konsiderueshme tejkalon vlerën e detyrimeve (Figura 32). Mospërputhja e afatit të maturimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve kryesisht

pasqyron dallimet në mes të afatit të maturimit të kredive dhe depozitave, duke qenë se ato përbëjnë pjesën më të madhe të asetëve, përkatësisht, detyrimeve. Në qershor 2010, 53 përqind e gjithsej kredive kishin afat maturimi prej 'më shumë se 1 vit', ndërsa 98.4 përqind e depozitave kishin afat maturimi prej 'më pak se 1 vit'. Aktiviteti i sektorit bankar duhet të përqendrohet më shumë në tërheqjen e detyrimeve me afat maturimi më të gjatë, gjë që do ngushonte hendekun e afatit të maturimit, dhe në këtë mënyrë do të zvogëlonte rrezikun e likuiditetit. Për më tepër, rritja e fondeve me afat maturimi më të gjatë siguron një rritje më të qëndrueshme të kreditimit afatgjatë.

Figura 32. Hendeku i likuiditetit, diferenca në mes gjithsej asetëve dhe gjithsej detyrimeve sipas maturitet (në mil. euro)




Burimi: BQK (2010)

### 6.5.2. Rreziku kreditor

Përkundër performancës më të mirë të ekonomisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, sektori bankar i Kosovës vazhdoi shtrëngimin e kredidhënies. Kjo reflekton qasjen më konzervative të ndjekur nga bankat për menaxhimin e rrezikut kreditor si rezultat i krizës globale. Me gjithë normën pozitive të rritjes ekonomike që është regjistruar në Kosovë gjatë vitit 2009, si dhe parashikimeve për rritje edhe më të lartë gjatë vitit 2010, efektet e krizës globale u reflektuan edhe në Kosovë, duke shkaktuar ngadalësim të rritjes ekonomike. Kjo mund të ketë ndikuar negativisht aftësinë paguese të kredimarrësve, duke rezultuar në përkeqësim të cilësisë së kredive në portofolin kreditor të sektorit bankar të Kosovës.

Figura 33. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2010)

Sa i përket strukturës së kredive sipas klasifikimit në bazë të cilësisë, vërehet një zhvendosje e lehtë e kredive nga kategoria standarde (që paraqet kreditë të cilat nuk kanë probleme të kthimit) drejtë kategorive që karakterizohen me cilësi më të dobët.<sup>6</sup> Në qershor 2010, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara si nënstandarde në gjithsej kreditë ka shënuar rritje prej 0.8pp krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, kategoria e kredive vrojtuese dhe standarde kanë shënuar një rënie modeste (Figura 33).


<sup>6</sup> Bazuar në rregulloret e BQK, kreditë në sektorin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë e klasifikuara përfshijnë kategoritë: vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë me probleme përfshijnë kategoritë: nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë joperformuese përfshijnë kategoritë: të dyshimta dhe të humbura.

Në qershor 2010, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara në gjithsej portofolin kreditor u ngrit në 10.2 përqind nga 9 përqind sa ishin në qershor 2009, duke treguar për një përkesëim të lehtë të cilësisë së kredive. Po ashtu, pjesëmarrja e kredive me probleme në gjithsej kreditë, në qershor 2010, ishte 7.1 përqind (5.6 përqind në qershor 2009).

Grupimi më i rëndësishëm i kredive për sa i përket cilësisë së tyre përfaqësohet nga Kreditë Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL). Në qershor 2010, pjesëmarrja e NPL në gjithsej portofolin kreditor të sektorit bankar të Kosovës arriti në 4.5 përqind, që paraqet një rritje prej 0.6pp krahasuar me qershor 2009 (Figura 34). Gjatë periudhës 2008-2010, norma mesatare e rritjes vjetore të vlerës së NPL ishte 26.8 përqind, përderisa norma mesatare e rritjes së nivelit të përgjithshëm të kredisë ishte 22 përqind. Vazhdimi i këtij trendi nënkupton vazhdim të rënies së cilësisë së portofolit kreditor, andaj parashtrohet nevoja që zgjerimi i mëtutjeshëm i kreditimit nga bankat të bëhet në suaza të kreditimit të shëndoshë. Nga gjithsej tetë banka sa operojnë në Kosovë, në qershor 2010, katër prej tyre shënuan përmirësim në cilësinë e portofolit kreditor, ndërsa në tri banka u evidentua rritje e pjesëmarrjes së NPL në gjithsej portofolin. Struktura e NPL dominohet kryesisht nga kreditë e klasifikuara si të humbura, të cilat në qershor 2010 përfaqësonin 61 përqind të gjithsej NPL, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga kreditë e kategorizuara si të dyshimta (Figura 35). Gjatë kësaj periudhe, kreditë e dyshimta u rritën për 30.8 përqind (6 milionë euro), ndërsa kreditë e humbura për 22.5 përqind (7 milionë euro) në krahasim me vitin paraprak.


Përkeqësimi i cilësisë është vërejtur si te kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare ashtu edhe te kreditë për ndërmarrjet. Sidoqoftë, përkeqësimi i cilësisë paraqitet të jetë më i theksuar te kreditë e ndërmarrjeve, gjë që mund të jetë edhe një ndër faktorët që ka shkaktuar shtyrëngim më të theksuar të kredisë për këtë sektor (Figura 36). Në qershor 2010, 5 përqind e gjithsej kredive të lëshuara për ndërmarrjet ishin kredi joperformuese që, krahasuar me vitin e kaluar, paraqet një rritje prej 1.3pp. Ndërsa, nga gjithsej kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare, 1.2 përqind e tyre ishin kredi joperformuese (1 përqind në qershor 2009). Bazuar në strukturën e NPL, kreditë për ndërmarrjet paraqiten të jenë më problematike për sa i përket kthimit.

Figura 34. Gjithsej kreditë dhe NPL-të



Burimi: BQK (2010)

Figura 35. Struktura e kredive joperformuese (në mil. euro)




Burimi: BQK (2010)

Rritja e NPL ishte prezente në të gjithë sektorët e ekonomisë. Sidoqoftë, përkeqësimi i cilësisë ishte më i theksuar te kreditë e sektorit të ndërtimtarisë dhe prodhimitarisë (Figura 37). Pjesëmarrja e NPL në gjithsej kreditë e lëshuara për sektorin e ndërtimtarisë u rrit nga 1.5 përqind sa ishte në qershor 2010 në 4 përqind në qershor 2010. Ndërsa në sektorin e prodhimitarisë, NPL rritën pjesëmarrjen nga 7.5 përqind në 9.7 përqind. Devijimi i cilësisë së kredive për këto kategori kryesisht ndërlidhet me zhvillimet në ekonominë globale si rezultat i krizës. Në këtë kontekst, rritja e NPL te kreditë e sektorit të ndërtimtarisë deri në një masë mund ti atribuohet rënies së blerjes së banesave në Kosovë, që deri në një masë mund të ketë rezultuar prej rënies së blerjeve nga emigrantët Kosovarë. Po ashtu, zvogëlimi i kërkesës për eksportet Kosovare mund të ketë ndikuar negativisht aftësinë e industrisë prodhuese në vend për të kthyer kreditë, duke ndikuar kështu në rritjen e NPL te kreditë e këtij sektori. Sektori i prodhimitarisë njëherësh paraqet sektorin më problematik në ekonominë e Kosovës për sa i përket kthimit të kredive. Nivel të lartë të NPL kanë edhe kreditë e lëshuara për sektorin e minierave dhe energjisë. Sidoqoftë, sektori bankar ka një ekspozim kreditor mjaft të ulët ndaj këtij sektori. Gjithsej kreditë e lëshuara për sektorin e minierave dhe të energjisë në qershor 2010 përbënin vetëm 2 përqind të gjithsej kredive.

Definicioni i NPL në sektorin bankar të Kosovës, përpos vonesave në kthimin e kredisë merr për bazë edhe faktorë tjerë që ndërlidhen me performancën financiare të kredimarrësit. Rritja e NPL mund të reflektojë edhe perceptimet e bankave dhe të rregullatorit mbi rritjen e pasigurisë në sektorin real të ekonomisë si rezultat i efekteve të krizës, gjë që ndikon klasifikimin e rrezikut kreditor.


Figura 36. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2010)


Në këtë kontekst, rritja e NPL te kreditë e sektorit të ndërtimtarisë deri në një masë mund ti atribuohet rënies së blerjes së banesave në Kosovë, që deri në një masë mund të ketë rezultuar prej rënies së blerjeve nga emigrantët Kosovarë.

Figura 37. NPL-të sipas industrive



Burimi: BQK (2010)

Figura 38. Struktura e kredive mbi 90 ditë sipas industrive




Burimi: BQK (2010)



Shikuar vetëm aspektin e vonesave në kthimin e kredive, vërehet se pjesëmarrja e kredive me vonesa në gjithsej portofolin kreditor të sektorit bankar në qershor 2010 u zvogëlua në 3.5 përqind, krahasuar me 3.7 përqind në qershor në 2009. Struktura e kredive që kanë qenë në vonesë për një periudhë prej mbi 90 ditë, dominohet nga kreditë që i janë lëshuar sektorit të ndërtimtarisë, të cilat përbëjnë 36 përqind të këtyre kredive, pasuar nga kreditë lëshuar sektorit të prodhimtarisë, të cilat përfaqësohen me 28.3 përqind (Figura 38). Nga kjo mund të vërehet që kreditë e sektorit prodhues, përfaqësojnë një pjesë më të madhe të kredive me vonesa si dhe të NPL. Kjo mund të ndikojë perceptimin e bankave dhe të rregullatorit mbi dështimin e mundshëm të kredive për sektorin prodhues, gjë që mund të ndikojë edhe në normat e interesit për kreditë e këtij sektori. Kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare duket të kenë cilësi më të mirë edhe për sa i përket vonesave. Në qershor 2010, vetëm 4.5 përqind e gjithsej kredive që ishin në vonesë prej mbi 90 ditë përbëheshin nga kreditë që i ishin lëshuar ekonomive familjare (2.67 përqind në qershor 2009). Sektori i ekonomive familjare konsiderohet nga bankat si sektor me nivel më të ulët të riskut, gjë reflektohet edhe normat më të ulëta të interesit për kreditë e ekonomive familjare krahasuar me ato të ndërmarrjeve.

Përkundër rritjes së pjesëmarrjes së NPL në gjithsej portofolin kreditor, sektori bankar i Kosovës në vazhdimësi ka mbajtur nivel të lartë të mbulimit të NPL me provizione për humbje nga kreditë. Në qershor 2010, shkalla e mbulueshmërisë së kredive me provizione ishte 135 përqind, ndërsa mesatarja për katër vitet e fundit ishte 129 përqind (Figura 39). Shuma e përgjithshme e provizioneve në qershor 2010 arriti në rreth 75 milionë euro ose për 22.8 milionë euro më e lartë se sa në vitin paraprak.

Figura 39. NPL-të dhe provizionet




Burimi: BQK (2010)

### Koncentrimi i riskut kreditor

Analiza e koncentrimin të riskut kreditor mundëson identifikimin e dobësive të mundshme të sektorit bankar që mund të rrjedhin nga ekspozimet e mëdha kreditore, të cilat mund të kërcënojnë stabilitetin e sektorit në rast të dështimit të tyre. Rritja e ekspozimeve të mëdha paraqet nivel më të lartë të rrezikut kreditor, pasi që në këtë mënyrë sistemi bëhet më i ndjeshëm ndaj performancës së një numri të caktuar të kredive, të cilat kanë peshë më të madhe në gjithsej portofolin kreditor. Në këtë kontekst, rritja e koncentrimin të rrezikut kreditor paraqet ndjeshmëri më të lartë të sistemit bankar ndaj performancës së një dege të caktuar të

Figura 40. Koncentrimi i riskut kreditor



Burimi: BQK (2010)

industrisë apo një grupi të caktuar të kredimarrësve.


Sipas rregulloreve të BQK-së, kreditë të cilat tejkalojnë 10 përqind të kapitalit të klasit të parë klasifikohen si ekspozime të mëdha. Në qershor 2010, shumica e kredive që konsideroheshin si ekspozime të mëdha u rritë në 88.4 milionë euro (83.6 milion euro në qershor 2009), përderisa numri i ekspozimeve të mëdha arriti në 45 nga 20 sa ishte në qershor 2009 (Figura 40). Megjithatë, raporti ndërmjet gjithsej ekspozimeve të mëdha dhe kapitalit të klasit të parë u zvogëlua në 39.9 përqind, nga 41.4 përqind në qershor 2009, gjë që mund të interpretohet si zvogëlim i riskut kreditor.

### 6.5.3. Risku i solvencës

#### Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR)<sup>7</sup> në sistemin bankar të Kosovës në qershor 2010 është rritur në 18.7 përqind krahasuar me 17.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 41). Ky nivel është mjaft i kënaqshëm duke marrë parasysh se dukshëm tejkalon normën minimale prej 12 përqind të përcaktuar nga Banka Qendrore. Rritja e CAR ishte kryesisht rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kapitalit në krahasim me rritjen e asetëve të peshuara ndaj riskut (Risk Weighted Assets RWA). Përderisa norma vjetore e rritjes së kapitalit ishte 12.8 përqind, RWA shënuan një rritje vjetore prej vetëm 4.8 përqind.

Figura 41. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK (2010)

Ngadalësimi i normës së rritjes së RWA reflekton ngadalësimin e normës së rritjes së kredive, të cilat paraqesin komponentin kryesor të RWA.

Tabela 8. Distribucioni i asetëve sipas shkallës së CAR

Përshkrimi	Numri i Bankave			Përqindja e gjithsej asetëve të menaxhuara nga bankat		
	12-15 %	15-18%	> 18 %	12-15 %	15-18%	> 18 %
2007	1	1	4	40.0%	35.5%	24.5%
2008	1	1	6	38.9%	35.6%	25.5%
2009	0	6	2	0.0%	84.6%	15.4%
2010	3	1	4	13.9%	14.7%	71.4%

Burimi: BQK (2010)

<sup>7</sup> Sipas rregullave të BQK, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA

Përderisa në qershor 2009 shumica aseteve të sektorit bankar menaxhoheshin nga bankat me CAR prej 15-18 përqind, në vitin 2010, rreth 71 përqind e gjithsej aseteve menaxhohej nga bankat me nivel të CAR më të lartë se 18 përqind (Tabela 8). Normat e larta të CAR në bankat komerciale që operojnë në Kosovë tregojnë për nivel të lartë të kapitalizimit, gjë ngritë aftësinë e këtij sektori për të përballuar tronditjet potenciale.


## Kapitali

Në qershor 2010, kapitali i sektorit bankar arriti vlerën prej 259.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga figura 42 mund të vërehet se gjatë tri viteve të fundit kapitali i sektorit bankar ka shënuar rritje të vazhdueshme, por norma e rritjes së tij ka ndjekur një trend rënës.

Kapitali rregullativ në sistemin bankar të Kosovës kryesisht është financiar përmes kapitalit aksionar dhe fitimit të mbajtur nga bankat. Veç kësaj, bankat gjatë viteve të fundit kanë filluar të shfrytëzojnë edhe forma të financimit nga jashtë për të ngritur kapitalin, si për shembull duke pranuar më tepër borxh të ndërvarur, që është pjesë e kapitalit të klasit të dytë. Mund të theksohet se bankat ende nuk përdorin instrumente hibride financiare, të cilat mund të bartin nivel më të lartë të rrezikut.

Shkalla e pjesëmarrjes së kapitalit aksionar në raport me gjithsej kapitalin reflekton edhe cilësinë e kapitalit rregullativ. Sa më e lartë që të jetë pjesëmarrja e kapitalit aksionar në kapitalin rregullativ aq më e mirë vlerësohet të jetë cilësia e kapitalit. Cilësia e kapitalit, përveç që ka rëndësi të madhe për aftësinë e sektorit bankar që të përballojë tronditjet potenciale, paraqet një element shumë të rëndësishëm edhe për rankimin kreditor të bankave, duke ndikuar kështu mundësinë më të madhe dhe koston më të ulët të qasjes në financim të jashtëm për bankat komerciale. Në qershor 2010, pjesëmarrja e kapitalit aksionar në gjithsej kapitalin rregullativ shënoi një rënie të lehtë duke qëndruar në 85 përqind (88 përqind në qershor 2009). Zvogëlimi ka ndodhur për shkak të rritjes së pjesëmarrjes së kapitalit të klasit të dytë në gjithsej kapitalin nga 12 përqind sa ishte në qershor 2009 në 15 përqind në qershor 2010. Rritja e kapitalit të klasit të dytë kryesisht ka rezultuar nga rritja e borxhit të ndërvarur.

Figura 42. Gjithsej kapitali i sektorit bankar




Burimi: BQK (2010)

## Kapitali i klasit të parë

Në qershor 2010, kapitali i klasit të parë arriti vlerën prej 220.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.6 përqind. Struktura e kapitalit të klasit të parë vazhdon të dominohet nga kapitali aksionar, që në qershor 2010 përfaqësoi 73 përqind të kësaj kategorie të kapitalit, ndërsa kategoria e dytë për nga madhësia përbëhet nga fitimi i pashpërndarë i cili në këtë periudhë përfaqësoi 26 përqind të gjithsej kapitalit të klasit të parë. Mjetet jo materiale (angl. intangible assets) dhe vlera e emrit të mirë (angl. goodwill) rritën pjesëmarrjen nga 0.4 përqind sa ishin në vitin 2009 në 1 përqind në qershor të vitit 2010 (Figura 43).

Figura 43. Struktura e kapitalit të klasit të parë (në mil. euro)




Burimi: BQK (2010)

Në qershor 2010, kapitali aksionar shënoi vlerën prej 164.4 milionë euro ose 10 përqind më i lartë krahasuar me qershor 2009. Ndërsa, fitimi i pashpërndarë i vitit aktual dhe fondet rezervë u rritën nga 54.4 milionë euro sa ishin në qershor 2009 në 59.4 milion euro në qershor 2010, duke shënuar një rritje vjetore prej 9.1 përqind (2.1 përqind në qershor 2009) si rezultat i rritjes së fitimit të realizuar nga sektori bankat gjatë gjysmës së partë të vitit 2010. Mjetet jo materiale dhe vlera e emrit të mirë, të cilat sipas rregullave të BQK-së zbriten nga kapitali i klasit të parë, u rriten nga 820 mijë euro në qershor 2009 në 3.28 milionë euro qershor 2010.

### Kapitali rregullativ

Sektori bankar i Kosovës vazhdimisht ka ruajtur një nivel të kapitalit përtej nivelit të kërkuar nga Banka Qendrore. Në qershor të vitit 2010, kapitali i kërkuar rregullativ ishte 166.1 milion euro, ndërsa gjithsej kapitali rregullator i mbajtur nga ana e sektorit bankar ishte 259.3 euro, që paraqet një tepriçë të kapitalit në vlerë prej 93.3 milion euro (Figura 44). Kapitali tepriçë i mbajtur nga bankat, në qershor 2010, përbënte 56.1 përqind të kapitalit të kërkuar rregullativ, që është një rritje prej 10.9pp krahasuar me qershor 2009.

Figura 44. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativë




Burimi: BQK (2010)

## Asetet e përshtatura ndaj riskut

Gjithsej vlera e RWA të sektorit bankar të Kosovës, në qershor 2010, arriti vlerën prej 1.38 miliardë euro. Sidoqoftë, pjesëmarrja e aseteve me peshë të riskut prej 100 përqind në, qershor 2010, u zvogëluua në 69 përqind të gjithsej RWA, krahasuar me 72.8 përqind në qershor 2009 (Figura 45). Zvogëlimi i pjesëmarrjes së kësaj kategorie të RWA kryesisht është rezultat i ngadalësimit të normës së rritjes së kredive, të cilat paraqesin komponentin kryesor të aseteve me peshë të riskut prej 100 përqind. Ndërsa, pjesa tjetër e aseteve me peshë të riskut prej 100 përqind përbëhet nga mjetet fikse edhe patundshmëria në pronësi të bankave. Kategoria e aseteve me peshë të riskut prej 75 përqind shënoi një rritje vjetore prej 14.4 përqind, duke arritur vlerën prej 334.9 milionë euro në qershor 2010. Kjo kategori përbëhet nga kreditë e garantuara me hipotekën e parë në pasuri të patundshme, me vonesë kthimi prej më pak se 30 ditë. Kategoria e mjeteve me peshë të riskut prej 50 përqind<sup>8</sup> shënoi rënien më të theksuar në krahasim me vitin paraprak. Në qershor 2010, vlera e mjeteve me këtë peshë të riskut ishte 5.7 milionë euro apo 69 përqind me e ulët se në qershor 2009.

Figura 45. Struktura e RWA-ve sipas peshës së riskut




Burimi: BQK (2010)

## 6.6. Analiza stres-test

Analiza stres-test ofron informacion mbi qëndrueshmërinë e sistemit bankar nën supozimet për tronditje të jashtëzakonshme negative ndaj sektorit. Stres-testi paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm për menaxhimin e rrezikut në banka individuale, por që shfrytëzohet edhe nga bankat qendrore për të vlerësuar rrezikun në nivel të sistemit. Objektivi kryesor i stres-testit është të shpjegojë ndjeshmërinë e sistemit bankar ndaj lëvizjeve të faktorëve të ndryshëm të rrezikut. Stres-testi mund të aplikohet si në anën e aseteve ashtu edhe në anën e detyrimeve të portofolios së bankave.

<sup>8</sup> Kjo kategori përbëhet nga kërkesat me maturim prej 1 viti ose me pak në bankat që veprojnë në vendet e OECD-së, por që nuk janë të klasifikuara ose që janë ranguar nga Standard & Poor's me B ose me gradë më të ulët; apo që janë klasifikuar nga Moody's me P-3 ose me gradë më të ulët.

Figura 46. Prezentim i thjeshtësuar i metodologjisë së modelit Stres-Test



Burimi: BQK (2010)

Në këtë kontekst, përmes analizës stres-test mund të vlerësohet ndjeshmëria e sistemit bankar ndaj rreziqeve të ndryshme, si për shembull rreziku kreditor (humbjet e mundshme nga rritja e kredive joperformuese), rreziku i likuiditetit (mundësia e tërheqjes së shumave të mëdha të depozitave), rreziku nga normat e interesit (humbjet e mundshme nga ndryshimi i normave të interesit në treg) si dhe rreziku nga norma e këmbimit (humbjet e mundshme nga ndryshimi i normës së këmbimit).

Figura 46 prezenton kanalet përmes së cilave një tronditje në ekonomi do të mund të ndikonte performancën dhe qëndrueshmërinë së sektorit bankar. Për shembull, një tronditje negative në sektorin real të ekonomisë do të ndikonte negativisht performancën e ndërmarrjeve, duke ndikuar kështu aftësinë e tyre për të ripaguar kreditë. Si pasojë, kreditë joperformuese në sektorin bankar do të rriteshin, duke shkaktuar zvogëlim të profitit, rritje të provizioneve për humbje nga kreditë dhe, rrjedhimisht, zvogëlim të kapitalit. Zvogëlimi i kapitalit të sektorit bankar ka implikime negative për qëndrueshmërinë e sektorit pasi që zvogëlon kapacitetin e bankave për të absorbuar tronditjet. Andaj, analiza stres-test paraqet një mundësi të mirë për të ndërlidhur zhvillimet makroekonomike në vend me performancën e sistemit bankar, duke mundësuar vlerësimin e ndjeshmërisë së sistemit bankar ndaj tronditjeve të ndryshme

makroekonomike. Përmes kësaj mundësohet monitorimi dhe anticipimi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) aplikon analizën stres-test për të vlerësuar rrezikun potencial si në banka individuale ashtu edhe në nivel të sistemit. Stres-testi i aplikuar nga BQK-ja kryesisht bazohet në analizën e ndjeshmërisë së bankave ndaj ndryshimit të faktorëve të rrezikut, si rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i normës së interesit, përderisa po bëhen avancime drejtë ndërlidhjes më të mirë të faktorëve të rrezikut të sistemit bankar me zhvillimet makroekonomike në vend. Tronditjet e supozuara në portofolin e sistemit bankar kryesisht janë të bazuara në trendet historike në portofoliot e bankave dhe në metodën e gjykimit mbi zhvillimet e mundshme në të ardhmen. Kjo analizë merr për bazë gjendjen e sistemit bankar në një pikë të caktuar kohore, ndërsa janë bërë avancime drejtë përfshirjes së elementeve dinamike, në mënyrë që të krijohet një platformë më e mirë për anticipimin e zhvillimeve të ardhshme për sa i përket qëndrueshmërisë së sistemit bankar.

Analiza stres-test për sektorin bankar të Kosovës për këtë numër të Raportit të Stabilitetit Financiar është bërë duke marrë për bazë të dhënat për muajin qershor 2010. Në kuadër të kësaj analize është testuar ndjeshmëria e sistemit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, me gjithë faktin se pjesa dërmuese e portofolios është në euro dhe rreziku nga norma e këmbimit është minor, si dhe është testuar ndjeshmëria e sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit.

### **6.6.1 Përcaktimi i përbashkët i rrezikut kreditor, rrezikut nga norma e interesit dhe rrezikut nga norma e këmbimit**

#### **Metodologjia**

Kjo analizë është mbështetur mbi skenarin hipotetik se kriza ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian do të vazhdojë të reflektohet në ekonominë e Kosovës përmes uljes së dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Rrjedhimisht, kjo supozohet të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 4 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar një rënie ekonomike prej 1.2 përqind për vitin 2010, gjë që do të kishte ngritur hendekun e prodhimit për 5.2 përqind. Për të vlerësuar ndikimin e hendekut të prodhimit në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. non-performing loans: NPL) janë shfrytëzuar koeficientët e elasticitetit nga një analizë e papublikuar e FMN-së për disa vende të Evropës qendrore dhe juglindore.<sup>9</sup> Rrjedhimisht, duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, pjesëmarrja e NPL në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.2pp, që paraqet pothuaj një dyfishim të nivelit aktual të NPL. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, ku është supozuar rënie e normave të interesit dhe zhvlerësim i valutës euro ndaj valutave të tjera si rezultat i zhvillimeve në disa vende të

<sup>9</sup> IMF Unpublished Note "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", July 2009.

eurozonës, si për shembull Greqia, ku problemet buxhetore kanë shkaktuar presione negative ndaj euros. Rrjedhimisht, përveç rritjes së pjesëmarrjes së NPL në gjithsej kreditë, në këtë skenar po ashtu është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për 20 përqind<sup>10</sup> si dhe zvogëlimi i normave të interesit për 2.0 pp. Rritja e pjesëmarrjes së NPL në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon humbjet/fitimet në të hyrat neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave. Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se të hyrat nga 'provizionet dhe të ngjashme' dhe të hyrat tjera nga jo-interesi në vitin 2010 do të jenë ekuivalente me 60 përqind të këtyre të hyrave në vitin 2009 (kjo për shkak se është supozuar se nuk ka rritje të kredive – ato mbeten konstant), përderisa komponentet tjera të pasqyrës së të ardhurave janë supozuar të kenë nivel të ngjashëm me ato të vitit 2009.

Rritja e supozuar e NPL është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, nën vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Rritja e NPL është shpërndarë proporcionalisht në dy kategoritë joperformuese, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të NPL në këto kategori. Rritja e NPL reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sistemit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pozicionet e hapura neto në valutë të huaj në fund të qershorit 2010 ishin ekuivalent me vetëm 11 përqind të kapitalit të klasit të parë. Kreditimi në valutë të huaj pothuaj se nuk ekziston, gjë që ndikon në minimizimin e rrezikut nga kursi valutor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave. Megjithatë, pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit, gjë që e bënë sistemin bankar më pak sensitiv ndaj lëvizjeve të normave të interesit në periudhë afatshkurtër.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të rritjes së NPL, zhvlerësimit të valutës euro dhe rënies së normave të interesit në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar, aseteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

## Rezultatet

Rezultatet nga analiza e lartpërmendur tregojnë se niveli i qëndrueshmërisë së sektorit bankar do të kishte nivel të ulët të ndjeshmërisë në rast të paraqitjes së këtij skenari hipotetik. Nën supozimin e paraqitjes së këtij skenari, vetëm njëra nga bankat që operojnë

<sup>10</sup> Supozim i bazuar në të dhënat historike mbi volatilitetin e këmbimit valutor euro-dollar amerikan.



në Kosovë do kishte CAR nën nivelin minimal prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore, ndërsa vlera që do të kërkohej për rikapitalizimin e mundshëm të kësaj banke është vetëm 1.7 milionë euro apo 0.04 përqind e PBB-së (Tabela 9). Në këto rrethana, niveli i ri i pjesëmarrjes së NPL në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të arrinte në 8.7 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i ulët i NPL do të ishte 4.2 përqind dhe niveli më i lartë do të ishte 12.5 përqind. Në rastin kur skenari i njëjtë aplikohet për vitin 2011, duke konsideruar si gjendje fillestare situatën në sektorin bankar në fund të vitit 2010 pas tronditjeve të përfshira në skenarin e lartpërmendur, ndikimi në sektorin bankar paraqitet se do të ishte më i theksuar. Numri i bankave që do të kishin CAR më të ulët se 12 përqind, nën këtë skenar, do të arrinte në katër, ndërsa kapitali i nevojshëm për rikthimin e CAR së këtyre bankave në 12 përqind do të arrinte në 13.1 milionë euro apo 0.3 përqind e PBB-së.

**Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku kreditor**

Përshkrimi	Numri i bankave 1/			CAR			Raporti NPL			Rikapitalizimi 2/	
	CAR <0	CAR 0-8%	CAR 8-12%	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sistemit	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sistemit	Në mijëra euro	Si % e PBB-së
Nivelet aktuale (para goditjeve)	0	0	0	13.2	20.7	18.8	0.8	8.4	4.5		
Rezultatet e makroskenarëve 3/											
2010	0	0	1	10.3	22.9	19.4	4.2	12.5	8.7	1,734.0	0.04
2011	0	2	2	3.6	21.2	16.2	8.7	17.0	13.1	13,156.1	0.29

**Shënim:**

1/ Numri i bankave që bien nën nivelin minimum të kërkuar nga rregullatori.

2/ Gjithsej vlera e kërkuar për rikapitalizimin e bankave, CAR e të cilave bie nën 12 përqind. Vlerat e PBB-së janë projeksione të FMN-së (IMF, 2010c).

3/ Rritja e pjesëmarrjes së NPL, zhvlerësimi i euros, zvogëlimi i normave të interesit.

Pjesëmarrja relativisht e ulët e kredive joperformuese në portofolin kreditor të sistemit bankar (4.5 përqind), mbulesa e tyre e mjaftueshme me provizione për humbje nga kreditë (135 përqind) si dhe niveli i lartë i kapitalizimit të sistemit (18.7 përqind) bëjnë që sistemi bankar i Kosovës të jetë mjaft i qëndrueshëm ndaj tronditjeve të mundshme në cilësinë e portofolit kreditor. Po ashtu, dominimi i kredive dhe depozitave me norma fikse të interesit bëjnë që sektori bankar i Kosovës të mos jetë sensitiv ndaj lëvizjeve të mundshme të normave të interesit. Sektori po ashtu paraqitet të mos jetë sensitiv ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit, pasi që pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave janë në euro. Në përgjithësi, rezultat e stres-testit, bazuar në skenarin e kombinuar me rrezikun kreditor, të normës së interesit dhe të normës së këmbimit, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës paraqitet të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe nën supozimin e paraqitjes së skenarit të lartpërmendur, që mbështetet në supozime hipotetike dhe mjaft konservative.

## 6.6.2 Rreziku i likuiditetit

### Metodologjia

Rreziku i likuiditetit në këtë analizë është adresuar duke vlerësuar aftësinë e bankave që operojnë në Kosovë për të përballur një tërheqje më të theksuar të depozitave për një periudhë pesë ditore, duke mos marrë parasysh mundësinë e qasjes së bankave në financim

nga jashtë. Stres-testi i likuiditetit është bazuar në një skenar mjaft konservativ, duke supozuar tërheqje të depozitave me një normë prej 10 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore gjatë një periudhë prej pesë ditësh. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide do të ishte një përqind brenda një dite. Në këtë skenar është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit.

Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit, duke marrë për bazë skenarin e lartpërmendur, bëhet duke vlerësuar mjaftueshmërinë e aseteve likuide të sektorit bankar për të plotësuar kërkesat për tërheqje të depozitave.

## Rezultatet

Nën supozimin e paraqitjes së skenarit të lartpërmendur, në ditën e parë të fillimit të tërheqjes së depozitave asnjëra nga bankat që operojnë në vend nuk do të kishte nevojë për mjete likuide shtesë, ndërsa në ditën e dytë vetëm njëra nga bankat do kishte nevojë për mjete likuide shtesë, të cilat kapin vlerën prej vetëm 1.6 milion euro (Tabela 10). Pas ditës së pestë, pesë nga bankat që operojnë në Kosovë do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë në vlerë prej 42 milionë euro (1 përqind a PBB-së), përderisa raporti kredi/depozita (duke supozuar se vlera e kredive mbetet konstante) për tërë sistemin do të arrinte në 134.7 përqind.

Tabela 10. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)
Pas ditës së parë	0	0
Pas ditës së dytë	1	1,621
Pas ditës së tretë	1	4,312
Pas ditës së katërt	4	14,232
Pas ditës së pestë	5	41,969

Shënim:

1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Në një skenar të tillë, kur për pesë ditë rresht do të tërhiqeshin nga 10 përqind të depozitave, gjithsej shuma e depozitave të tërhequra do të arrinte në 41 përqind të gjithsej depozitave të sistemit bankar. Stresti i sektorit bankar për rrezikun e likuiditetit u bazua në një skenar hipotetik, me supozime mjaft konservatore, të cilat nënkuptuan norma mjaft të larta të tërheqjes së depozitave si dhe përjashtuan mundësinë që bankat të kenë qasje në burime të tjera të financimit, përveç aseteve të tyre likuide. Rezultatet e stres-testit sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të kishte pozitë mjaft të mirë të likuiditetit qoftë edhe nën supozimin e paraqitjes së këtij skenari hipotetik, ku nevoja për mjete likuide shtesë në fund të periudhës pesë ditore do të ishte mjaft e ulët. Aftësia relativisht e lartë e sektorit bankar të Kosovës për të përballuar tronditjet e likuiditetit i atribuohet nivelit mjaft të lartë të aseteve likuide në raport me gjithsej asetet e sektorit bankar.

## 7. Institucionet Tjera Financiare

### 7.1. Kompanitë e sigurimit

Sektori i kompanive të sigurimit në Kosovë edhe në gjysmën e parë të vitit 2010 vazhdoi të zgjerohet dhe të operojë në mënyre stabile. Deri në qershor 2010, vlera e aseteve të kompanive të sigurimit arriti në 90 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 20.1 përqind. Asetet e kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë kryesisht përbëhen nga depozitat në bankat komerciale, të cilat përfaqësojnë 65.2 përqind të gjithsej aseteve. Në qershor 2010, numri i kompanive të sigurimit që operuan në tregun Kosovar ishte 11, ku 8 prej tyre janë kompani me pronësi të huaj ndërsa vetëm 3 me pronësi vendore. Sa i përket përbërjes së aseteve sipas pronësisë, 79.9 përqind janë me pronësi të huaj, ndërsa 20.1 përqind me pronësi vendore.


Deri në qershor 2010, numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit arriti në 241 mijë, që paraqet një rritje vjetore prej 8 përqind. Ndërsa, shuma e primeve të pranuar nga kompanitë e sigurimit deri në qershor 2010 arriti në 34.8 milionë euro me një normë të rritjes vjetore prej 5.4 përqind (Figura 47). Aktiviteti kryesor i kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë vazhdon të jetë siguri i Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë (PPT). Primet e pranuar nga shitja e

policave PPT në qershor 2010 përfaqësonte 61.2 përqind të gjithsej primeve të pranuar. Në anën tjetër, shuma e dëmeve të paguara deri në qershor 2010 u dyfishua në krahasim me periudhën e njëte të vitit të kaluar dhe arriti vlerën prej 13.2 milionë euro. Po ashtu, pjesëmarrjen më të lartë në shumën e dëmeve të paguara e përbëjnë PPT-të (74 përqind të gjithsej dëmeve të paguara). Raporti ndërmjet primeve të pranuar dhe dëmeve të paguara deri në qershor 2010 u rrit në 38 përqind, krahasuar me 24.2 përqind në qershor 2009.

### 7.2. Institucionet mikrofinanciare


Në qershor 2010 gjithsej 17 institucione mikrofinanciare operonin në Kosovë. Aktiviteti kryesor i institucioneve mikrofinanciare vazhdon të jetë financimi i bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Vlera mesatare e një kreditë të lëshuar nga IMF-të në qershor 2010 ishte 1852 euro. Numri i kredive të lëshuara nga këto institucione deri në qershor 2010

Figura 47. Primet e shitura dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

Figura 48. Kreditë e lëshuara nga IMF-të, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

ishte 61,498 që paraqet rritje vjetore prej 15.2 përqind (Figura 48). Për sa i përket vlerës së kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare, ngjashëm me bankat komerciale, vërehet një ngadalësim i trendit të rritjes. Deri në qershor 2010, vlera e kredive të institucioneve mikrofinanciare arriti në 113.9 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 9.4 përqind krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 21.5 përqind të regjistruar në qershor 2009. Si rrjedhojë e ngadalësimit të trendit të rritjes, pjesëmarrja e kredive të lëshuara nga IMF-të në gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori financiar i Kosovës u zvogëlua në 7.5 përqind nga 8.9 përqind në qershor 2009.


### 7.3. Fondet Pensionale

Në tremujorin e parë të vitit 2010 performanca e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) ishte positive, duke marrë parasysh kthimet pozitive të mjetet e investuara. Megjithatë, paralelisht me rënien e performancës së tregjeve financiare ndërkombëtare, edhe performanca e TKPT-së filloi të bie lehtë.<sup>11</sup> Këto zhvillime ndikuan edhe në zvogëlimin e çmimit të aksioneve nga 1.00 euro në tremujorin e parë në 0.95 në tremujorin e dytë. Megjithatë, në qershor 2010 vlera e aksionit prej 0.95 euro, e cila u regjistrua në qershor 2010, ishte më e lartë krahasuar me periudhën e njëte të vitit të kaluar kur çmimi i aksionit ishte 0.88 euro (Figura 49).

Vlera e aseteve të TKPK-së deri në qershor 2010 arriti në 407.6 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 35.5 përqind. Përqendrimi më i lartë i investimeve të TPTK-së vazhdon të jetë investimi në aksione dhe forma tjera të kapitalit, që tregon ndjeshmëri të lartë të vlerës së përgjithshme të investimeve të TKPK-së ndaj lëvizjes së çmimeve të aksioneve në tregjet ndërkombëtare.

Për këtë arsye, si rezultat i turbulencave në tregjet financiare ndërkombëtare, në gjysmën e parë të vitit 2009, TKPK reduktoi investimet e saj në aksione dhe forma tjera të kapitalit në tregjet ndërkombëtare, ndërsa rriti depozitat në BQK si mënyrë për të shmangur rreziqet e mundshme. Si rezultat, në qershor 2010, 23.7 përqind e aseteve të TKPK-së ishin depozita në BQK (2.6 përqind në qershor 2008), ndërsa aksionet dhe format tjera të kapitalit përbënin 43.5 përqind të gjithsej aseteve (59.5 përqind në qershor 2008). Rikuperimi i tregjeve financiare ndërkombëtare gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 çoi në rritje të investimeve të TKPK-së në aksione dhe forma tjera të kapitalit, të cilat në qershor 2010, përbënin 61.2 përqind të gjithsej aseteve të TKPK-së, ndërsa pjesëmarrja e depozitave në BQK u zvogëlua në 8.5 përqind të gjithsej aseteve të TKPK-së. Pjesa tjetër e aseteve të TKPK-së janë investuar në fletëobligacione (23.4 përqind) dhe banka komerciale (6.2 përqind).

Figura 49. Çmimi i aksionit të trustit, në euro



Burimi: TKPK (2010)

<sup>11</sup> Tregjet financiare ndërkombëtare gjatë tremujorit të dytë 2010 u karakterizuan me performancë negative, për shkak të problemeve të borxheve në Greqi, rënies së euros, rrjedhjes së naftës në gjirin e Meksikës, reformave në tregjet financiare etj.

## **Tema Specifike**



## 8. Stabiliteti i Sektorit Financiar dhe Potencialet e Rritjes Ekonomike në Vendet e EJJ-së

Boštjan Jazbec dhe Albulenë Kastrati

### 8.1 Hyrje

Kriza globale financiare rezultoi me probleme ende të pazgjidhura në tregjet financiare globale dhe për rrjedhojë pati efekt edhe në vendet më pak të zhvilluara të rajonit. Sa i përket vendeve të tranzicionit, disa prej tyre i janë bashkangjitur Bashkimit Evropian (BE), ndërsa vendet tjera në vazhdimësi janë të përfshira në proceset e pranimit në BE. Si masë mbrojtëse e vendeve të tranzicionit ndaj krizës financiare, shërbyen reformat e ndërmarra gjatë njëzet viteve të tranzicionit. Megjithatë, sot pas njëzet vitesh të transformimit të këtyre vendeve, duket e pazakonshme t'u referohemi si vendet e tranzicionit, përderisa duket më e natyrshme që t'u referohemi si vendet e reja anëtarë të BE-së apo si ekonomitë më pak të zhvilluara të rajonit të BE-së. Stabiliteti makroekonomik dhe liberalizimi i sistemit financiar, që njëzet vjet më parë konsideroheshin si shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik, sot kanë humbur rëndësinë e tyre në procesin e tranzicionit. Kjo për arsye se, këto dy shtylla nuk kontribuuan mjaftueshëm në rritjen ekonomike të vendeve më pak të zhvilluara të BE-së, të njohura më parë si ekonomitë e tranzicionit të Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore. Një pjesë e vendeve të tranzicionit përfaqësojnë edhe vendet e Evropës Jug-Lindore (EJJ)<sup>12</sup>, të cilat, kanë ngecur prapa në proceset e integritimit në BE. Shkaku kryesor qëndron në konfliktet politike dhe luftrat e ndryshme që e karakterizuan këtë rajon gjatë viteve të '90-ta, të cilat ngadalësuan ritmin e reformave strukturore në ekonomitë e tyre. Gjithashtu, mbyllja gjeografike kontribuoi në pamundësinë e rigjallërimit të shpejtë ekonomik dhe rritjes së fuqishme ekonomike. I vetmi vend i rajonit që po ashtu është pjesë e BE-së (përveç Bullgarisë që hyri në BE në vitin 2007), është Greqia. Gjatë viteve të fundit, Greqia paraqet vendin më problematik i BE-së, për shkak të ndjeshmërisë financiare dhe stabilitetit ekonomik.

Qëllimi i këtij hulumtimi qëndron në shqyrtimin e mundësive të rritjes më të fuqishme ekonomike dhe në trajtimin e efekteve të krizës financiare në vendet e EJJ-së. Po ashtu, në kuadër të këtij hulumtimi do të tregohet se kriza financiare në BE, dhe në veçanti kriza e fundit në Greqi, influencuan sektorin financiar të vendeve të EJJ-së. Ndër të tjerash, përmes këtij hulumtimi do të konkludohet se zhvillimi i ngadalshëm ekonomik në vendet e EJJ-së nuk mund ti atribuohet vetëm stabilitetit makroekonomik dhe sistemit të brishtë financiar në këto vende. Përkundrazi, do të vërehet se shumica e këtyre vendeve janë treguar të suksesshme në zbatimin e reformave për transformimin nga sistemi i centralizuar në sistem të ekonomisë së lirë, në liberalizimin e tregtisë si dhe në integrimin e sektorit financiar. Rrjedhimisht, vendet e EJJ-së i kanë të gjitha predispozitat për një rritje më të fuqishme ekonomike. Shkaku kryesor i ngecjes së zhvillimit ekonomik në EJJ qëndron në mosfunksionimin e plotë të institucioneve, që paraqesin faktor kyç në mbështetjen e investimeve dhe zhvillimit ekonomik.

Kapitulli i dytë trajton procesin e tranzicionit gjatë njëzet viteve të fundit. Parë nga distanca kohore, mund të vërehet se stabiliteti makroekonomik dhe liberalizimi i sistemit financiar nuk kanë mjaftuar për një rritje më të fuqishme ekonomike të vendeve më pak të

<sup>12</sup> Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria, Kosova, Serbia dhe Mali I Zi.

zhvilluara. Kapitulli i tretë paraqet zhvillimet makroekonomike në rajonit, duke vënë në dukje ngjashmëritë mes tyre, pavarësisht zbatimit të politikave të ndryshme monetare. Kapitulli i katërt paraqet zhvillimet e sektorit financiar dhe ndikim e krizës financiare në vendet e EJJ-së. Kapitulli i pestë paraqet mundësitë e rritjes ekonomike në vendet e EJJ-së. Kapitulli i gjashtë paraqet përfundimet e këtij hulumtimi.

## 8.2 Mësimet që u nxorrën gjatë njëzet viteve të tranzicionit

Fillimi i procesit të tranzicionit i gjeti vendet në zhvillim të papërgatitura në lidhje me reformat strukturore që duhej të ndërmerreshin. Prandaj, ato u bazuan në udhëzimet dhe ekspertizën e vendeve perëndimore. Në këtë kohë, vendet e Amerikës Latine shërbyen si pikënisje në hartimin e programeve të stabilizimit makroekonomik, përkundër faktit që problemet e vendeve të tranzicionit dallonin dukshëm nga ato të vendeve të zhvilluara. Edhe pse procesi i tranzicionit përmban në vete një rrafsh të gjërë të ndryshimeve institucionale dhe politike, rritja ekonomike dhe stabilizimi i inflacionit ishin shqetësimet kryesore të ekonomistëve në ditët e para të tranzicionit. Megjithatë, fillimi i tranzicionit në këto vende u karakterizua me rënie drastike të prodhimit (rreth 30 përqind dhe 50 përqind) shoqëruar nga presione të larta inflacioniste. Zgjatja e procesit të tranzicionit bashkë me mungesën e përvojës së transformimit nga ekonomi të centralizuara në ekonomi të tregut të lirë gjeneruan situata të paparashikuara. Përderisa vendet e tranzicionit filluan të transformohen nga pika të ndryshme të zhvillimit ekonomik, të gjitha këto vende u ballafaquan me sfidën e transformimit nga ekonomi të centralizuara në ekonomi të tregut të lirë. Vende të ndryshme në rajon përjetuan përvoja të ndryshme gjatë tranzicionit, megjithatë u fokusuan në uljen e normës së inflacionit, i cili po pengonte në zbatimin e suksesshëm të reformave.

Edhe pse vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore adoptuan regjime të ndryshme të kursit të këmbimit, të gjitha këto vende përjetuan vlerësim të kursit dhe flukse të mëdha të kapitalit brenda një kohe relativisht të shkurtër. Vendet që u treguan më efikase në ristrukturimin dhe privatizimin e pronave shtetërore dhe subjekteve shoqërore, qenë ndër të parat që shijuan efektet pozitive të kapitalit të huaj. Hyrja e kapitalit të huaj në këto vende rriti konkurrencën e jashtme, megjithatë, ky efekt u kompensua nga rritja ekonomike në fazat e hershme. Në anën tjetër, ekonomitë më të ngadalshme në procesin e adoptimit të reformave, tërhoqën kapital të huaj kryesisht në formë të borxhit qeveritar dhe përkeqësuan bilancin e pagesave.

Në këtë kohë, rëndësi të veçantë në vendet në tranzicion kishte hartimi i politikave makroekonomike, sidomos hartimi i politikave fiskale. Politikat fiskale në vendet në tranzicion trajtonin kontrollimin e deficitit buxhetor, e sidomos çështjen e reduktimit të rolit të qeverisë në ekonomi. Për këtë arsye, trajtimi i inflacionit nuk ishte faktori i vetëm që kishte nevojë për ndërhyrje shtetërore në vendet e tranzicionit. Përveç tjerash, nevoja e ndërhyrjes shtrihej në gjatë fusha tjera (Fisher, Sahay dhe Vegh, 1996):

- \* Stabiliteti makroekonomik;
- \* Liberalizimi i çmimeve;
- \* Liberalizimi i tregtisë dhe konvertimi i llogarisë rrjedhëse;
- \* Reformimi i ndërmarrjeve (sidomos privatizimi);
- \* Krijimi i një ambienti të sigurtë, dhe



\* Zhvillimi i kornizës institucionale dhe ligjore për një ekonomi të tregut, përfshirë krijimin e një sistemi financiar të bazuar në parimet e tregut të lirë.

Krijimi i stabilitetit makroekonomik kërkonte zbatimin e reformave edhe në fushat tjera. Për shembull, zbatimi i reformave në fushën ligjore shtrëngonte politikat buxhetore, dhe si rrjedhojë shërbente si shtysë për orientimin e subjekteve të ndryshme drejt sektorit privat.

### 8.3 Zhvillimet Makroekonomike në Evropën Jug-Lindore

Pas njëzet vitesh trazira politike dhe pasiguri ekonomike, vendet e EJJ-së akoma po mundohen të arrijnë norma më të larta të rritjes ekonomike. Meqë gjeografikisht ndodhen larg tregut të përbashkët të BE-së (duke marrë parasysh tregtia me vendet e Bullgarinë dhe Greqinë, si vende anëtare të BE-së është relativisht modeste), mund të thuhet se vendet e EJJ-së janë lënë të vetme në procesin e rigjallërimit ekonomik. Siç do të vërehet më poshtë, problemi kryesor qëndron në mungesën e zhvillimit të institucioneve si predispozitë për funksionimin e tregut të lirë.

Gjashtë vendet e EJJ-së (që janë marrë si shembuj në këtë hulumtim) përfaqësojnë ekonomi të hapura dhe me madhësi relativisht të vogël. Secila prej tyre ka aplikuar politika të ndryshme të kursit të këmbimit, me qëllim të arritjes së stabilitetit makroekonomik. Për shembull, Bullgaria ka zgjedhur 'currency board' me Euro-n, ndërsa Maqedonia vazhdon të zbatojë kurs fiks të këmbimit ndaj Euro-s, ngjashëm si ai i Sllovenisë gjatë viteve '90-ta. Shqipëria dhe Serbia zbatojnë regjim fleksibil të këmbimit, kombinuar me targetimin e inflacionit. Megjithatë, përkundër regjimit fleksibil të kursit të këmbimit, në këto dy vende vërehet ndërhyrja sistematike e bankave qendrore përkatëse. Vendet më të vogla të EJJ-së, Kosova dhe Mali i Zi, zgjedhën adoptimin unilateral të Euro-s për shkak të kushteve të pafavorshme në kohën e deklarimit të pavarësisë së shteteve të tyre. Tabela 10 paraqet regjimin e kurseve të këmbimit në vendet e EJJ-së.

Tabela 11. Regjimet e Kursit të Këmbimit në Vendet e EJJ-së


Kosova	Maqedonia	Shqipëria	Bullgaria	Serbia	Mali i Zi
Euro	Denari ndjek Kurs Fiks të Këmbimit	Leku ndjek Kurs Fleksibil të Këmbimit	Levi ndjek 'Currency Board' me Euro-n	Dinari ndjek Kurs Fleksibil të Këmbimit	Euro

Burimi: Bankat qendrore të vendeve përkatëse.

Pavarësisht aplikimit të kurseve të ndryshme të këmbimit, të gjitha vendet e EJJ-së kanë pasur zhvillime të ngjashme në trendet e çmimeve gjatë dhjetë viteve të fundit (Figura 50). Nga vendet e rajonit, inflacioni më i lartë është vërejtur në Serbi. Ndërsa në vendet tjera të EJJ-së, inflacioni nuk ka tejkaluar 5 përqind. Rëndësia e përzgjedhjes së një regjimi të caktuar të kursit të këmbimit, që do të kontribuonte në stabilitetin makroekonomik në vendet e EJJ-së, duket se ka humbur rëndësinë e saj gjatë procesit të tranzicionit.

Si duket vendimi në lidhje me regjimin e kursit të këmbimit në radhë të parë ka qenë arbitrar dhe i trasuar nga rrethanat e veçanta të asaj kohe. Liberalizimi i tregtisë dhe prania e konsiderueshme e institucioneve me pronësi të huaj në sektorin financiar ka kufizuar politikat monetare të disa vendeve dhe për rrjedhojë ka kufizuar edhe rrjedhjen e lirë të kapitalit brenda dhe jashtë këtyre ekonomive. Për shembull, Mali të Zi dhe Kosova kanë hequr dorë nga politika e pavarur monetare, në këmbim të të adoptimit unilaterale të Euro-s. Megjithatë, edhe në këto dy vende, pavarësisht mungesës së politikës monetare, zhvillimet e çmimeve ishin plotësisht të ngjashme me çmimet e vendeve fqinje.

Figura 50. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit



Burimi: WEO Prill 2010, IMF

Më poshtë do të prezantohet profili ekonomik i secilit vend të EJJ-së, ku do të mësojmë se zhvillimet e çmimeve në këto vende kryesisht shpjegohen përmes çmimeve të produkteve të importuara. Shumica e këtyre vendeve kryesisht importojnë ushqim, produkte finale dhe makineri, produkte këto që përfaqësojnë sektorë që më së shumti janë prekur gjatë krizës së fundit financiare (Tabela 12). Struktura e importeve në vendet e EJJ gjithashtu korrespondon me nivelin ulët të zhvillimit ekonomik. Sa i përket eksporteve, shumica e vendeve të EJJ-së eksportojnë metale bazë dhe produkte minerale, përjashtuar Serbinë në të cilën dominojnë produktet e proceduara, dhe Shqipërinë e cila ka specializuar në eksportin e tekstilit. Edhe pse zhvillimet e çmimet e produkteve të importit kanë kontribuar në uljen e inflacionit në këto vende, në anën tjetër, baza e lartë e importeve në krahasim me importet ka ndikuar në përkeqësimin sistematik të bilancit të pagesave.

Tabela 12. Struktura e eksporteve dhe importeve, në përqindje

Kosova	Maqedonia	Shqipëria	Bullgaria	Serbia	Mali i Zi
<i>Më së shumti eksporton:</i>	<i>Më së shumti eksporton:</i>	<i>Më së shumti eksporton:</i>	<i>Më së shumti eksporton:</i>	<i>Më së shumti eksporton:</i>	<i>Më së shumti eksporton:</i>
Metale bazë (50%)	Hekur&Çelik (26%)	Tekstil (35%)	Metale (37%)	Produkte të procesuara (33%)	Aluminium (41%)
Produkte minerale (15%)	Veshje (20%)	Minerale (30%)	Veshje (36%)	Ushqim (16%)	Hekur& Çelik (13%)
Perime (6%)	Ushqim&Pije (14%)	Matr. Ndërtimi. & Metale (19%)	Burime të energjisë (5%)	Makineri (15%)	Beverages, alcohol, vinegar (6%)
<i>Më së shumti importon:</i>	<i>Më së shumti importon:</i>	<i>Më së shumti importon:</i>	<i>Më së shumti importon:</i>	<i>Më së shumti importon:</i>	<i>Më së shumti importon:</i>
Produkte minerale (17%)	Makineri&Mjete Transp. (24%)	Makineri (20%)	Makina&Mjete (43%)	Makineri (25%)	Makina&Pajisje Mekan. (12%)
Makineri (14%)	Karburante (16%)	Ushqim&Pije (18%)	Ushqim (32%)	Produkte të procesuara (20%)	Karburante (8%)
Ushqim&Pije (13%)	Ushqim (11%)	Matr. Ndërtimi. & Metale (15%)	Tekstil (27%)	Karburante (18%)	Hekur&Produkt. Hekuri (5%)


Burimi: Bankat qendrore të vendeve përkatëse.

Si argument shtesë në lidhje me zhvillimet e ngjashme që i karakterizojnë vendet e EJJ-edhe në sektorin real dhe atë financiar, do të paraqesim shkurtimisht profilin ekonomik të gjashtë vendeve të EJJ-së.

**Kosova**


Kosova nuk gëzon të drejten e emetimit të valutës së saj, pasi që nga viti 2002, në mënyrë unilaterale ka adoptuar Euro-n si valutë zyrtare. Si pasojë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) nuk bën pjesë në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore ose eurozonës, nuk udhëheq politikën monetare dhe rrjedhimisht nuk gëzon të drejtën e Kreditorit të Instancës së Fundit.

Figura 51. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit




Burimi: WEO Prill 2010, IMF

Figura 52. Rritja reale dhe bilanci buxhetor




Burimi: BQK (2010)

Figura 53. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së



Burimi: BQK (2010)

Figura 54. Rritja e Depozitave dhe Kredive në Kosovë, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

Rritja ekonomike në Kosovë kryesisht është gjeneruar nga rritja e konsumit privat, investimeve publike, dërgesave të emigrantëve, asistenca e huaj dhe në masë të konsiderueshme nga rritja e shpenzimeve qeveritare (Figura 52). Adoptimi i Euro-s në Kosovë, në masë të madhe ka kontribuar në lehtësimin e tregtisë së jashtme. Po ashtu, adoptimi i Euro-s ka ndihmuar në uljen e normave të inflacionit afër normave të eurozonës (Figura 51). Kosova paraqet një ekonomi të bazuar në import, prandaj inflacioni në Kosovë kryesisht reflekton çmimet e importit. Në anën tjetër, baza eksportit në Kosovë është relativisht e vogël, por me trend rritës (Figura 53). Rreth 74 përqind e tregtisë së Kosovës realizohet me vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s. Prej vendeve të BE-së, Kosova kryesisht eksporton në Itali (rreth 30 përqind) dhe Gjermani (4 përqind), ndërsa më


së shumti importon nga Gjermania (rreth 13 përqind) dhe Greqia (rreth 5 përqind). Dërgesat e emigrantëve në Kosovë përfaqësojnë një ndër burimet kryesore të financimit të konsumit dhe përbëjnë rreth 14 përqind të PBB-së. Rreth 64 përqind të dërgesave të emigrantëve vijnë nga vendet që përdorin Euro-n, prej të cilave më së shumti nga Gjermania.

Sektori financiar në Kosovë është pothuajse plotësisht i euroizuar (rreth 96% e depozitave dhe kredive), prandaj nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ose garantimit të detyrimeve të bankës qendrore (Figura 54). Për këtë arsye, përveç monitorimit të bankës qendrore dhe vlerësimit e rrezikut në sektorin bankar, shumica e barrës për ruajtjen e stabilitetit financiar bie mbi autoritetet fiskale.

### Shqipëria


Shqipëria aplikon kurs fleksibël të këmbimit të kombinuar me targetimin e inflacionit (Figura 55). Politika monetare në Shqipëri është treguar e dobishme në absorbimin e efekteve të krizës financiare dhe ka kontribuar në rritjen ekonomik pozitive (Figura 56).

Figura 55. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit




Burimi: WEO Prill 2010, IMF

Figura 56. Rritja reale dhe bilanci buxhetor




Burimi: BSH (2009), WEO Prill 2010, IMF

Figura 57. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së



Burimil: NSTAT dhe WEO Prill 2010, IMF

Figure 58. Rritja e depozitave dhe kredive në Shqipëri, në përqindje



Burimi: BSH (2010) dhe raporti vendor, IMF (2010)

Euroizimi në Shqipëri kryesisht favorizohet me anë të Investimeve të Huaja Direkte (IHD),

tregtisë, dërgesave të emigrantëve dhe linjave kreditore. Në kuadër të vendeve të rajonit, Shqipëria praqet vendin më të ekspozuar ndaj Greqisë dhe Italisë, dhe atë përmes tregtisë, dërgesave të emigrantëve dhe sektorit financiar. Partnerët kryesorë tregtarë në Shqipëri janë vendet e BE-së (rreth 67 përqind), nga të cilat pjesa më e madhe realizohet me Greqinë dhe Italinë. Ngjashëm me Kosovën, eksportet në Shqipëri kanë bazë të ulët. Kohët e fundit, rënia e kërkesës në Greqi dhe Itali shkaktoi edhe rënie të eksporteve shqiptare. Po ashtu, edhe ekonomia e Shqipërisë është e bazuar në import. Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë është e përqendruar në Greqi dhe Itali. Mirëpo, për shkak të rritjes së papunësisë në këto dy vende gjatë viteve 2008 dhe 2009 si pasojë e krizës financiare, Shqipëria ka regjistruar një ulje të madhe e dërgesave të emigrantëve (Figura 57). Po ashtu, Shqipëria është e lidhur me Greqinë përmes sektorit financiar. Filialet dhe degët e bankave greke në Shqipëri përbëjnë një të katërtën e sistemit bankar dhe përmbajnë nivelin më të ulët të kapitalizimit dhe likuiditetit në sektorin financiar. Gjatë krizës së fundit në Greqi, bankat greke kanë aplikuar tërheqje depozitash nga bankat e tyre në Shqipëri (Figura 58). Megjithatë, pasi Greqia hyri në program financiar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe me BE-në, bankat greke në Shqipëri shënuan rritje të depozitave.

**Maqedonia**

Denari maqedonas është pothuajse plotësisht i lidhur (‘pegged’) me Euro-n, me qëllim të mbajtjes së stabilitetit të çmimeve (Figura 58). Duke marrë parasysh politikën konzervative të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (BPRM), e në veçanti masat e rrepta që i ndër morri në vitin 2009 (rritjen e kërkesave për likuiditetit dhe rritjen e rezervave nga bankat komerciale), mund të thuhet se Maqedonia paraqet një nga vendet me politikën më të shtrënguar monetare në rajon. Masat e marra nga ana e BPRM-së kishin për qëllim ruajtjen e pegg-ut me Euron, si dhe mbrojtjen e rezervave valutore. Këto masa u realizuan me sukses në sektorin bankar në Maqedoni, megjithatë patën ndikim relativisht të vogël në rritjen ekonomike (Figura 60).

Figura 59. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit




Figure 60. Rritja reale dhe bilanci buxhetor






Figura 61. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së



Burimi: BPRM (2010) dhe WEO Prill 2010, IMF

Figura 62. Rritja e depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: BPRM(2010)


Llogaria rrjedhëse e Maqedonisë karakterizohet me deficit të lartë (Figura 61). Kohët e fundit, efektet negative në llogarinë rrjedhëse mund të kenë ardhur nga tregtia me vendet e BE-së, pasi që vetëm Gjermania, Greqia, Bullgaria dhe Italia përbëjnë 45 përqind të eksporteve dhe 31 përqind të importeve të Maqedonisë. Në pjesën e parë të vitit 2010 Maqedonia ka shënuar një rënie të eksporteve në Greqi, ndërsa importet janë rritur. Kriza e fundit greke mund të ketë përkeqësuar deficitin tregtar të Maqedonisë me Greqinë. Sa i përket dërgesave të emigrantëve, Maqedonia ka përqindjen më të ulët të dërgesave ndaj PBB-së në rajon (rreth 5 përqind).

Sistemi bankar në Maqedoni është relativisht i vogël, i cili në masë të kufizuar mbështetet nga financimi i jashtëm dhe investimet. Një nga bankat më të mëdha në Maqedoni (Stopanska Banka) përfaqëson degë të një banke greke. Megjithatë, sektori bankar në Maqedoni duket të jetë i qëndrueshëm dhe mirë i pozicionuar. Rreth 30 përqind e sektorit bankar në Maqedoni është i euroizuar. Në vitin 2009 dhe në fillim të vitit 2010 qeveria filloi lëshimin e bonove të thesarit, me norma të larta të interesit dhe risk të ulët, duke i mundësuar kështu sektorit bankar kushte më të favorshme për investime në bono sesa në kreditimin e ekonomisë (Figura 62).

## Bullgaria


Bullgaria aplikon 'currency board' me Euro-n dhe si qëllim final ka anëtarësimin në eurozonë. Lidhja e Lev-it bullgar me Euro-n i ka shërbyer Bullgarisë në kontrollimin e inflacionit dhe të deficitit buxhetor (Figura 63, 64). Normat më të larta të inflacionit në Bullgari vërehen gjatë viteve 2006-2008, si pasojë e flukseve të konsiderueshme të kapitalit. Hyrja e kapitalit ndikoi në rritjen e kredithënies së ekonomisë, që shkaktoi edhe rritjen e kërkesës vendore.

Figura 63. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit



Burimi: WEO Prill 2010, IMF


Figura 64. Rritja reale dhe bilanci buxhetor



Burimi: WEO Prill 2010, IMF

I gjithë ky proces në Bullgari, u manifestua me rritje të çmimeve dhe pagave (edhe pse Bullgaria karakterizohet me nivelin më të ulët të pagave në BE). Me fillimin e krizës financiare, flukset e kapitalit u zvogëluan dukshëm, duke ndikuar kështu edhe rënien e kërkesës së brendshme dhe të ardhurat e buxhetit. Rrjedhimisht, ekonomia e Bullgarisë pësoi rënie prej 5 përqind pas disa vitesh rritjeje ekonomike (Figura 64). Efektet e krizës kryesisht janë ndjerë në vitin 2009, ku recesioni i partnerëve tregtarë goditi eksportet e Bullgarisë dhe shkaktoi zvogëlimin e kërkesës së brendshme, duke ngadalësuar kështu edhe importet e Bullgarisë (Figura 65).

Figura 65. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së




Burimi: BKB (2010); WEO Prill 2010, IMF dhe Banka Botërore

Partnerët kryesorë tregtarë të Bullgarisë janë vendet e BE-së (62 përqind e eksporteve dhe 53 përqind të importeve). Greqia është një nga vendet e afërta më Bullgarinë, si nga aspekti gjeografik dhe ai ekonomik. Për shembull, eksportet e Bullgarisë në Greqi përfaqësojnë rreth 9 përqind, ndërsa importet përfaqësojnë rreth 5 përqind. Sa i përket sektorit financiar në Bullgari, në vitin 2009 kreditë e lëshuara në Euro përbënin 57,9 përqind, ndërsa depozitat e mbajtura në Euroi shin 58,7 përqind. Asetet e bankave greke në Bullgari përbëjnë rreth 16 përqind të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Megjithatë, niveli i kapitalizmit të sektorit bankar të Bullgarisë duket të jetë i mjaftueshëm për të absorbuar rritjen kredive joperformuese (KJP) dhe provizioneve. Për më tepër, Banka Kombëtare e Bullgarisë (BKB) ka këshilluar bankat komerciale që të mbajnë tërësisht fitimin e pashpërndarë brenda Bullgarisë.

**Serbia**


Serbia ndjek kurs fleksibil të këmbimit. Kjo mundëson ndërhyrjen e Bankës Popullore të Republikës së Serbisë (BPRS) në mbajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe të rezervave të huaja në nivelin e duhur. Si mjet kryesor të politikës monetare Serbia përdor manipulimin e normave të interesit.

Figura 66. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit




Burimi: WEO Prill 2010, IMF

Figure 67. Rritja reale dhe bilanci buxhetor




Burimi: WEO Prill 2010, IMF

Figura 68. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së



Burimi: WEO Prill 2010, IMF dhe Banka Botërore

Figura 69. Rritja e depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: BPRS (2010)

Inflacioni mesatar në Serbi gjatë viteve të 2000-ta ishte më i larti në rajon (Figura 66). Në përgjithësi, Dinari i Serbisë ka trashëguar mungesë kredibilitetit, për shkak të hiperinflacionit gjatë viteve '90-ta, i cili ka ndikuar që pritjet për inflacion në Serbi të jenë çdoherë të larta. Për më tepër, rikthimi i besueshmërisë në Dinarin serb ishte edhe më i vështirë për shkak të politikave monetare ekspansioniste të BPRS-së për financimin e deficitit të lartë të llogarisë rrjedhëse dhe për blerjen e rezerva të huaja (Figura 67). Megjithatë, hyrja e Serbisë në program financiar me FMN-në në vitin 2009, ndihmoi Serbinë në stabilizimin e inflacionit.

Pjesa më e madhe e tregtisë së Serbisë realizohet me vendet e BE-së (54 përqind e eksporteve dhe 55 përqind e importeve), ndërsa me vendet anëtare të CEFTA-s pjesëmarrja




e tregtisë është dukshëm më e ulët (31% e eksporteve dhe 8% të importeve). Para krizës globale, ngjashëm me Bullgarinë, Serbia ka gëzuar rritje të shpejtë ekonomike. Mirëpo, në fund të vitit 2008 Serbia u godit nga kriza globale përmes tkurrjes së tregtisë, rënies së menjëhershme të flukseve të kapitalit dhe tërheqjes së depozitave të ekonomive familjare (Figura 68, 69). Sektori bankar në Serbi është i euroizuar në masë të konsiderueshme, kryesisht për shkak të preferencës të Euro-s ndaj monedhës vendase. Në Serbi ekzistojnë katër degë të bankave greke, të cilat përbëjnë rreth 14 përqind të aktiveve të sektorit bankar.

## Mali i Zi

Para futjes së Euro-s në ekonomi, Mali i Zi ka përdorur gjërësisht Markën Gjermane në sektorin privat dhe atë bankar. Me futjen e Euro-s në qarkullim, Qeveria e Malit të Zi mori vendimin e adoptimit unilateral të Euro-s si valutë zyrtare.


Gjatë viteve të 2000-ta, inflacioni në Malin e Zi ishte më i lartë sesa mesatarja e rajonit, megjithëse duke përcjellur të njëjtin model të lëvizjes (Figura 70). Ngjashëm me vendet tjera në rajon, Mali i Zi është i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me vendet e BE-së nëpërmjet tregtisë dhe flukseve të kapitalit. Më shumë se 50 përqind e eksporteve të Malit të Zi i adresohen vendeve të BE-së, dhe atë kryesisht Greqisë (rreth 22 përqind) dhe Italisë (rreth 12 përqind). Nga ana tjetër, 41 përqind e importeve vijnë nga Serbia, ndërsa 31 përqind nga vendet e BE-së. Rënia e eksporteve të Malit të Zi gjatë vitit 2010, po ashtu erdhi si pasojë e rrethanave tregtare jofavorizuese me vendet e BE-së, e në veçanti me Greqinë, duke marrë parasysh krizën e fundit buxhetore atje (Figura 72). Kjo për arsye se Greqia është një nga importuesit më të mëdhej të Malit të Zi.

Figura 70. Inflacioni, mesatarja e çmimeve të konsumit



Burimi: WEO Prill 2010, IMF


Figura 71. Rritja reale dhe bilanci buxhetor



Burimi: WEO Prill 2010, IMF dhe raportit vendor, IMF (2010)


Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Mali i Zi përjetoi hyrje të mëdha të kapitalit, të cilat kontribuan në rritje të fuqishme të ekonomisë. Në të njëjtën kohë, niveli i kreditimit të ekonomisë shënoi rritje të konsiderueshme (Figura 73). Megjithatë, gjatë krizës financiare, ekonomia e Malit të Zi u godit rëndë, ku deficit i llogarisë rrjedhëse u thellua, borxhi i sektorit privat u rrit, ndërkohë që cilësia e portfolios së kredive u përkeqësua dhe pati tërheqje të depozitave nga sektori bankar. Si pasojë, këto zhvillime ndikuan që Mali i Zi të kalojë nga një rritje e fuqishme ekonomike në recesion (Figura 71).

Figura 72. Llogaria rrjedhëse, në përqindje të PBB-së



Burimi: WEO Prill 2010, IMF dhe raporti vendor, IMF (2010)

Figura 73. Rritja e depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: Raporti vendor, IMF (2010)

Euroizimi në Mal të Zi ndihmoi në stabilizimin e pritjeve ndaj inflacionit, megjithëse hendikepoi Malin e Zi në kontekst të kontrollimit të hyrjeve masive të kapitalit dhe rritjes së kredidhënies. Për më tepër, politika monetare ekspansioniste në eurozonë nuk ishte e përshtatshme për të përballuar problemet makroekonomike të Malit të Zi. Si një ekonomi unilateralisht e euroizuar, Malit të Zi i mbeti vetëm politika fiskale si mjet për të kontrolluar ofertën monetare dhe sektorin bankar. Megjithatë, politika fiskale nuk ndihmoi shumë në stabilizimin e gjendjes ekonomike, pasi që me vite të tëra Mali i Xi ndoqi politika fiskale ekspansioniste. Prandaj, duke marrë parasysh edhe ndikimin që pati kriza financiare, ekonomia e Malit të Zi u dobësua më shumë sesa ekonomitë tjera të rajonit.


#### 8.4. Zhvillimet në Sektorin Financiar

Pavarësisht nga politika monetare dhe regjimeve të ndryshme të kursit të këmbimit që ndoqën vendet e EJL-së gjatë viteve të tranzicionit, të gjitha këto vende përjetuan zhvillime të ngjashme në sektorin financiar. Kriza financiare globale që filloi në Shtetet e Bashkuara dhe më vonë u përhap edhe në vendet e BE-së, nuk pati ndikim të drejtpërdrejtë në vendet e EJL-së. Sektori financiar i këtyre vendeve u ndikua kryesisht përmes rënies së burimeve të financimit, zvogëlimit të IHD-ve dhe rënies së dërgesave të emigrantëve. Për rrjedhojë, norma e kredidhënies u ngadalësua dukshëm, e cila çoi edhe në ngadalësimin e kërkesës së brendshme dhe të rritjes së ulët ekonomike. Normat e interesit të kredive mbetën në nivele relativisht të larta, mesatarisht rreth 14 përqind, ndërsa normat e interesit të depozitave ishin rreth 5 përqind (Figura 74).

Ngadalësimi (në disa vende edhe rënia) e rritjes ekonomike në vendet e EJL-së u manifestua edhe me rritjen e papunësisë, rënies së konsiderueshme të tregtisë së jashtme dhe të hyrjeve të kapitalit. Deri në fund të vitit 2010, rimëkëmbja ekonomike në vendet e


Figura 74. Normat e interesit të depozitave dhe kredive në vendet e EJL-së, në përqindje

Normat e interesit në depozita dhe kredi në Kosovë




Burimi: BQK(2010)

Normat e interesit në depozita dhe kredi në Shqipëri




Burimi: Raporti i Tranzicionit EBRD (2009)

Normat e interesit në depozita dhe kredi në Maqedoni




Burimi: Raporti i Tranzicionit EBRD (2009)

Normat e interesit në depozita dhe kredi në Bullgari




Burimi: Raporti i Tranzicionit EBRD (2009)

Normat e interesit në depozita dhe kredi në Serbi



Burimi: BPRS (2010)

Normat e interesit në depozita dhe kredi në Mal të Zi



Burimi: Raporti i Tranzicionit EBRD (2009)

zhvilluara pritet të jetë e ngadaltë por me trende pozitive, ndërsa rimëkëmbja ekonomike në vendet e EJL-së ende duket e paqartë dhe në shumicën e rasteve është graduale. Sa i përket sektorit financiar, ekonomitë e vendeve të EJL-së janë prekur më pak nga kriza financiare. Kjo për arsye se aktivitetet bankare kryesisht janë bazuar në modelet tradicionale, duke mos u ekspozuar ndaj aseteve toksike. Megjithatë, kriza financiare shfaqti efekte indirekte në vendet e EJL-së, kryesisht përmes ngadalësimit të kredidhënies dhe rritjes së normave të interesit në kredi. Këto politika, pjesërisht ishin reagim ndaj rritjes së KJP-ve (Kosovë, Shqipëri dhe Mal të Zi), ndërsa vendet tjera (Serbia dhe Maqedonia) rritën normat e kredive për të mbrojtur valutat e tyre nga rreziku i zhvlerësimit. Edhe pse një rritje në normat e kredive ka kontribuar në ngadalësimin e

kërkesës së brendshme, siç do të shihet më poshtë, rritja e normave të kredive nuk paraqet determinuesin kryesor të kërkesës vendore në këto vende.

Përndryshe, të gjitha vendet e EJJ-së aspirojnë që të bëhen pjesë e BE-së, me përjashtim të Bullgarisë e cila tashmë është në BE. Vendet e EJJ-së janë të lidhura me BE-në, përveç tjerash, edhe përmes nivelit të konsiderueshëm të pronësisë së huaj të sektorit bankar, siç edhe tregohet në tabelën 12.

**Tabela 13. Struktura e pronësisë së sektorit bankar në EJJ**

Përshkrimi	Kosova	Maqedonia	Shqipëria	Bullgaria	Serbia	Mali i Zi
Pronësia e huaj	91.5%	93.1%	93.6%	83.9%	75.3%	84.5%
Pronësia vendore	8.5%	6.9%	6.4%	16.1%	24.7%	15.5%

Burimi: Raporti i Tranzicionit, EBRD (2009) dhe bankat qendrore të vendeve përkatëse

I vetmi vend i rajonit që gjithashtu është pjesë e BE-së (përjashtuar Bullgarinë) është Greqia. Greqia paraqet vendin më problematik të BE-së në kontekst të stabilitetit makroekonomik. Në linjë me këtë, vlen të ceket se katër vende të EJJ-së: Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Bullgaria, janë të lidhura ngushtë me Greqinë përmes sistemit financiar, që mund të konsiderohet si pikë shqetësuese sa i përket stabilitetit financiar. Një pasojë e dukshme e krizës financiare në sektorin financiar të këtyre vendeve është rritja e normave të interesit në depozita, duke konfirmuar kështu hipotezën se në kohën e krizës financiare, bankat komerciale në mënyrë agresive filluan të kërkojnë burime nga ekonomitë familjare. Efekti i trazirave financiare dhe ekonomike në Greqi ishte më i theksuar në Bullgari, për shkak të pranisë më të madhe të bankave greke në krahasim me vendet tjera të rajonit. Ndryshe nga vendet tjera të EJJ-së, Bullgaria rriti edhe normat e interesit të kredive, bashkë me rritjen e ndjeshme të normave të interesit të depozitave.

Marrë në përgjithësi, për shkak të rritjes së burimeve të brendshme të financimit, të kombinuara me shtrëngim të kredidhënies, sektori bankar në vendet e EJJ-së arriti të eksportojë kapital neto. Ky fakt vlen sidomos për Kosovën dhe Shqipërinë, ku bankat po përjetojnë likuiditetin të tepërt gjatë viteve të fundit. Kjo mund të mos korrespondojë me faktin që pikërisht këto dy vende, janë vendet më pak të zhvilluara të rajonit. Prandaj, mund të konkludojmë se zhvillimi i sektorit financiar në vendet e EJJ-së jo domosdoshmërisht ka penguar rritjen ekonomike, dhe se duhet kërkuar faktorë tjerë përcaktues të rritjes ekonomike në vendet e EJJ-së.

Si përfundim, mund të konkludojmë se vendet e EJJ-së janë prekur nga kriza globale por jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kriza financiare në vendet e EJJ-së u manifestua përmes zvogëlimit të volumit të tregtisë, si pasojë e rënies së kërkesës në vendet e BE-së dhe rënies së çmimeve globale. Tregjet financiare në vendet e EJJ-së janë afektuar në mënyrë indirekte përmes rënies së IHD-ve, rënies së dërgesave të emigrantëve dhe shtrëngimit të kredidhënies. Prandaj, rënia ekonomike ka të ngjarë të jetë më e madhe në vendet e Evropës Juglindore se sa në vendet e zhvilluara, ku e kishte origjinën kriza financiare.

#### 4. Mundësitë e rritjes ekonomike në vendet e EJJL-së

Siç u vërejt më lartë, vendet e EJJL-së me sukses kanë arritur stabilitet makroekonomik dhe financiar gjatë tranzicionit. Po ashtu, secili nga vendet e EJJL-së ka zgjedhur kursin më të përshtatshëm të këmbimit, si mjet për arritjen e stabilitetit makroekonomik. Njëherit, vendet e EJJL-së janë treguar të hapur ndaj investitorëve të huaj në sektorin financiar, me qëllim të konsolidimit të këtij sektori (i cili deri para disa vitesh nuk ekzistonte në vendet e EJJL-së), dhe në radhë të dytë me qëllim të integritimit më të madh në tregjet financiare ndërkombëtare. Shumica e vendeve të EJJL-së kanë filluar eksportimin e mallrave në tregjet e BE-së. Megjithatë, edhe pse këto eksporte kanë kontribuar në masë të moderuar në rritjen ekonomike, prapë se prapë, struktura e tyre reflekton nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik në vendet e EJJL-së. Po ashtu, baza e vogël e eksporteve të këtyre vendeve ka ndikuar negativisht në deficitin e llogarisë rrjedhëse. Gjithashtu, varësia e eksporteve të EJJL-së kryesisht nga vendet e BE-së, ka ndikuar në zvogëlimin e dinamikës së rritjes ekonomike në rajon. Në tabelën 13 mund të vërehet se vendet e rajonit tregtojnë relativisht pak me njëra-tjetrën. Siç mund të vërehet, niveli i tregtisë në mes të vendeve të rajonit vazhdon të jetë i dobët dhe ka nevojë për zgjerim të mëtejshëm. Kjo tregon se vendet e EJJL-së më shumë preferojnë të tregtojnë me vendet e BE-së, sesa të rrisin tregtinë në mes tyre. Problemet politike në mes të vendeve të EJJL-së kanë ndikuar që këto vende zvogëlojnë dinamikën e bashkëpunimit ekonomik, duke penguar kështu edhe potencialet e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik.

**Tabela 14. Matrica e tregtisë mes vendeve të EJJL-së, në përqindje vetëm nëse ceket ndryshe**

Matriksi i shteteve	Kosova	Maqedonia	Shqipëria	Bullgaria	Serbia	Mali i Zi
<b>Kosova</b>	Eksportet=4.6% e PBB Imporetet=47.6% e PBB	Exp (KS→MKD)=9.6% Imp(KS→MKD)=15%	Exp (KS→AL)=13.5% Imp(KS→AL)=3.2%	Exp (KS→BLG)=2% Imp(KS→BLG)=2%	Exp (KS→SR)=1.6% Imp(KS→SR)=11.1%	Exp (KS→MNG)=1.5% Imp(KS→MNG)=0.6%
<b>Maqedonia</b>	Exp (MKD→KS)=7.5% Imp(MKD→KS)=0.2%	Eksportet=37.1% e PBB Imporetet=59.7% e PBB	Exp (MKD→AL)=2.9% Imp(MKD→AL)=0.5%	Exp (MKD→BLG)=8.8% Imp(MKD→BLG)=4.8%	Exp (MKD→SR)=18% Imp(MKD→SR)=7.8%	Exp (MKD→MNG)=1% Imp(MKD→MNG)=0.03%
<b>Shqipëria</b>	Exp (AL→KS)=6.7% Imp(AL→KS)=0.6%	Exp (AL→MKD)=2.8% Imp(KS→MKD)=2.0%	Eksportet=9.5% e PBB Imporetet=35.8% e PBB	Exp (AL→BLG)=0.7% Imp(AL→BLG)=1.4%	Exp (AL→SR)=3.0% Imp(KS→SR)=3.5%	Exp (AL→MNG)=3.4% Imp(KS→MNG)=0.3%
<b>Bullgaria</b>	Exp (BLG→KS)=n/a Imp(BLG→KS)=n/a	Exp (BLG→MKD)=2.1% Imp(BLG→MKD)=3.2%	Exp (BLG→AL)=0.5% Imp(BLG→AL)=0.05%	Eksportet=45.8% of GDP Imporetet=59.2% e PBB	Exp (BLG→SR)=2.1% Imp(BLG→SR)=3.2%	Exp (BLG→MNG)=2.1% Imp(BLG→MNG)=3.2%
<b>Serbia</b>	Exp (SR→KS)=3.5% Imp(SR→KS)=0.03%	Exp (SR→MKD)=4.6% Imp(SR→MKD)=2.2%	Exp (SR→AL)=1.4% Imp(SR→AL)=0.1%	Exp (SR→BLG)=2.5% Imp(SR→BLG)=2.1%	Eksportet=20.9% of GDP Imporetet=40.2% e PBB	Exp (SR→MNG)=4.6% Imp(SR→MNG)=2.2%
<b>Mali i Zi</b>	Exp (MNG→KS)=7.4% Imp(KS→KS)=0.1%	Exp (MNG→MKD)=0.5% Imp(KS→MKD)=1.4%	Exp (MNG→AL)=0.5% Imp(KS→AL)=1.4%	Exp (MNG→BLG)=2.8% Imp(KS→BLG)=0.0%	Exp (MNG→BLG)=24.9% Imp(KS→BLG)=41.2%	Eksportet=17.3% e PBB Imporetet=67.6% e PBB

Burimi: Krijuar nga autorët, në bazë të IMF WEO Prill 2010, Banka Botërore (2010) dhe bankat qendrore të vendeve përkatëse.

Megjithatë, problemi më i madh i mos-zhvillimit më të hovshëm ekonomik në vendet e EJJL-së, është mungesa e zhvillimit dhe funksionimit institucional. Edhe pse mund të pretendohet se vendet e EJJL-së kanë krijuar stabilitet makroekonomik dhe me sukses kanë realizuar procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, është e rëndësishme të pranohet se vendet e EJJL-së kanë ngecur në themelimin e një strukture institucionale të ekonomisë së tregut, e cila është më se e domosdoshme për mbështetjen e rritjes së

mëtejshme ekonomike. Me strukturë institucionale të ekonomisë së tregut nënkuptojmë krijimin e të drejtave pronësore, sundimin e ligjit dhe në veçanti krijimin e kapaciteteve për zbatimin e kontratave ekzistuese në ekonomi. Tabela 14 paraqet renditjen e vendeve të SEE, sipas Raportit të Bankës Botërore 'Doing Business 2010', studim i cili tenton që paraprakisht t'i japë përgjigje pyetjes: 'Pse vendet e EJJL-së po zhvillohen me trend të ngadalshëm?' Për shembull, investitorët privatë në rajon nuk janë të mbrojtur nga institucionet përkatëse, gjë që i ndalon ata të ekspozohen dhe të ndërmarrin investime. Mbrojtja e investitorëve sa vjen e bëhet më e rëndësishme, duke marrë parasysh faktin që tregjet financiare po tregohen më të kujdesshme në mbështetjen e investimeve të reja në mjedise me risk relativisht të lartë, siç mund të konsiderohen vendet e EJJL-së.

**Tabela 15. Kushtet e biznesit në vendet e EJJL-së**

	Rangimi i lehtësisë për të bërë biznes	Fillimi i biznesit	Lejet e ndërtimit	Punësimi i punëtorëve	Regjistrimi i pronës	Marja e kredisë	Mbrojtja e investitorëve	Pagimi i taksave	Tregtia ndërkufitare	Zbatimi i Kontratave	Mbyllja e biznesit
Maqedonia	5	2	14	9	14	11	3	1	9	19	22
Bullgaria	10	12	11	8	12	1	7	12	17	21	11
Mali i Zi	15	18	19	6	24	11	6	19	8	26	5
Shqipëria	18	11	22	16	17	4	2	18	11	22	27
Serbia	19	15	23	14	21	1	15	17	13	23	21
Kosova	22	27	24	4	16	11	27	6	19	27	2

Burimi: Banka Botërore, Doing Business (2010)

Aktualisht, vendet e EJJL-së karakterizohen me stabilitet relativ makroekonomik, përkundër defiticitëve në llogarinë rrjedhëse dhe bilancit buxhetor. Pjesëmarrja më e lartë në sektorin financiar është me pronësi të huaj, gjë që ka ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit financiar në këto vende, edhe pse kriza financiare ka shkaktuar disa efekte të përkohshme. Megjithatë, ringjallja ekonomike e vendeve të EJJL-së, në thelb varet nga nga zhvillimi e institucioneve efikase në ekonominë e tregut, që garanton sundimin e ligjit. Tabela 14 ofron dëshmi se vendet e EJJL-së janë të fundit në listë sa i përket në rangimit për zbatimin e kontratave, në mesin e 27 vendeve në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Dhe me sa duket, është pikërisht korniza ligjore determinati kryesor në rritjen e investimeve në rajonin e EJJL-së.

## 5. Përfundim

Duke u bazuar në rrjedhën e përgjithshme të procesit të tranzicionit në vendet e EJJL-së, shumica e këtyre vendeve do të duhej të përjetonin norma më të larta të rritjes ekonomike, sepse të gjitha këto vende kanë arritur të ulin normat e inflacionit dhe të vendosin stabilitet makroekonomik. Sektori financiar në rajon vepron në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Për më tepër, sektori financiar në vendet e EJJL-së vazhdon të jetë stabil dhe përkohësisht është më i qëndrueshëm sesa në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, (pavarësisht problemeve që kanë pasur bankat më të degëve të bankave në EJJL). Normat e interesit në kredi në vendet e EJJL-së konsiderohen të larta. Kjo për arsye se institucionet financiare të vendosura në vendet e EJJL-së përceptojnë nivel më të lartë të riskut sesa në vendet e zhvilluara. Ky përceptim është pasojë e mbrojtjes së dobët ligjore të

bankave dhe institucioneve të tjera financiare, sa i përket zbatimit të ligjit dhe ekzekutimit të kontratave biznesore. Për këto arsye mund të konkludohet se në vendet e EJJL-së mungon mbështetja institucionale për gjenerimin e rritjes më të lartë ekonomike. Edhe pse shumica e këtyre ekonomive gjenerojnë norma pozitive të rritjes ekonomike, kryesisht si rrjedhojë e investimeve publike, megjithatë, një rritje më e fuqishme ekonomike do të mund të arrihej vetëm nga rritja e investimeve të huaja dhe vendore. Që kjo të ndodhë, vendet e EJJL-së duhet të krijojnë institucione kredibile dhe kornizë ligjore në funksion të mbrojtjes së investitorëve që janë të gatshëm të investojnë në rajon. Prandaj, bazuar vetëm në stabilitetin e sektorit financiar, por në mungesë të kornizës ligjore dhe institucioneve funksionale, vendet e EJJL-së nuk mund të presin për zhvillim më të shpejtë ekonomik.

## 9. Zbërthimi i Kostos së Ndërmjetësimit Financiar: Analizë Krahasuese

Valentin Toçi, Arben Mustafa dhe Astrit Panxha

### 9.1. Hyrje

Dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës ka shënuar një trend rënës. Dallimi i theksuar mes normave të interesit kryesisht reflekton normat e larta në kredi dhe ato të ulëta në depozita. Kjo mund të dekurajojë investimet dhe kursimet, gjë që ka implikime negative për rritjen ekonomike.

Normat e interesit për kredi përcaktohen nga shumë faktorë, disa prej tyre janë madhësia e bankës, fuqia e tregut, likuiditeti, ekonomia e shkallës dhe kostot operacionale. Gjithashtu kostoja e financimit, kostot rregullative (p.sh. taksat dhe rezervat e detyrueshme) dhe zbatimi i ligjit po ashtu paraqesin faktorë të rëndësishëm për përcaktimin e normave të interesit për kredi. Për më tepër, një pjesë shumë e rëndësishme e normave të interesit përbëhet nga rreziku i perceptuar nga vetë bankat, i cili ndër të tjera, mund të rrjedh nga dështimet institucionale në përgjithësi dhe ato ligjore në veçanti, si p.sh. vështirësitë për ekzekutimin e kolateralit.

Ky studim mbështet në një punim të mëhershëm të Morina dhe Toçi (2007), duke paraqitur një version të azhurnuar të tij. Ky studim fillimisht shpjegon trendin e normave të interesit në Kosovë dhe krahason strukturën e pasqyrës së të hyrave dhe marxhinat e fitimit të sektorit bankar në Kosovë me katër vende të rajonit. Më tej studimi përqendrohet në strukturën e kostos së kreditimit të sektorit bankar në Kosovë, duke e zërthyer atë në kostot e financimit, operacionale, të rrezikut dhe rregullative. Rezultatet tregojnë se komponentët më të rëndësishme që kontribuojnë në nivelin e lartë të normave të interesit për kredi janë kostot operacionale dhe kostot e rrezikut, të shprehura përmes provizioneve.

### 9.2. Normat e interesit dhe margjinat e fitimit

Një nga indikatorët e zakonshëm për matjen e efikasitetit të sektorit bankar është dallimi mes normave të interesit d.m.th diferenca në mes normës së interesit për kreditë dhe normës së interesit që bankat paguajnë për depozita. Diferencat më të ulëta mund të interpretohen si një tregues i efikasitetit ndërmjetësues të sektorit bankar, ndonëse jo domosdoshmërisht gjithmonë kjo qëndron. Për shembull, dallimi i ulët ndërmjet normave të interesit *ex post* mund të reflektojë nivelin e lartë të rrezikut kreditor dhe normën lartë të kredive që nuk kthehen. Në anën tjetër, dallimet e larta mund të nënkuptojnë transfere të tepërta drejtë bankave, joefikasitet në ndërmjetësim në tregun vendor, mungesë të konkurrencës, ndërmarrje të projekteve me rrezik të lartë nga huamarrësit, dështime institucionale, etj. Sipas Valverde *et al.* (2004), dallimet e mëdha ndërmjet normave të interesit për kredi dhe normave të interesit në depozita zvogëlojnë pjesën e kursimeve të dedikuara për investime. Si rezultat, ky jo-efikasitet bankar do të rritë koston e ndërmjetësimit, ku një pjesë e kursimeve do të “humben” në procesin e ndërmjetësimit. Barjas *et al.* (1999) ofroi evidencë se bankat komerciale me fuqi më të madhe në treg dhe me nivel të lartë të rezervave të kërkuara nga rregullatori do të rrisin dallimin ndërmjet normave të interesit. Rritja e këtij dallimi po ashtu ndodhë kur institucionet janë të dobëta (Demirguc-Kunt *et al.*, 2003). Për sa i përket variablave makroekonomike, ekzistojnë një



sërë studimesh që kanë gjetur evidencë se inflacioni i lartë (Demirguc-Kunt and Huizinga, 1998), deficit i lartë fiskal dhe rritja e parasë së gjerë (Crowley, 2007) mund të rrisin dallimet ndërmjet normave të interesit. Një studim nga Demirguc-Kunt *et al.* (2003) gjeti se dallimet mes normave të interesit tentojnë të ulen me përmirësimin e faktorëve institucionale.


Sidoqoftë, efikasiteti më i lartë, siç pranohet në literaturën bankare, vjen me një kosto mbi stabilitetin (e ashtuquajtura lidhja inverse efikasitet–stabilitet). Dallimet më të mëdha ndërmjet normave të interesit mund të kontribuojnë në stabilitetin e sektorit, duke siguruar profitabilitet më të lartë, duke rritur kështu edhe koston oportune të një dështimi të mundshëm të bankave, gjë e cila mund të kontribuojë në zvogëlimin e nivelit të riskut të ndërmarrë nga bankat; ndërkohë që për huamarrësin vlen e kundërta. Për shembull, normat e larta të kredive mund të nxisin huamarrësit të ndërmarrin projekte më të rrezikshme. Po ashtu, normat më të larta të interesit, së bashku me kërkesat e larta për kolateral, mund të dekurajojnë kërkesën për kredi duke bërë që më pak projekte të kualifikohen për t'u kredituar. Si pasojë, shumë nisma fitimprurëse nuk do të mund të ndërmerren. Deri në një masë kjo mund të shpjegojë edhe rezultatet nga anketa BEEPS mbi qasjen në financa në Kosovë, të cilat sugjerojnë se Kosova ka nivelin më të ulët të qasjes në financa krahasuar me vendet e rajonit.

Duke filluar nga qershori 2004, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) publikon normat efektive të interesit në depozita dhe kredi të aplikuara nga bankat komerciale në Kosovë. Figura 77 tregon mesataren e peshuar të normave të interesit në kredi dhe depozita (mesatarja lëvizëse 12-mujore) për periudhën 2005–2009.

Gjatë periudhës 2004-2009, norma mesatare e interesit për kredi ishte 14.75%, ndërsa norma mesatare e interesit për depozita ishte 3.49%, gjë që paraqet një dallim prej 11.26 pikë përqindje (pp) ndërmjet normës së interesit në kredi dhe në depozita (Figura 77).<sup>13</sup> Normat e interesit, siç paraqiten në raportet statistikore, janë matje *ex ante* të koston së ndërmjetësimit. Këto, për shembull, janë normat e kontraktuara me të cilat ngarkohen kreditë dhe me të cilat paguhen depozitat, dhe synojnë

të masin kushtet e tregut në një moment kohor. Shuma e interesit që është paguar deri në përfundimin e kontratës nuk reflektohet në këto të dhëna. Për shembull, kreditë joperformuese nuk paguajnë normë të interesit. Andaj, është e rëndësishme të llogaritet dhe zbërthehet norma *ex-post* e interesit në kredi, që reflekton vlerën reale të koston së ndërmjetësimit dhe mundëson zbërthimin e faktorëve që përbëjnë koston e ndërmjetësimit, përfshirë shpenzimet operacionale, kostot rregullative, kostot e riskut, etj.

Figure 77. Normat e interesit në sektorin bankar, 2006-2009



Burimi: WEO Prill 2010, IMF

<sup>13</sup> Deri në vitin 2008, shpenzimet administrative të paguara nga klienti nuk janë përfshirë në normën e interesit për kredi. Kjo kosto administrative ishte 1.5 pp e gjithsej normës së interesit të paguar për kredi. Megjithatë që nga viti 2008, në përputhje me standardet ndërkombëtare të statistikave, shpenzimet administrative paraqiten si pjesë e normës së interesit. Nëse këto shpenzime do të ishin përfshirë edhe para vitit 2008, norma e interesit për kredi do të ishte më e lartë për atë periudhë dhe gjithashtu rënia në vitet e fundit do të ishte më e theksuar.

Një mënyrë për zbrërthimin e kostos së ndërmjetësimit është metoda e përdorur nga Hansen and Rocha (1986), të cilët shfrytëzojnë të dhënat nga pasqyra e të ardhurave, të shprehura në raport me totalin e aseteve. Kjo metodë është shfrytëzuar edhe për vendet e rajonit si Shqipëria, Kroacia, Maqedonia dhe Serbia. Në Tabelën 16 është paraqitur zbrërthimi i këtyre të dhënave dhe zërat 1 dhe 2 paraqesin interesin e përfituar nga asetet dhe interesin e paguar ndaj detyrimeve në raport me totalin e aseteve. Diferenca ndërmjet të dyjave paraqet margjinën e normës së interesit. Të hyrat tjera neto përfaqësojnë të hyrat neto nga jo-interesi siç janë të hyrat/shpenzimet nga taksat dhe komisionet, të hyrat/shpenzimet nga tregtimi i letrave me vlerë, valutave të huaja, etj., me përjashtim të kostove operacionale dhe provizioneve. Shuma e margjinës së interesit dhe të hyrave tjera paraqet margjinën bruto të bankave në veprimtarinë e tyre. Duke zbritur nga margjina bruto kostot operacionale (zëri 6), siç janë kostoja e personelit, kostot administrative, kostot e aseteve fikse e të ngjashme, përfitohet margjina neto (zëri 7). Duke zbritur provizionet (zëri 8) nga margjina neto përfitojmë treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në shtetet përkatëse.

Siç mund të shihet në Tabelën 16, margjina e interesit është më e larta në Kosovë (rreth 1pp më e lartë krahasuar me Maqedoninë dhe Serbinë dhe mbi 2.5pp më e lartë krahasuar me Shqipërinë dhe Kroacinë). Ky dallim i madh kryesisht i atribuohet interesit më të lartë të përfituar nga asetet. Margjina e interesit në sektorin bankar të Kosovës ka ndjekur një trend në rritje që nga viti 2005 deri 2008, kryesisht për shkak të rritjes së kredive të lëshuara nga sektori bankar, të cilat karakterizohen me normë më të lartë të interesit. Ndërsa normat e interesit në kredi gjatë kësaj periudhe janë zvogëluar në mënyrë modeste, ndërkohë që normat e interesit në depozita kanë ndjekur trend rritës. Në vitin 2009, margjina e interesit u zvogëlua për herë të parë dhe ky zhvillim mund t'i atribuohet ngadalësimit të rritjes së kreditimit dhe kostos më të lartë të financimit për bankat.

Kosova qëndron më lartë krahasuar me vendet e rajonit edhe për sa i përket margjinës bruto, kryesisht për shkak të nivelit të lartë të të hyrave tjera në sektorin bankar. Kjo kategori përfshinë të hyrat e gjeneruara nga taksat dhe komisionet, fitimet nga tregtimet dhe të hyrat tjera operative. Kostot operacionale dhe provizionet i shtojnë një përqindje të konsiderueshme kostos së ndërmjetësimit. Këta tregues për Kosovën janë shumë më të lartë krahasuar me Shqipërinë dhe Kroacinë, janë në nivel të përafërt me Maqedoninë, por më të ulët krahasuar me Serbinë. Këto kosto reflektojnë joefikasitetin e shpenzimeve, perceptimin e rrezikut nga bankat/rregullatorët për portofolin kreditor, etj., të cilat deri në një masë mund të shpjegojnë normat e larta të interesit në Kosovë.

Kjo qasje përgjithëson koston e ndërmjetësimit që ka të bëjë me operacionet bankare në tërësi. Për shembull, interesi i përfituar nga asetet nuk bënë dallim ndërmjet aseteve të investuara në investime me rrezik të ulët-kthim të ulët, siç janë plasmanet në bankat jashtë vendit dhe letrat me vlerë të lëshuara nga qeveritë dhe, nga ana tjetër, aseteve të investuara në kredi në tregun vendor me rrezik më të lartë dhe kthim më të lartë. Megjithatë, përafrimi nuk është joreal kur konsiderohen ngjashmëritë në raportin e kredive për ekonominë vendore ndaj totalit të aseteve për vendet e rajonit të cilat fillojnë nga 58.48% në Kosovë deri në 66.24% mesatarja për vendet e rajonit të përfshira në këtë analizë (Tabela 16). Gjithashtu, provizionet ndërlidhen me operacionet bankare në tërësi dhe jo në mënyrë eksplicite me aktivitetin huadhënës të bankave në tregun vendor. Duke marrë parasysh këtë, në vijim do të zbrërthet kostoja e ndërmjetësimit që ndërlidhet me aktivitetin e kreditimit në ekonominë vendore të sektorit bankar të Kosovës dhe sektorëve bankarë të vendeve tjera të rajonit.

Tabela 16. Struktura e pasqyrës së të hyrave të bankave komerciale dhe margjinat e fitimit

(në mijëra të valutave kombëtare dhe si % e gjithsej asetëve)

Përshkrimi	Kosovë				Maqedoni	Kroaci	Shqipëri	Serbi
	2006	2007	2008	2009	2009	2009	2009	2009
1. Interesi i pranuar	89 <b>7.65</b>	118 <b>8.21</b>	156 <b>8.61</b>	163 <b>7.41</b>	19,131 <b>7.12</b>	22,830 <b>6.03</b>	154,831 <b>4.53</b>	168,920 <b>7.23</b>
2. Interesi i Paguar	20 <b>1.71</b>	26 <b>1.81</b>	38 <b>2.11</b>	52 <b>2.37</b>	8,436 <b>3.14</b>	13,279 <b>3.51</b>	78,804 <b>2.31</b>	68,390 <b>2.93</b>
3. Marxhina e interesit (1-2)	69 <b>5.93</b>	92 <b>6.40</b>	118 <b>6.50</b>	111 <b>5.04</b>	10,695 <b>3.98</b>	9,551 <b>2.52</b>	76,027 <b>2.22</b>	100,530 <b>4.30</b>
4. Të hyra tjera (neto)	26 <b>2.26</b>	39.0 <b>2.72</b>	38.2 <b>2.11</b>	38 <b>1.70</b>	3,423 <b>1.27</b>	13,436 <b>3.55</b>	23,280 <b>0.68</b>	31,590 <b>1.35</b>
5. Marxhina bruto (3+4)	95 <b>8.19</b>	131 <b>9.12</b>	156 <b>8.61</b>	149 <b>6.74</b>	14,118 <b>5.26</b>	22,987 <b>6.08</b>	99,307 <b>2.91</b>	132,120 <b>5.66</b>
6. Kostoja operative	61 <b>5.23</b>	69.7 <b>4.86</b>	86.0 <b>4.76</b>	87 <b>3.95</b>	10,278 <b>3.83</b>	7,564 <b>2.00</b>	52,859 <b>1.55</b>	104,420 <b>4.47</b>
7. Marxhina neto (5-6)	34 <b>2.96</b>	61 <b>4.26</b>	70 <b>3.86</b>	62 <b>2.79</b>	3,840 <b>1.43</b>	15,423 <b>4.08</b>	46,448 <b>1.36</b>	27,700 <b>1.19</b>
8. Provizionet	14 <b>1.18</b>	18 <b>1.24</b>	17 <b>0.94</b>	26 <b>1.16</b>	5,254 <b>1.96</b>	3,515 <b>0.93</b>	31,525 <b>0.92</b>	138,362 <b>5.92</b>
9. Profiti para tatimit	27 <b>2.29</b>	41 <b>2.88</b>	48 <b>2.63</b>	29 <b>1.31</b>	1,725 <b>0.64</b>	4,216 <b>1.11</b>	7,503 <b>0.22</b>	20,030 <b>0.86</b>
10. Profiti pas tatimit	20 <b>1.74</b>	33 <b>2.33</b>	36 <b>2.01</b>	25 <b>1.15</b>	1,676 <b>0.62</b>	3,278 <b>0.87</b>	5,489 <b>0.16</b>	20,030 <b>0.86</b>
A. Gjithsej asete në vitin raportues	1,161	1,435	1,808	2,204	268,543	378,371	3,417,473	2,336,046
B. Kreditë	637	892	1,183	1,289	178,195	252,428	1,596,615	1,989,552
C. Kreditë/gjithsej asete	<b>54.82</b>	<b>62.17</b>	<b>65.45</b>	<b>58.48</b>	<b>66.36</b>	<b>66.71</b>	<b>46.72</b>	<b>85.17</b>

Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse dhe kalkulimet vetanake

### 9.3. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit

Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit *ex-post* është bërë në *koston e financimit*, *koston operative*, *koston e rrezikut* dhe *koston rregullative*. Kjo qasje shfrytëzon të dhënat nga bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave dhe me anë të disa supozimeve ofron një vlerësim të përafërt me koston e ndërmjetësimit që ndërlidhet vetëm me ekonominë vendore. Analiza bazohet në identitetin themelor të kontabilitetit:

$$II + NII = IE + C + Pv + Tax + P$$

ku të hyrat nga interesi (*II*) plus të hyrat nga jo-interesat (*NII*) barazohen me shpenzimet e interesit (*IE*), kostot operative (*C*), provizionet për humbje nga kreditë (*Pv*), taksat e paguara (*Tax*) dhe fitimin (*P*). Megjithatë, kjo kornizë nuk merr parasysh efektet e sjelljes së faktorëve makroekonomikë, faktorëve institucionalë, dhe as faktorëve të specifik të bankave individuale apo të tregut si ekonomia e shkallës, fuqia e tregut, etj., të cilat mund të pasqyrohen në komponentet e kostove ose të hyrave.

Për sa u përket dështimeve institucionale të cilat në një masë të madhe i kontribuojnë rrezikut kreditor, bazuar në një anketë me bankat në Kosovë, së fundmi është realizuar një studim mbi zbatimin e së drejtave të kreditorëve, ku Kosova duket të jetë e krahasueshme

mirë me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë. Rezultate të ngjashme janë ofruar edhe nga raporti i Bankës Botërore 'Doing Business' (2011), ku Kosova qëndron afër vendeve tjera për sa i përket ditëve të nevojshme për zbatimin e një kontrate dhe për sa i përket mbrojtjes me ligj të të drejtave të kreditorëve. Sidoqoftë, rezultatet e anketës tregojnë se joefikasiteti institucional ende paraqet pengesë në procesin e zbatimit të kontratave, duke shkaktuar vonesa në ekzekutimin e kolateralit. Këto pengesa mund të rrisin shpenzimet e sektorit bankar dhe po ashtu rrezikun kreditor, duke shkaktuar rritje të normave të interesit për kreditë. Sa u përket faktorëve makroekonomikë, për shkak të përdorimit të euros, Kosova karakterizohet me një inflacion të ulët edhe pse disbalancet e jashtme, aktiviteti i ulët ekonomik dhe shkalla e lartë e papunësisë mund të rrisin perceptimin e përgjithshëm mbi rrezikun.

### 9.3.1 Norma e interesit në kredi *ex-post*

Kostot që bartin huamarrësit janë normat e interesit që ata paguajnë për kreditë e pranuar si dhe pagesat për komisione. Për shembull, norma e interesit *ex ante* nuk pasqyron ato kredi që nuk paguajnë interes, që janë në vonesë, etj. Për t'u marrë me këtë çështje, është llogaritur raporti në mes të hyrave nga interesi prej kredive, të cilat janë të dhëna mujore nga pasqyra e të ardhurave (të dhëna mbi fluksin) dhe bruto kreditë, të cilat janë të dhëna mujore nga bilanci i gjendjes (të dhëna kumulative). Të dhënat mujore nga pasqyra e të ardhurave janë përvitësuar dhe është nxjerrë mesatarja e raportit gjatë një viti për të zbutur pasojat e problemit të ndërlidhur me të dhënat mbi fluksin dhe të dhënat kumulative. Bankat në Kosovë po ashtu aplikojnë komisionin prej 1-2% për çdo kredi të lëshuar (komisioni për procesim/lëshim). Për të përfshirë këtë dhe komisionet e tjera të mundshme, si për shembull gjobat për pagesa të kredive të vonuara, është llogaritur raporti në mes të hyrave komisioneve (variabla e fluksit) dhe bruto kredive (variabla kumulative). Për të ndarë të hyrat nga komisionet që lidhen vetëm me aktivitetin e kreditimit në ekonominë e vendit, shumëzohet vlerën komisioneve me faktorin *A*. *A* përfaqëson, për çdo periudhë, përqindjen e kredive të lëshuara në ekonominë vendore ndaj gjithsej asetëve. Me këtë rast supozohet se ky faktor përfshinë aktivitetin e sektorit bankar në kreditimin e ekonomisë vendore.<sup>14</sup>

### 9.3.2 Zbërthimi i kostos *ex-post*

Struktura e kostos së sektorit bankar është dekompozuar duke llogaritur katër komponentë: kostot e financimit, kostot operative, kostot e rrezikut dhe kostot rregullative. Depozitat përbëjnë burimin më të rëndësishëm të financimit për aktivitetin kreditues të sektorit bankar. *Kostot e financimit* ose norma 'aktuale' e interesit për depozita është nxjerrë duke llogaritur raportin ndërmjet shpenzimeve të interesit për depozita dhe huave tjera ndaj gjithsej borxhit të bankave ndaj klientëve (D). Prandaj, e para duke qenë një variabël fluksi dhe e fundit variabël kumulative, të dhënat mujore mbi fluksin janë përvitësuar dhe është llogaritur mesatarja e raportit gjatë një viti.

*Kostot operative* që përfshijnë kostot e personelit, kostot e qerasë dhe kostot e tjera jo të interesit mund të transferohen tek klientët nëpërmjet normave më të larta të interesit.

<sup>14</sup> Një tjetër supozim për faktorin *A* mund të jetë të hyrat nga interesi në kreditë ndaj gjithsej të hyrave. Megjithatë, rezultatet nuk do të ndryshojë në mënyrë substanciale.

Këto kosto janë rezultat i të gjitha aktiviteteve bankare. Në periudhën 2004-2009 pjesa më e madhe e kostove operative ishte e ndarë ndërmjet kostove të personelit (40 përqind e gjithsej kostove operative) dhe kostove të qerasë (40 përqind). Për të ndarë kostot operacionale që ndërlidhen vetëm me kreditimin e ekonomisë vendore, shumëzohet kostot me faktorin  $A$ . Duke ndërlidhur këtë me bruto kreditë ( $L$ ) mund të rezultojë në kostot operative që i dedikohen vetëm kreditimit të ekonomisë vendore. Kjo përqindje është faktor tjetër kontribuues në koston e ndërmjetësimit që ka të bëjë me aktivitetin kreditues të bankave komerciale.

Provizionet paraqesin rrezikun që bankierët e perceptojnë apo vlerësojnë në portofolin e tyre dhe paraqesin një faktor tjetër i kontribuon koston së ndërmjetësimit. *Kosto e rrezikut* është nxjerrë nga të dhënat në raportin e bilancit të gjendjes, duke llogaritur raportin ndërmjet provizioneve për humbjet nga kreditë dhe bruto kredive të lëshuara në ekonominë vendore në bazë mujore për secilin vit të periudhës 2004-2009. Bazuar në të dhënat aktuale, rreth 95% e provizioneve i takon kredive për ekonominë e vendit.

*Kostot rregullative* përfshijnë tatimet dhe rezervat e detyrueshme të kërkuara nga banka qendrore. E njëjta logjikë është përdorur për llogaritjen e taksave, duke i ndërlidhur provizionet për taksat (shumëzuar me faktorin  $A$ ) me bruto kreditë. Taksat dhe kosto e rezervës së detyrueshme pritet të jenë më pak të rëndësishme. Pas normës 'aktuale' të kreditimit dhe pas llogaritjes së të gjitha komponentëve të koston, është llogaritur diferenca ndërmjet tyre që pasqyron *mbetjen* ( $\varepsilon$ ). Kjo përbëhet prej të hyrave nga operacionet tjera bankare dhe nga gabimet që rezultojnë nga supozimet e bëra dhe gjatë kombinimit të të dhënave mbi fluksin nga pasqyra e të ardhurave dhe të dhënave kumulative nga bilanci i gjendjes.

Identiteti themelor i kontabilitetit është transformuar në këtë formë:

$$\frac{II}{L} + \frac{NII}{L} * A = \frac{IE}{D} + \frac{C}{L} * A + \frac{Pv}{L} * 0.95 + \frac{Tax}{L} * A + \frac{IE}{L} * A * 0.1 + \frac{P}{L} * A + \varepsilon$$

### 9.3.3 Rezultatet

Siç mund të vërehet nga Tabela 17, norma e kreditimit *ex post* prej 12.59% si dhe tarifat dhe komisionet që i shtojnë 1.99pp normës së kreditimit rezultojnë në një normë *ex-post* të kreditimit në sektorin bankar prej 14.58% për vitin 2009. Norma *ex-post* e kreditimit në sektorin bankar të Kosovës rezulton të jetë më e lartë krahasuar me vendet tjera të rajonit, mesatarja e të cilave është 11.14%.

Gjatë vitit 2009, ndër faktorët më të rëndësishëm të cilët i kanë kontribuar normës së kreditimit në Kosovë ishin kostot operative, të pasuara nga kostot e rrezikut të cilat përfaqësohen nga provizionet për humbjet nga kreditë. Kostot operative përfaqësojnë 4.48pp të kostove totale të bartura nga sektori bankar, ndërsa kostot e rrezikut i shtojnë atyre edhe 5.08pp. Kostot e financimit dhe kostot rregullative bashkarisht shtojnë 3.80pp, ndërkohë që fitimet e bankës përbëjnë 1.28pp.

Struktura e koston *ex-post* për sektorin bankar të Kosovës dallon nga sektorët bankar të vendeve tjera në rajon. Ndryshe nga Kosova, ku kostot e rrezikut dhe kostot operacionale

paraqesin pjesën më të madhe të kostos *ex-post*, komponenti më i madh i kostos *ex-post* në sektorët bankar të vendeve të rajonit duket të jenë kostot e financimit. Në Maqedoni, kostot operacionale përfaqësojnë kategorinë e dytë më të madhe të kostos *ex-post*, ndërsa në vendet tjera, kostot e rrezikut përfaqësojnë kategorinë e dytë më të madhe, duke lënë kostot operacionale në vendin e tretë. Dominimi i kostove të rrezikut dhe kostove operacionale në strukturën e përgjithshme të kostos *ex-post* në sektorin bankar të Kosovës reflektojnë nivel më të lartë të rrezikut që është perceptuar nga bankat në Kosovë si dhe nivel më të ulët të efikasitetit të bankave. Për më tepër, fitimi i bankave gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në shpjegimin e kostove *ex post* për sektorin bankar të Kosovës dhe është më e lartë në krahasim me mesataren e vendeve të rajonit.

Kostot operacionale, si njëra ndër komponentet më të mëdha të kostos së ndërmjetësimit, kanë shënuar një tendencë të rënies që nga viti 2005. Në vitin 2009, kostot operacionale përbënin 4.48pp të gjithsej kostove *ex-post*, krahasuar me 6.13pp sa ishin në vitin 2005. Niveli i lartë i kostove operacionale në vitet e para të operimit të sektorit bankar të Kosovës, në mes tjerash, mund t'i atribuohet nevojës për shtrirjen e rrjetit të sektorit bankar. Kjo shtrirje ka shkaktuar një nivel më të lartë të shpenzimeve për hapjen dhe funksionalizimin e degëve dhe pjesës tjetër të infrastrukturës. Në vitin 2009, mund të konsiderohet se sektori bankar në masë të madhe ka kompletuar rrjetin e tij dhe shërbimet bankare janë të pranishme në pjesën më të madhe të vendit.

Tabela 17. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit

Përshkrimi	Kosovë				Maqedoni	Shqipëri	Kroaci	Serbi	Mesatarja për vendet e rajonit
	2006	2007	2008	2009	2009	2009	2009	2009	
<b>Norma e kreditimit Ex-post</b>	<b>15.66</b>	<b>16.30</b>	<b>15.52</b>	<b>14.58</b>	<b>11.90</b>	<b>12.19</b>	<b>10.18</b>	<b>10.29</b>	<b>11.14</b>
Norma e kreditimit	13.32	13.30	13.09	12.59	10.74	9.70	9.04	8.49	9.49
Tarifat dhe komisionet	2.35	3.00	2.43	1.99	1.16	2.49	1.14	1.80	1.65
<b>Kostoja ex-post</b>	<b>12.93</b>	<b>13.25</b>	<b>13.50</b>	<b>13.37</b>	<b>8.85</b>	<b>7.85</b>	<b>11.92</b>	<b>12.87</b>	<b>10.37</b>
Kostoja e financimit	2.30	2.52	2.93	3.36	4.10	2.93	5.17	6.17	4.59
Kostoja operative	5.64	5.37	5.28	4.48	3.99	2.00	1.89	0.42	2.07
Kostoja e rrezikut	4.22	4.54	4.37	5.08	0.38	2.55	4.30	6.26	3.37
Kostoja rregullative	0.77	0.81	0.92	0.45	0.39	0.36	0.57	0.01	0.33
o/w taksat	0.59	0.61	0.69	0.18	0.02	0.08	0.23	0.00	0.08
o/w rezervat	0.19	0.20	0.23	0.27	0.36	0.29	0.33	0.01	0.25
<i>Artikujt e memorandumit</i>									
<b>Mbetja</b>	<b>2.74</b>	<b>3.05</b>	<b>2.02</b>	<b>1.21</b>	<b>3.04</b>	<b>4.34</b>	<b>-1.74</b>	<b>-2.57</b>	<b>0.77</b>
o/w Profiti	1.88	2.60	2.26	1.28	0.72	0.21	0.82	0.22	0.49

Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse dhe kalkulimet vetanake

Për më tepër, në vitet e para të operimit, bankat në Kosovë kishin shpenzime më të mëdha për trajnimin e stafit dhe shpenzime tjera, duke marrë parasysh që në atë kohë tregu nuk mund të ofronte një staf me përvojë për këtë industri. Bazuar në një studim të bërë nga Banka Botërore (2010), në sektorin financiar të Kosovës pagat janë më të lartat krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë. Kjo shprehet përmes diferencës së pagave në mes të sektorit financiar dhe sektorëve që kërkojnë fuqi punëtore me kualifikim më të ulët (ndërtimtaria, hotelieria dhe tregtia me pakicë). Diferenca e pagave ndërmjet sektorit

financiar dhe sektorëve të tjerë në Kosovë është më e lartë krahasuar me vendet e rajonit. Krahasuar me Maqedoninë, diferenca e pagave është për 50 përqind më e lartë, ndërsa në krahasim me Kroacinë është për 100 përqind më e lartë. Ky fakt mund të hedh dritë mbi nivelin e lartë të shpenzimeve operacionale në Kosovë, në krahasim me vendet e rajonit.<sup>15</sup>

Ndryshe nga vitet e mëparshme, kur shpenzimet operative përfaqësonin komponentin më të madh të kostos *ex-post* për sektorin bankar, në vitin 2009, kostoja e rrezikut ishte komponenti më i madh, duke përfaqësuar 5.08pp të kostove totale. Kostoja e rrezikut ka shënuar një trend në rritje gjatë pesë viteve të fundit, kryesisht për shkak të rritjes së kredive dhe ndërmarrjes së një rreziku më të madh nga bankat gjatë kësaj periudhe. Kontributi më i madh i kostos së rrezikut në koston totale për vitin 2009, kryesisht pasqyron përkeqësimin e kushteve në sektorin real gjatë kësaj periudhe, si pasojë e krizës globale, e cila shkaktoi një rritje të kredive joperformuese në sektorin bankar të Kosovës nga 3.3 përqind të gjithsej kredive në vitin 2008 në 4.3 përqind të gjithsej kredive në vitin 2009. Kostot e financimit përfaqësojnë një kategori tjetër që e ka shtuar vazhdimisht kontributin e saj në gjithsej koston *ex-post*. Rritja e kostove të financimit kryesisht pasqyron rritjen e normave të interesit për depozita, sidomos gjatë periudhës 2008-2009. Kjo periudhë është karakterizuar me hyrje të reja në sektorin bankar të Kosovës, gjë që ka intensifikuar konkurrencën ndërmjet bankave për të siguruar shuma më të mëdha të depozitave. Përveç kësaj, normat e larta të rritjes së kredive gjatë kësaj periudhe, kanë parashtruar nevojën për të siguruar shuma më të mëdha të depozitave në mënyrë që të financojnë rritjen e aktivitetit kredidhënës. Këto zhvillime kanë pasur ndikim pozitiv në normat e interesit për depozita, duke rritur kështu koston e financimit për sektorin bankar.

#### 9.4 Përfundim

Margjina ndërmjet normave të interesit për kredi dhe atyre për depozita në sektorin bankar të Kosovës konsiderohet të jetë e lartë në krahasim me vendet e rajonit. Margjina e normës së interesit në Kosovë në radhë të parë reflekton normat e larta të interesit për kredi. Në të njëjtën kohë, normat e interesit në depozita kanë ndjekur një trend të rritjes, duke e ngushtuar deri në një masë marginën ndërmjet normave të interesit. Ky studim konstaton se norma e interesit për kredi në Kosovë kryesisht shpjgohet nga kostot operacionale dhe kostot e rrezikut. Kostot operacionale paraqiten si kategoria dominuese në strukturën e përgjithshme të kostos së sektorit bankar. Shpenzimet e ndërmarrja për adoptimin e teknologjive të reja, për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve bankare, si dhe zgjerimi i shërbimeve drejt bizneseve të vogla që kanë kosto më të lartë, ka ndikuar në rritjen e kostove operacionale. Gjithashtu shpenzimet fillestare ose kostoja e blerjes së bankave të vendit, si dhe shpenzimet për trajnimin e stafit, që në përgjithësi mungonte në Kosovë, gjithashtu kishte ndikim në rritjen e kostove operacionale. Kostot e rrezikut, të shprehura me nivelin e provizioneve, po ashtu kanë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e normës së interesit për kredi. Për dallim nga Kosova, në vendet e rajonit, kostot e financimit duket se kanë ndikim të theksuar në shpjgimin e normës së interesit në kredi.

Pjesa e madhe të shpenzimeve operative në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve në sektorin bankar të Kosovës tregon mangësi për sa i përket efikasitetit të shpenzimeve në këtë sektor. Kjo kërkon marrjen e masave nga ana e bankave për të përmirësuar efikasitetin e shpenzimeve, në mënyrë që të ketë rënie të normave të interesit për kreditë.

<sup>15</sup> Shih po ashtu Toçi (2009) për joefikasitetin relativ të ndërmjetimit në sektorin bankar të Kosovës.

Rritja e konkurrencës në sektorin bankar mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e efikasitetit të këtij sektori. Përveç kësaj, rezultatet e nxjerra nga ky studim paraqesin nevojën për përmirësim të teknikave të vlerësimit të rrezikut nga bankat që operojnë në Kosovë, duke pasur parasysh që kostot e rrezikut kanë rezultuar të jenë një nga komponentët kryesorë të kostos së ndërmjetësimit.

Në këtë drejtim, përmirësimi i shkëmbimit të informacioneve si p.sh regjistrit të kredive, si dhe përmirësimi në cilësinë dhe transparencën e raportimit financiar nga firmat faktorë shumë të rëndësishëm për zvogëlimin e kostos së rrezikut. Përveç kësaj, përmirësimi i infrastrukturës së informacionit së bashku me ngritjen e efikasitetit të gjykatave për të procesuar lëndët e bankave po ashtu mund të japin një kontribut të konsiderueshëm për zvogëlimin e rrezikut kreditor dhe, rrjedhimisht, për zvogëlimin e normave të interesit për kredi në sektorin bankar të Kosovës.



## 10. Zbatimi i të Drejtave të Kreditorëve në Kosovë: Analizë Empirike

Valentin Toçi and Arben Mustafa

### 10.1 Hyrje

Kosova pas luftës së vitit 1999 filloi të ndërtojë institucionet e nevojshme për funksionimin e ekonomisë së tregut. Kosova shënoi progres të konsiderueshëm për sa i përket krijimit të kushteve për funksionimin e tregut financiar dhe mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve, duke hartuar kornizën rregullative për sektorin financiar dhe ligjet mbi falimentimin, pengun, hipotekën si dhe regjistrat e hipotekës dhe kredisë. Për sa i përket ligjit të shkruar, Kosova duket se qëndron më mirë se sa mesatarja e ekonomive në tranzicion edhe vendet anëtare të OECD-së kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve. Një vlerësim i të drejtave të kreditorëve është bërë në raportin ‘Doing Business’ (2011) të Bankës Botërore, i cili ka ndërlidhur zbatimin e të drejtave të kreditorit me disa aspekte kyçe të ligjit mbi falimentimin e ndërmarrjeve dhe pengun, duke mbuluar tri aspekte të ligjit mbi falimentimin dhe shtatë aspekte të ligjit mbi kolateralin. Vlerësimi i Indeksit të Drejtës të Kreditorit varion nga shkalla 0 deri në 10 (sa më e lartë shkalla, aq më të mbrojtura të drejtat e kreditorit). Një pikë i shtohet çdo tipari i cili forcon të drejtat e kreditorit në ligjin e kolateralit dhe ligjin e falimentimit. Bazuar në këtë indeks, të drejtat e kreditorëve janë të mbrojtura mirë me ligjet e shkruara në Kosovë. Indeksi për të Drejtat e Kreditorit në Kosovë është vlerësuar të jetë 8, që është më i lartë se mesatarja prej 7 e ekonomive të tjera në tranzicion. Për sa u përket vendeve të EJJL-së, vetëm Shqipëria u cilësua më lart se Kosova. Sidoqoftë, për sa i përket zbatimit të të drejtave të kreditorëve nuk ka evidencë përfundimtare se si këto ligje funksionojnë në praktikë në Kosovë pasi që studime të ndryshme japin përfundime të ndryshme (World Bank, 2004; Zahler, 2004; BCI, 2005). Disa venë në dukje dobësitë në sundimin e ligjit në vend, ndërkohë që të tjerat theksojnë mbrojtjen adekuate të të drejtave të kreditorit – më mirë se në disa ekonomi tjera të tranzicionit dhe në disa vende të zhvilluara.

Ky studim ofron një vlerësim të përditësuar të zbatimit të së drejtave të kreditorëve në Kosovë, duke shpjeguar fillimisht vlerësimet e disa agjensioneve mbi zbatimin e të drejtave të kreditorit. Mirëpo, këta indikatorë mund të mos shpjegojnë plotësisht zbatimin e të drejtave të kreditorit, sidomos në kontekst të sektorit bankar. Kufizimet janë qoftë për shkak se ato mund të dështojnë të kapin plotësisht kontekstin e marrëdhënies huadhënës-huamarrës ose janë multidimensionalë. Si të tillë, këta indikatorë, marrin parasysh disa segmente, por domosdoshmërisht përfshijnë specifikat e marrëdhënies huadhënës-huamarrës. Andaj, ky studim synon të shqyrtojë ambientin ligjor të sektorit bankar në Kosovë, në veçanti aspektet e zbatimit të kontratës në marrëdhënien huadhënës-huamarrës. Kjo analizë bazohet në të dhënat primare nga një anketë të bërë me bankat për të vlerësuar se si funksionon ligji mbi pengun në praktikë.

### 10.2 Zbatimi i të drejtave të kreditorit

Banka Botërore (2004) vlerësoi “ligjet në veprim” në Kosovë dhe nxori në pah shumë mangësi në procedurat gjyqësore. Aspekte si pa-parashikueshmëria e gjykimit, gjatësia e procesit të gjykimit dhe komplikimet dhe mungesa e qartësisë gjatë procesit janë cilësuar si

pengesa për zbatimin e të drejtave të kreditorit, gjë që mund të nxisë krijimin e kulturës së mospagimit tek huamarrësit. Kjo tregon zhvillimin e dobët të sistemit gjyqësor për sa i përket zbatimit të kontratave. Për më tepër, bazuar në intervistat me bankierë në Kosovë, Zahler (2004) pretendon se gjykatat dhe gjyqtarët tentojnë të favorizojnë huamarrësit kundrejt huadhënësve gjatë procesit të gjyqimit. Autori gjithashtu thekson funksionimin e dobët të institucioneve ligjore të cilat qeverisin transaksionet financiare.

‘Doing Business’ (2011) ofron një pasqyrë të qartë të zbatimit të kontratave në Kosovë, duke marrë parasysh numrin e ditëve të nevojshme për të zbatuar një kontratë të thjeshtë borxhi. Siç shihet në Tabelën 18, Kosova renditet mirë krahasuar me ekonomitë e tjera në tranzicion për sa i përket zbatimit të kontratave. Ajo ka performuar më mirë se sa shumica e vendeve të EJJ-së dhe, mesatarisht, më mire edhe se vendet e OECD-së. Për të zbatuar një kontratë të thjeshtë borxhi në Kosovë nevojiten 420 ditë, ndërkohë që mesatarja për vendet e EJJ-së është 506 ditë, ajo e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) është 547, mesatarja e vendeve të CIS-it (angl. Commonwealth of Independent States) është 301 ditë dhe ajo e OECD është 518 ditë. Numri mesatar i ditëve për zbatimin e një kontrate në Kosovë në vitin 2010 është rritur krahasuar me vitin 2005 (Tabela 18). Kjo mund t’i atribuohet rritjes së kredisë gjatë kësaj periudhe ndërkohë që numri i rasteve që dërgohen në gjykatë është rritur vazhdimisht.

Zbatimi i kontratave në Kosovë, megjithatë, mund të pengohet nga kostoja e lartë e zbatimit të kontratës, e cila është më e lartë se sa në të gjitha ekonomitë në tranzicion dhe vendet e OECD. Sipas Doing Business (2011), kostoja e zbatimit të një kontratë në Kosovë, mesatarisht sillet rreth 61 përqind të shumës së borxhit, ndërkohë që mesatarja për vendet e EJJ është 34 përqind, për vendet e EQL është 28 përqind, 24 përqind për vendet e CIS dhe 20 përqind për vendet e OECD.

**Tabela 18. Ditët për Zbatim të Kontratës, Kostoja e Zbatimit dhe Indeksi i Sundimit të Ligjit**

	Ditët për Zbatimin e Kontratës		Kosto (% e borxhit)		Indeksi i Sundimit të Ligjit	
	2005	2010	2005	2010	2005	2009
Kosova (2010)	153	420	...	61	-0.9	-0.5
Shqipëria	390	390	39	39	-0.8	-0.5
Bosnia dhe Hercegovia	330	595	38	40	-0.6	-0.4
Bullgaria	440	564	24	24	-0.1	-0.1
Kroacia	415	561	14	14	0.2	0.2
Maqedonia	335	370	33	33	-0.3	-0.2
Rumania	509	512	20	29	-0.1	0.1
Serbia dhe Mali i Zi	1028	635	33	29	-0.9	-0.4
EJJ (mesatarja)	450	506	29	34	-0.4	-0.2
EQL (mesatarja)	442	547	24	28	0.6	0.4
CIS (mesatarja)	331	301	24	24	-0.9	-0.8
OECD (mesatarja)	280	518	20	20	1.6	1.3

Burimi: Banka Botërore, Doing Business (2011)

Sidoqoftë, ‘Indikatorët e Qeverisjes’ të publikuar nga Banka Botërore paraqesin një gjendje më pak të favorshme sa i përket zbatimit të kontratave, krahasuar me pikëpamjen e prezantuar nga Ditët për Zbatimin e Kontratës, dallim ky që kryesisht i atribuohet

diferencave në metodologji.<sup>16</sup> Indeksi i Sundimit të Ligjit, i cili matet bazuar në disa aspekte të cilësisë së institucioneve dhe reflekton, përveç të tjerash, lirinë civile, lirinë e shtypit, të drejtat politike, krimin, infrastrukturën, zbatueshmërinë e kontratave qeveritare dhe private, si dhe shpejtësinë dhe korrektësinë e proceseve juridike. Ky indeks variron nga -2.5 në 2.5 dhe sa më i lartë që të jetë aq më mirë zbatohet ligji. Indeksi për Sundimin e Ligjit sugjeron se Kosova qëndron në nivel më të ulët se mesatarja e vendeve të EJJL-së për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit. Në vitin 2009, Indeksi për Sundim të Ligjit në Kosovë u vlerësua si -0.5 që është më i ulët krahasuar me mesataren e EJJL, EQL dhe vendeve të OECD, por më i lartë se mesatarja e vendeve të CIS-it. Bazuar në këtë metodologji, zbatimi i ligjit në Kosovë në vitin 2009 u përmirësua krahasuar me vitin 2005 ku shënonte vlerën -0.9.

### 10.3 Procesi gjyqësor ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit: studim empirik

Seksioni i mëparshëm është marrë me zbatimin e të drejtave të kreditorëve në Kosovë, bazuar në tregues të ndryshëm, si Ditët e Zbatimit të Kontratës (angl. Contract Enforcement Days: CED) dhe Indeksi i Sundimit të Ligjit (angl. Rule of Law Index: RLI). Megjithatë, këta tregues kanë disavantazhet e tyre ose për shkak se ata mund të dështojnë për të kapur plotësisht kontekstin e marrëdhënies huadhënës-huamarrësi (indikatori CED) ose janë shumëdimensionalë (indikatori RLI). Në këtë kontekst, CED është ndërtuar duke marrë për bazë kohën që duhet për gjykatat për të trajtuar dy lloje të rasteve: ndjekjen e qiramarrësit për mospagimin e qirasë dhe arkëtimi i një çeku të kthyer për shkak të mospagesës. Koha e nevojshme për zbatimin e një kontrate në këto raste jodomosdoshmërisht mundet të shpjegojë marrëdhëniet huadhënës-huamarrës. Lidhur me RLI, edhe pse ky indikator përfshinë disa karakteristika që lidhen me efikasitetin e zbatimit të kontratave, siç janë zbatimi i kontratave private, korrektësia e sistemit gjyqësor dhe shpejtësia e procesit gjyqësor, RLI përmbanë edhe dimensione të ndryshme të tjera, të tilla si krimi i organizuar, krimi, liritë civile, liria e shtypit, të drejtat politike, infrastruktura, etj. Edhe pse këta tregues mund të shpjegojnë përafërsisht zbatimin e ligjit në një vend të veçantë, ata janë një përzierje e treguesve dhe reflektojnë ambientin e përgjithshëm institucional. Si i tillë, RLI nuk merret në mënyrë eksplicite me zbatimin e ligjit në marrëdhëniet huadhënës-huamarrës.

Nevoja për tu përqëndruar në funksionimin e ligjeve në praktikë në ekonomitë në tranzicion, në mënyrë eksplicite në lidhje me marrëdhëniet huadhënës-huamarrës, ka shtyrë EBRD-në të iniciojë projektin New Legal Indicators Survey (NLIS2003) që synon të ndihmojë kredituesit në vlerësimin e përparësive të mundshme në marrjen e pengut, duke nënvizuar përparësitë dhe dobësitë e kornizës ligjore për kolateral dhe duke krijuar një bazë për krahasim objektiv. Duke u përpjekur për të kapur realitetin, qështja kryesore e studimit ishte vlerësimi i efikasitetit me të cilin mund të ekzekutohet kolaterali i luajtshëm në praktikë.

Siç përshkruhet në EBRD (2003), për anketën e zbatimit të ligjit është adaptuar metodologjia e një rast studimor dhe një rast imagjinar ishte paraqitur për avokatët komerciale në ekonomitë në tranzicion. Ata u pyetën për të vlerësuar se si banka mund të zbatojë të drejtat e tyre në rast të dështimit të huamarrësit. Vlerësimi i kishte tri

<sup>16</sup> 'Indikatorët e Qeverisjes' matin aspekte të ndryshme të cilësisë së institucioneve, si stabilitetin politik, efikasitetin e qeverisë, cilësinë rregullative, kontrollin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit.

dimensione: (i) çfarë shume të vlerës së kredisë kreditori mund të rikthejë, (ii) sa shpejt kreditori mund të rikthejë kredinë, dhe (iii) sa e thjeshtë është procedura e rikthimit (shuma, koha dhe thjeshtësia). Përveç kësaj, 12 pyetje të tjera lidhur me procesin e zbatimit u pyetën për të nxjerrë në pah ndikimin e palëve të treta në këtë proces. Për shembull, në kuadër të faktorëve të procesit është bërë pyetja në qoftë se huamarrësi mund të pengojë procesin, gjë që do të ketë implikime për kohën, shumën dhe dimensionet e thjeshtësisë në procesin e zbatimit. Faktorët e përfshirjes tregojnë se si përgjigjet mund të ndikohen, nëse disa rrethana do të ndryshojnë. Për shembull, deri në çfarë mase do të ndikohet procesi i zbatimit nëse huamarrësi aplikon për falimentim, ose si do të ndikohet procesi i zbatimit në qoftë se kolaterali përbëhet nga pasuri të paluajftëshme.

Në mënyrë që të sigurohet një fotografi më e qartë mbi zbatimin e të drejtave të kreditorëve në marrëdhënien huadhënës-huamarrës në Kosovë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës zhvilloi një anketë me katër nga bankat që operojnë në Kosovë në vitin 2010, bazuar në NLIS 2003. Në këtë anketë janë mbajtur pyetjet origjinale nga NLIS 2003 në mënyrë që të gjenerohen rezultate të krahasueshme me ekonomitë tjera në tranzicion.

Qasja e EBRD ndaj proceseve gjyqësore fokusohet në fazën finale të procesit, d.m.th. si zgjidhet kontesti i kolateralit nga gjykata. Mirëpo, siç është shprehur Hendley (2001), vetëm një numër i vogël i kontesteve përfundojnë në gjykatë sepse ato ose zgjidhen më përpara ose janë të tilla që kostoja potenciale për të proceduar çështjen tejkalon benefitin potencial. Procesi i zgjidhjes së kontestit mund të përfshijë disa faza. Për shembull, Cooter and Rubinfeld (1989) në analizat e tyre për ligjin njohin katër faza të kontestit ligjor: dëmi, vërtetësia e pretendimit ligjor, negocimi dhe gjykimi. Andaj, pyetësi u zgjerua për të hetuar hapa të tjerë të procesit gjyqësor, të cilët nuk janë analizuar më parë nga EBRD. Në të merret në konsideratë çështja e pajtimit vullnetar nga ana e huamarrësit, faza e negocimit në zgjidhjen e kontestit, një dallim më i qartë lidhur me metodat e detyrimit (vetë-realizimi dhe përfshirja e gjyqit) dhe ekzistimi i tregut për kolateral.

Anketa u relizua me katër banka, të cilat sëbashku përbëjnë rreth 80 përqind të aseteve të përgjithshme të sektorit bankar. Anketa u realizua duke intervistuar ekspertë ligjorë, zyrtarë për kredi dhe menaxherët e riskut të këtyre bankave. Për sa i përket rezultateve, kur përgjigjet janë dhënë në interval (p.sh. nevojiten dy deri gjashtë muaj për të zbatuar kërkesën), është marë vlera mesatare. Rrjedhimisht, është nxjerrë mesatarja e të gjitha përgjigjeve të responentëve për të dhënë një vlerësim të vetëm.

## 10.4 Rezultatet

Në këtë pjesë janë paraqitur rezultatet e anketës mbi zbatimin e ligjit të kolateralit në Kosovë dhe më pas janë krahasuar me rezultatet për ekonomitë tjera në tranzicion. Përsa i përket pyetjes mbi 'shumën', që reflekton shumën e mundëshme që mund të kthehet nga ekzekutimi i aseteve të zotuara si kolateral, Kosova shënon 5.5 nga 10 pikë të mundshme, që do të thotë se huadhënësit mund të kthejnë 55 përqind të vlerës së kredisë së dështuar përmes kolateralit të lënë peng (Tabela 19). Krahasuar me rezultatet e përfituara nga e njëjta anketë në vitin 2005, shifrat aktuale tregojnë një rënie të lehtë për sa i përket shumës së kthyer të kredisë. Për sa i përket pyetjes 'sa shpejtë', e cila i referohet kohës që nevojitet për procedurën e zbatimit të kontratës, Kosova shënon 8 pikë nga 10 të mundëshme; që do të thotë se huadhënësit mund të ekzekutojnë kolateralin mesatarisht

brenda gjashtë muajve.<sup>17</sup> Për sa i përket kohës së nevojshme për shlyerjen e kredisë, situata duket se është e ngjashme me atë të pesë viteve më parë. Për “lehtësinë” e procesit të zbatimit, rezultati ishte 5 (nga tre përgjigjet e mundëshme: 1, 5 dhe 10). Arsyeja pse “lehtësia” nuk ka shënuar 10 (shkallën më të lartë) ishte për shkak të përgjigjeve që lidheshin me funksionimin e gjykatave: mungesa e eksperiencës të gjykatësit për këto çështje, mungesa e gjyqeve speciale, mungesa e gjykatësve, etj. Rezultati i përgjithshëm që Kosova ka shënuar në NILS 2003 është 18.5 (5.5 për ‘shumën’, 8 për ‘kohën’ dhe 5 për ‘lehtësinë’), rezultat ky më i ulët për 0.5 pp krahasuar me vitin 2005.

NLIS 2003	2005	2010
Shuma (% e kthimit të kredisë)	6 (60%)	5.5 (56.25%)
Koha (kohëzgjatja e procesit)	8 (6 muaj)	8 (6.25 muaj)
Thjeshtësia	5	5
<b>Faktorët e Procesit</b>		
Pengesat nga huamarrësi	1.67	1.75
Kreditorët preferencial	1	1
Kontrulli i kreditorit	1.67	1
Përvoja praktike	1	1.25
Korrupsioni	2.17	1.75
Institucionet	2.17	2
<b>Faktorët e fushëveprimit</b>		
Fushëveprimi i kolateralit	2	1
Procesi i josolvencës	na	na
Rankimi i josolvencës	1	1
Inventari	1.17	1.5
Kolaterali i paluajshëm	2.5	2.25
Kolaterali i arkëtueshëm	2.5	2.75

Tabela 19. Zbatimi i ligjit të kolateralit në Kosovë (NLIS 2003)

**Shënime:** ‘shuma’ paraqet përqindjen e kredisë të cilën huadhënësit mund të rikthejnë dhe kjo varion nga 0 deri në 10 që është rezultati më i lartë. ‘Koha’ përfaqëson kohën e nevojshme, të shprehur në muaj, brenda të cilës huadhënësit mund të rikthejnë shumën e huazuar dhe varion nga 0 deri në 10, e cila shënon kohën më të shkurtër; lehtësia tregon se sa i lehtë është procesi i zbatimit dhe ky proces merr vlerat 1, 5 dhe 10, ku procesi përfshin komplikime të mëdha, të mesme dhe të vogla. Faktorët e procesit dhe fushëveprimit vlerësohen me 1, 2 dhe 3, ku një faktor i caktuar përfaqëson një problem të madh, të mesëm ose të vogël gjatë procesit të zbatimit.

Për sa i përket faktorëve që ndikojnë në zbatimin e procesit, problemet më të mëdha ishin ‘patundshmëritë’ dhe ‘të hyrat e arkëtueshme’. Rezultati ishte 2.25 për ‘patundshmëritë’ dhe 2.75 për ‘të hyrat e arkëtueshme’, që do të thotë se procesi i zbatimit që përfshinë patundshmëritë dhe të hyrat e arkëtueshme si kolateral është më kompleks për sa i përket ekzekutimit të kolateralit. Krahasuar me vitin 2005, është vërejtur një përmirësim i lehtë në lidhje me ekzekutimin e kolateralit në formë të patundshmërive, ndërkohë që me të ardhurat e arkëtueshme ka ndodhur e kundërta. Pengesat tjera më të larta u dedikohen faktorëve “institucionet” (2), “korrupsioni” (1.75) dhe “pengesat nga ana e huamarrësit” (1.75). Rezultati 2 për institucionet sugjeron se joefikasiteti e institucioneve krijon probleme për bankat, kryesisht për shkak të mungesës së gjyqtarëve, gjë e cila ngadalëson zgjidhjen e rasteve të mos kthimit të kredive. Krahasuar me vitin 2005, joefikasiteti i

<sup>17</sup> Rezultati zero do të thotë se procesi mund të marrë 24 muaj ose më shumë, ndërsa rezultati maksimal 10 do të thotë se procesi mund të zgjasë vetëm një muaj.

institucioneve duket të jetë pengesë më e madhe për bankat, gjë e cila mund t'i atribuohet zgjerimit të portofolios kreditorë të sektorit bankar. Kjo nënkupton se një numër më i madh i rasteve dërgohen në gjykatë, ndërkohë që numri i gjyqtareve raportohet të jetë i pa mjaftueshëm. Ankesat kryesore të responentëve kishin të bënin me mungesën e ekspertizës dhe resurseve të gjykatave për të kryer punën e tyre. Andaj, procesi i zbatimit do të lehtësohej nëse do të ekzistonin gjykata të specializuara komerciale ose gjykatës të specializuar që do të merreshin vetëm me kontestet komerciale.<sup>18</sup> Korrupsioni i zyrtarëve gjyqësorë është një problem i moderuar dhe krahasuar me 2005 rezultati për korrupsion ka shënuar një rënie të vogël, gjë që do të thotë se ekziston një perceptim më i vogël për prezencën e korrupsionit në gjykata. “Pengesat nga huamarrësi” (1.75), që lidhen me mundësitë që ekzistojnë që huamarrësi të parandalojë, ngadalësojë apo bllokojë procesin e zbatimit të kontratave, poashtu paraqitet të përbjë një pengesë të moderuar në procesin e zbatimit. Krahasuar me vitin 2005, ‘pengesat nga ana e huamarrësit’ duket se janë rritur, kryesisht sepse huamarrësit janë duke shkaktuar vazhdimisht vonesa në proces, duke dërguar ankesa të pa baza ose duke ndikuar procesin në mënyra të tjera. Për sa i përket përfshirjes së kolateralit, një kategori e gjerë asetesh mund të shërbejë si kolateral dhe zëvendësimi i kolateralit ose përfshirja e një kolateralit të ri është e mundshme, andaj përfshirja e kolateralit është vlerësuar me vlerën 1.

Rezultati 1 është shënuar gjithashtu për “kreditorët e preferuar”, “kontrollin e kredisë” dhe “rangimin e josolvencës”. Për shembull, nuk ka kreditorë të preferuar që mund të kenë prioritet kundrejt pretendimeve të bankës. I njëjtë është rasti me ligjin mbi falimentimin e ndërmarrjeve, i cili u jep prioritet kreditorëve të siguruar (rangimi i josolvencës). Pastaj, rezultatet sugjerojnë se bankat kanë mjaftë ‘eksperiencë’ në praktikë me procesin e zbatimit të kontratave përmes sistemit gjyqësor, ndërsa ‘inventari’ paraqitet mjaftë efektiv si kolateral. Prosesi i ‘josolvencës’ nuk u vlerësua për shkak të mungesës së eksperiencës së bankave me procedurat e falimentimit të ndërmarrjeve.

Në përgjithësi, rezultatet e anketës tregojnë se zbatimi i të drejtave të kreditorëve në praktikë në Kosovë, në vitin 2010, kishte nivel të ngjashëm me vitin 2005. Kjo është në pajtim me pikëpamjen se institucionet në përgjithësi ndryshojnë ngadalë (Clague *et al.*, 1997). Duke marrë parasysh se situata për sa i përket zbatimit të të drejtave të kreditorëve në Kosovë në vitin 2010 ishte e ngjashme me vitin 2005, si dhe faktin se në përgjithësi institucionet vlerësohen të ndryshojnë ngadalë, kemi krahasuar rezultatet nga anketa e vitit 2010 në Kosovë me rezultatet e EBRD-së për ekonomitë tjera në tranzicion të realizuar në vitin 2003, përkundër distancës kohore ndërmjet dy anketave (Tabela 20). Për sa i përket rezultatit të përgjithshëm për pyetjet e NLIS 2003, rezultati prej 18.5 për Kosovën është mbi rezultatit mesatar për vendet e EJK-së dhe CIS-it, por nën mesataren e vendeve të EQL-së. Për sa i përket vendeve të rajonit individualisht, Bullgaria, Kroacia, dhe Maqedonia radhiten më lartë se vendet tjera. Për sa i përket faktorëve të ‘procesit’ dhe ‘fushëveprimit’, Kosova shënon 1.57 duke tejkalluar kështu mesataren e CIS-it (2.18), atë të EJK-së (1.94) si dhe të EQL-së (1.68). Për faktorët e ‘procesit’ dhe ‘përfshirjes’, vlerat më të ulëta tregojnë performancë më të mirë.

<sup>18</sup> Sipas Stanfield, *et al.* (2004), në Kosovë rastet komerciale kanë më pak prioritet se sa rastet kriminale dhe rastet tjera. Për më tepër, numri i gjykatësve në Prishtinë në 1989 (kur kishte 120,000 banorë) ishte 35, ndërsa në 2004 numri i gjykatësve ishte 26 (ndërkohë që llogariteshin rreth 500,000 banorë).

Tabela 20. Zbatimi i ligjeve të kolateralit në Kosovë, EJL, EQL dhe CIS

	Shuma', 'Koha' and 'Thjeshtësia'	Faktorët e 'procesit' dhe 'përfshirjes'
Kosova (2010)	18.5	1.57
Shqipëria	18	1.92
Bosnia dhe Hercegovia	4	2.58
Bullgaria	23	1.83
Kroacia	22	1.83
Maqedonia	21	1.58
Rumania	18	1.67
Serbia dhe Mali i Zi	19	2.17
EJL (mesatarja)	17.9	1.94
EQL (mesatarja)	24.3	1.68
CIS (mesatarja)	13.2	2.18

Burimi: EBRD (2003) dhe anketa vetanake për Kosovë.

Shënime: 'shuma', 'koha' dhe 'lehtësia' radhiten nga 0 deri në 30 dhe sa më e lartë renditja aq më i mirë zbatimi; faktorët e 'procesit' dhe 'fushëveprimt' marin vlerat 1, 2 dhe 3 ku një faktor i caktuar paraqet respektivisht një problem të vogël të mesëm apo të madh gjatë procesit të zbatimit.

## 10.5 Pajtimi vullnetar, negociimi, vetë-realizimi dhe tregu për kolateral

Në kontekst të marrëdhënies klient-bankë, procesi i zgjidhjes së kontestit mund të mendohet si lojë me zgjidhje që realizohen hap pas hapi ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit që nuk paguan. Çdo hap influencon pretendimin për kthim të shumës nga ana e huadhënësit. Së pari, kontesti mund të zgjidhet me pajtim vullnetar, d.m.th pa përfshirjen e institucioneve formale. Ndoshta shumica e rasteve zgjidhen në këtë mënyrë sepse kërcënimi me masa ligjore që banka i bën huamarrësit që nuk shlyen detyrimin ndonjëherë mjafton. Në këtë fazë, një pjesë e borxhit shlyhet dhe nevojitet pak kohë që të realizohet shlyerja. Evolimi i pajtimit vullnetar mund të ndërlihet me një sërë mundësishë. Agjentët mund të kuptojnë se funksionon ligji dhe institucionet që mbështesin ligjin. Ose mund të mos kenë asnjë njohuri mbi ligjin dhe ti binden kontratave, thjeshtë bazuar në mirëbesim. Përndryshe, agjentët mund të ngurrojnë të përballen me institucionet e shtetit, mund të brengosen për reputacionin e tyre dhe/ose nuk llogarisin kostot/përfitimet nga mospagesa. Nga ana tjetër, bankat mund të mos preferojnë të përdorin gjykatat sepse i konsiderojnë ato si të ngadalshme ndaj zgjedhin të përdorin mjete të tjera. Hay *et al.* (1996) theksoi se sistemi ligjor mund të mos përdoret për të zgjidhur konteste sepse gjykatat e jofunksionale rrisin koston e shfrytëzimit të sistemit ligjor; taksat mund të jenë shumë të larta; gjyqtarët mund të jenë të korruptuar, të pa informuar, dhe jo kompetentë; gjykatat mund të jenë të paparashikueshme ndaj mund të nevojiten vite për të zgjidhur një kontest, për të cilën kohë, edhe vlera e kërkesave që pritet të rimbursohet bie në zero.

Motivet për pajtim vullnetar me ligjin duket se janë të ndryshme. Nëse institucionet e bëjnë kredibil "kërcënimin" për zbatim të kontratës, atëherë pajtimi vullnetar është më i pranueshëm për klientët se sa detyrimi dhe kostot e transaksionit reduktohen. Cross (2002) potencon se bazuar në atë se sa agjentët besojnë se funksionon sistemi, reduktohet edhe kostoja për zbatimin e rregullave, thjesht nga fakti se individët nuk do të guxonin të mos u bindeshin rregullave apo të dhunonin të drejtën e pronës, një supozim ky standard në teorinë ligjore. Andaj, duke parë vetëm pjesën formale të kontestit, zgjidhja e tij është vetëm një pjesë e tregimit. Zgjidhjet formale dhe joformale nuk mund të shihen si

zëvendësuese të njëra-tjetërës, ato plotësojnë njëra-tjetërën, sidomos kur zgjidhjet formale janë efikase, informalet duhet të jenë më të shprehura. Çështja e pajtimit vullnetar nuk është studiuar nga EBRD meqenëse metodologjia është dizajnuar ekskluzivisht për të eksploruar se si funksionojnë gjykatat.

Së dyti, faza e negocimit mund të mendohet si një tjetër hap para se kontesti të mbërrijë të zgjidhja formale. Përsëri, një pjesë e borxhit do të shlyhet dhe do të marrë kohë derisa të realizohet shlyerja. Pala më e dobët në procesin e negocimit nxjerr në pah funksionimin e institucioneve, ose të paktën perceptimin mbi atë se si funksionojnë institucionet. Nëse huadhënësit janë më të dobët në këtë fazë, d.m.th të gatshëm për të bërë lëshime, kjo mund të sinjalizojë performancë të dobët të institucioneve në zgjidhjen e kontesteve. Edhe kjo çështje nuk është studiuar nga EBRD.

Së treti, kur arrihet të zbatimi ekzistojnë dy mundësi: (i) vetë-realizimi, d.m.th huadhënësi merr kolateralin me anë të urdhërit të gjykatës por duke mos përfshirë zyrtarët gjyqësorë (apo policinë), ose (ii) përfshirja e gjykatës. Nëse shumica e kontesteve zgjidhen me vetë-realizim, përsëri kjo nuk reflekton shumë efikasitetin e ligjit në mënyrë eksplicite. Por mund të sinjalizojë kredibilitetin e institucioneve, që do të nënkuptonte implikime të rëndësishme për politikën. Veçanërisht, detyrimi nga shteti do të ishte i nevojshëm vetëm në shumë pak raste, sidomos në shoqëri të vogla, sa për ta bërë “kërcënimin” e besueshëm dhe, si rezultat, zbatimi do të ishte mjaft efikas dhe me kosto të ulët.

Siç u përmend më lart, hulumtimi aktual zgjeron anketën e EBRD-së për të kapur faza dhe elemente të tjera që paraqiten para zbatimit formal, siç janë pajtimi vullnetar, negocimi, vetë-ndihma dhe tregu për kolateral. Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 60 përqind e kredive të pa paguara nuk arrijnë kurrë deri në gjykatë dhe zgjidhen me pajtim vullnetar, pasi që është bërë “kërcënim” apo paralajmërimi. Në këto raste rikthimi është 50 përqind e shumës. Ndër “kërcënimet” e përdorura nga bankat, respondentët konsiderojnë si më efikas inatë se “banka do të konfiskojë kolateralin” të pasuar nga “banka do ta dërgojë çështjen në gjykatë”. Në vend të tretë ishin konsideratat e reputacionit si “banka nuk do të ju jep më kredi në të ardhmen”, “banka do të detyrojë garantuesin të paguajë borxhin”, etj. Kjo mund të japë një përshtypje të kredibilitetit të institucioneve në vend ose të paktën të marrëdhënies huadhënës-huamarrës. Zbatimi i të drejtave të kreditorëve është mjaft i varur edhe në masën në të cilën kreditorët ndjekin pretendimet e tyre në mënyrë aktive, duke kërkuar shërbime ligjore. Zbatimi më i mirë i ligjit paraqitet kur personeli ligjor punon në mënyrë intenzive në çështjet kontraktuale dhe kur personeli i ndërmarrjes posedon më shumë kapital njerëzor (Hendley, *et al.* 2001). Për rastin e Kosovës, KCBS (2005) vë në dukje se një bankë në mënyrë agresive zbaton riposedimin dhe të drejtën për të shitur kolateralin me ndihmën e stafit të vet ligjor që punojnë ngushtë me gjyqtarë, ndonjëherë "duke u treguar atyre se si", dhe është mjaft e suksesshme.

Kur dështojnë “kërcënimet” pason faza e negociatave, edhe pse praktikohet rrallë (në më pak se 20 përqind të rasteve). Nëse negociatat realizohen ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit mospagues, huadhënësit nuk bëjnë lëshime të mëdha. Për shembull, ata mund të shtyjnë periudhën e shlyerjes por jo diçka tjetër. Përsëri, në këto raste kthimi i borxhit është i lartë (rreth 70 përqind e shumës). Kjo tregon pozicion më të mirë negociatave të bankave dhe poashtu kredibilitetin e institucioneve. Pas fazës së negociatave, janë dy mundësi: vetë-ndihmesa ose përfshirja e gjykatës. Në rast të vetë-ndihmesës, d.m.th. bankat konfiskojnë kolataralin me vendim të gjykatës por pa përfshirjen e zyrtarëve gjyqësorë dhe/apo policisë. Rezultatet tregojnë se mesatarisht 3 përqind e rasteve zgjidhen në këtë formë, rreth 20 përqind e shumës së borxhit arrihet të kthehet dhe procesi zgjatë



mesatarisht 2 muaj. Kur flasim për ekzistimin e tregut për kolateral, pasqyra ndryshon. Përgjigjet e bankave sugjerojnë se, mesatarisht, bankat arrijnë të shesin vetëm rreth 30 përqind të aseteve të lena peng, rreth 50 përqind e shumës së kredisë arrihet të kthehet dhe procesi zgjatë mesatarisht 3.5 muaj.

## 10.6 Përfundim

Fundi i luftës në vitin 1999 shënoi kohën kur Kosova filloi të ndërtojë institucionet e saj. Prej atëherë Kosova ka shënuar përparim substancial në themelimin dhe vënien në funksion të institucioneve të nevojshme për veprimtarinë e një ekonomie të tregut, përfshirë edhe përgatitjen e kushteve që sigurojnë funksionimin e tregut financiar dhe mbrojtjen e të drejtave të kreditorit. Bazuar në ligjet e shkruara, Kosova ka bërë përparim të dukshëm në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të kreditorëve, duke tejkaluar ekonomitë e tjera në tranzicion si dhe disa vende të zhvilluara. Mirëpo, pasqyra nuk është shumë e qartë kur bëhet fjalë për zbatimin e të drejtave të kreditorëve në praktikë. Bazuar në treguesin mbi Ditët për Zbatimin e Kontratës, Kosova qëndron më mirë se sa ekonomitë e tjera në tranzicion dhe disa vende të OECD-së. Nga ana tjetër, Indeksi i Sundimit të Ligjit, ofruar nga Banka Botërore, paraqet një pamje më pak të favorshme për Kosovën, duke sugjeruar se ajo mbetet prapa vendeve të tjera për sa i përket zbatimit të ligjit. Megjithatë, këta tregues kanë të metat e tyre dhe, si të tillë, nuk mund shpjegojnë plotësisht zbatimin e të drejtave të kreditorëve në mënyrë specifike në marrëdhëniet huadhënës-huamarrës.

Mbështetur në metodologjinë e EBRD-së (NLIS 2003), është bërë një anketë me disa nga bankat që operojnë në Kosovë me qëllim të sigurimit të një vlerësimi të përditësuar mbi zbatimin e të drejtave të kreditorëve në marrëdhëniet huadhënës-huamarrës. Rezultatet e studimit tregojnë se, në krahasim me vitin 2005, pasqyra e përgjithshme për zbatimin e të drejtave të kreditorëve në Kosovë është në përgjithësi e njëjtë. Ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në procesin e zbatimit të kontratës, në bazë të përgjigjeve të bankave, janë mungesa e efikasitetit të gjykatave, prezenca e korrupsionit dhe pengesat e shkaktuara nga huamarrësit. Lidhur me mungesën e efikasitetit të gjykatave, ankesat kryesore të të anketuarve kanë qenë se gjykatat nuk kanë ekspertizë dhe burime të mjaftueshme për të bërë punën e tyre. Prandaj, procesi i zbatimit do të lehtësohej nëse gjykata të veçanta komerciale apo gjyqtarë të specializuar do të merreshin me kontestet komerciale. Mungesa e efikasitetit të gjykatave është raportuar të shkaktojë vonesa në procesin e zbatimit të kontratës dhe, në një farë mase, mund të ketë nxitur kulturën e mospagimit nga huamarrësit, që mund të shprehet nga rritja e pengesave të huamarrësve në procesin e zbatimit. Megjithatë, rezultatet tregojnë se Kosova krahasohet mirë me vendet e rajonit dhe ekonomitë tjera në tranzicion për sa i përket zbatimit të të drejtave të kreditorëve. Anketa është zgjeruar edhe për të mbuluar fazat e tjera para zbatimit ligjor, të tilla si pajtimi vullnetar, negocimi, vetë-ndihmesa dhe tregut i kolateralit. Rezultatet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e rasteve të dështuara nuk arrijnë fare në gjykatë, por zgjidhen me pajtim vullnetar, duke theksuar rolin e kredibilitetit të institucioneve në procesin e zbatimit të kontratës.

## 11. Qasja në Financa në Kosovë: Rezultatet nga BEEPS 2009

Valentin Toçi, Zana Gjocaj dhe Arben Mustafa

### 11.1 Hyrje

Kjo analizë trajton qasjen e firmave në financimin bankar në Kosovë dhe në vendet e EJJ-së. Analiza kryesisht mbështetet në të dhënat nga Anketa mbi Ambientin Afarist dhe Performancën e ndërmarrjeve BEEPS (angl. Business Environment and Enterprise Performance Survey) që është projekt i përbashkët i Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, i dizajnuar që përmes anketave me ndërmarrjet të mbledh informacione rreth ndikimit të ambientit afarist në zhvillimin e ndërmarrjeve. Këto anketa u zhvilluan në pothuaj të gjitha vendet në tranzicion në vitet 1999, 2002, 2005, 2007 dhe 2009 dhe kishin për qëllim të vlerësojnë pengesat kryesore që hasin bizneset në veprimtarinë e tyre dhe në rritjen e ndërmarrjes. Përveç informacionit subjektiv lidhur me pengesat që ndërmarrjet hasin gjatë operimit të tyre, të gjitha ciklet e BEEPS ofrojnë informacion edhe mbi karakteristikat objektive të ndërmarrjeve dhe indikatorët e performancës së tyre si: niveli dhe rritja e shitjeve, burimet e financimit që përdorin ndërmarrjet për të financuar investimet e tyre, profitabiliteti, etj.

Anketat e BEEPS paraqesin një burim të rëndësishëm informacioni për të vetëdijësuar hartuesit e politikave mbi pengesat që hasin bizneset, si dhe për të ndihmuar në krijimin e politikave që kontribuojnë në përmirësimin e ambientit afarist. Një ndër pengesat më të rëndësishme për zhvillimin e bizneseve është edhe mundësia e qasjes së tyre në financa, pengesë kjo që mund të nxitet qoftë nga politikat joadekuate të shtetit (p.sh. kur të drejtat e kreditorëve nuk janë të mbrojtura mirë si pasojë joefikasitetit të sistemit gjyqësor) qoftë nga faktorë të ndryshëm të tregut, siç janë imperfeksionet e tregjeve të cilat mund të vështirësojnë dhe shtrenjtojnë qasjen e bizneseve në financa.

Qasja e lehtë në financim të jashtëm ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e bizneseve dhe, rrjedhimisht, për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në vend. Prandaj, implementimi i anketës BEEPS në Kosovë në vitin 2009 ka ofruar një mundësi të mirë për identifikimin e pengesave dhe sfidave kryesore me të cilat përballen bizneset në vend, posaçërisht problemeve të bizneseve në qasje në financa.

Anketa e BEEPS e realizuar në Kosovë përfshinë 270 ndërmarrje, 70 përqind e të cilave ndërmarrje të vogla. Mbi 50 përqind e ndërmarrjeve të anketuara në Kosovë kanë deklaruar se janë prezente në treg për një periudhë 6-10 vite, ndërkaq 20 përqind e tyre deklaruan një periudhë prej 16-20 vite. Të gjitha ndërmarrjet e anketuara janë në pronësi vendore, 38 përqind e ndërmarrjeve ishin deklaruar si ndërmarrje prodhuese, 6.3 përqind si ndërmarrje tregtare, ndërsa 38.5 përqind ofronin shërbime të tjera. Kur kemi parasysh strukturën e ekonomisë së Kosovës, ku dominojnë ndërmarrjet tregtare, mund të themi se anketa e BEEPS mund të mos jetë një mostër reprezentative për ekonominë e vendit.

### 11.2 Pengesat kryesore për bizneset në Kosovë

Sipas anketës BEEPS, në listën prej dhjetë pengesave kryesore për zhvillim të biznesit në Kosovë, të parat u radhitën mungesa e energjisë elektrike, prezenca e korrupsionit, ekonomia joformale, etj. (Figura 78). Në vitin 2009, rreth 33.5 përqind të bizneseve të

anketuara në Kosovë konsideruan energjinë elektrike si pengesën kryesore për zhvillimin e biznesit të tyre, duke reflektuar kështu problemet e vazhdueshme të furnizimit me energji elektrike në vend.<sup>19</sup>


Po ashtu, edhe prezenca e korrupsionit (20.6 përqind) dhe ekonomisë joformale (12.8 përqind) paraqesin pengesë të madhe për ndërmarrjet në Kosovë. Për dallim nga shumë vende të rajonit, qasja në financa në Kosovë nuk u konsiderua si pengesë thelbësore nga bizneset e anketuara, ku vetëm 2 përqind e bizneseve raportuan qasjen në financa si pengesën kryesore për zhvillimin e tyre. Kjo kryesisht për shkak se Kosova ende ballafaqohet me vështirësi të tjera më me rëndësi për bizneset siç janë infrastruktura dhe problemet tjera të ndërlidhura me ambientin ekonomik në përgjithësi.

Në vendet e rajonit, pjesëmarrja e ndërmarrjeve që deklarojnë qasjen në financa si pengesën kryesore për biznesin e tyre është dukshëm më e lartë se sa në Kosovë. Në Maqedoni, 26.9 përqind e ndërmarrjeve të anketuara kanë deklaruar se qasja në financa përfaqëson pengesën kryesore për biznesin e tyre, pasuar nga Romania dhe Sllovenia me 19.9, përkatësisht 19.2 përqind të gjithsej ndërmarrjeve. Ndërsa, me pjesëmarrje më të ulët të ndërmarrjeve që ranguan qasjen në financa si pengesën kryesore për ndërmarrjet, përveç Kosovës ishin edhe Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina. Karakteristikë e përbashkët po thuaj për të gjitha vendet e rajonit është pjesëmarrja relativisht e lartë e ndërmarrjeve që konsiderojnë si pengesë kryesore për rritjen dhe zhvillimin e biznesit të tyre prezencën e sektorit joformal të ekonomisë, korrupsionin dhe jostabilitetin politik.

### 11.3 Qasja në financa


Qasja në financa në Kosovë dhe EJT është përmirësuar ndër vite, por vazhdon të jetë në nivel më të ulët krahasuar me vendet e zhvilluara. Edhe pse përqindja e ndërmarrjeve që raportojnë qasjen në financa si pengesën kryesore për të zhvilluar biznesin e tyre është mjaftë e ulët në Kosovë, përqindja e ndërmarrjeve që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse qasja në financa është pengesë për zhvillimin e biznesit të tyre është më e lartë. Nga gjithsej ndërmarrjet e

Figura 78. Dhjetë pengesat kryesore për biznesin në Kosovë



Burimi: www.enterprisesurvey.org

Figura 79. Përqindja e firmave që identifikojnë qasjen në financa si pengesë për të bërë biznes




Burimi: www.enterprisesurvey.org

<sup>19</sup> Rezultatet të cilat paraqesin mungesën e energjisë elektrike si pengesën kryesore mund të kenë qenë në një masë të ndikuar nga veprimtaria e ndërmarrjeve, pasi që pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të anketuara ishin ndërmarrje prodhuese të cilat janë më shumë të varura nga furnizimi i rregullt me energji elektrike.

anketuara në Kosovë, 12.9 përqind raportuan se qasja në financa paraqet pengesë për zhvillimin e aktivitetit të tyre afarist (Figura 79). Sidoqoftë, kjo përqindje është më e ulët krahasuar me mesataren prej 20.7 përqind në vendet e rajonit. Në mesin e vendeve të rajonit, pjesëmarrjen më të lartë të ndërmarrjeve që raportuan qasjen në financa si pengesë për të bërë biznes e tyre kishin Serbia (27.9 përqind) dhe Maqedonia (27.7 përqind).

Përkundër rezultateve që sugjerojnë se në Kosovë qasja në financa shihet si pengesë më e vogël për ndërmarrjet krahasuar me vendet tjera, niveli i qasjes së ndërmarrjeve në financa në Kosovë është më i ulët krahasuar me vendet tjera të rajonit. Nga të gjitha ndërmarrjet e anketuara në Kosovë, vetëm 15 përqind kanë deklaruar se shfrytëzojnë kredi nga institucionet financiare, përderisa mesatarja për vendet tjera të rajonit ishte 58.8 përqind (Figura 80). Kjo tregon për shkallën e ulët të shfrytëzimit të

Figura 80. Përqindja e firmave që marrin kredi nga institucionet financiare




Burimi: www.enterprisesurvey.org

financimit nga institucionet financiare në Kosovë dhe mbështetjen më të lartë të ndërmarrjeve në financimim të brendshëm. Shkalla e ulët e shfrytëzimit të financimit bankar në Kosovë paraqitet edhe përmes 'Financial Access Survey' të FMN-së, ku në një 1000 banorë të rritur në Kosovë, numri i kredimarrësve në bankat komerciale paraqitet të jetë rreth 130 banorë (Figura 81). Nga vendet e rajonit, Serbia dhe Mali i Zi kishin rreth 172 dhe 218 kredimarrës në 1000 banorë të rritur, përderisa një pjesë e madhe e vendeve të rajonit nuk posedonin të dhëna për këtë indikator. Ndër vendet e rajonit, vetëm Shqipëria ka numër më të vogël të kredimarrësve në 1000 banor të rritur se sa Kosova.

Qasja më e kufizuar e ndërmarrjeve në financim bankar në Kosovë tregohet edhe përmes indikatorit të shkallës së kreditimit të sektorit privat si pjesëmarrje e PBB-së. Përderisa në Kosovë, shkalla e kreditimit të sektorit privat si pjesëmarrje e PBB-së në vitin 2009 ishte 32.9 përqind, mesatarja e rajonit për këtë indikator në të njëjtën periudhë ishte 52.7 përqind. Shkallën më të lartë të kreditimit të sektorit privat si pjesëmarrje e PBB-së kishte Mali i Zi (77.7 përqind) dhe Kroacia (66.5 përqind), ndërkaq shkallën më të ulët të kreditimit të sektorit privat në rajon, pas Kosovës, kishte raportuar Shqipëria (36.6 përqind).

Figura 81. Numri i huamarrësve në banka komerciale, në 1 000 të rritur



Burimi: Financial access survey, IMF

Literatura mbi qasjen në financa sugjeron se pavarësisht madhësisë apo pronësisë, ndërmarrjet kanë tendencë të shfrytëzojnë fondet e brendshme deri në maksimum dhe vetëm pastaj të orientohen drejt financimit bankar, kryesisht për shkak të kostove të transaksionit për marrjen e kredive bankare, si kostot e aplikimit, ekzaminimit bankar,


kostot e falimentimit, etj. (Hashi and Toçi, 2010). Megjithatë, duhet pasur parasysh që financimi përmes kanaleve tjera të financimit mund të ndikojë negativisht rritjen dhe zhvillimin e bizneseve, pavarësisht madhësisë së tyre (Chavis et al. 2010). Kjo deri në një masë mund të jetë për shkak se në rastet kur ndërmarrja kreditohet nga bankat, roli i bankës po ashtu është të monitorojë shpenzimin e mjeteve të huazuara si dhe të monitorojë menaxhimin dhe performancën e përgjithshme të ndërmarrjes, duke kontribuar kështu në rritjen e mëtejme të efikasitetit të ndërmarrjes së kredituar.

Ndërmarrjet e vogla konsiderohet të jenë më të kufizuara për sa i përket mundësisë së tyre për të siguruar qasje në financa. Këto ndërmarrje konsiderohet që bartin nivel më të lartë të rrezikut kreditor për shkak se mungesa e informacionit për veprimtarinë e ndërmarrjes shkakton pasiguri tek institucionet financiare për të financuar këto ndërmarrje. Pengesat që hasin ndërmarrjet e vogla në financim bankar në të shumtën e rasteve i shtyjnë ato që të orientohen kanaleve tjera të financimit (fondet vetanake, huamarrje nga familja, kreditimi joformal, etj). Rezultatet e gjeneruara përmes anketave të BEEPS mbështesin teorinë, pasi që si në Kosovë ashtu edhe në rajon, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme rezultuan të jenë më të kufizuara në qasjen në financim bankar, krahasuar me ndërmarrjet e mëdha.

Për më tepër, përderisa në Kosovë rreth 70 përqind e ndërmarrjeve të anketuara përmes BEEPS ishin ndërmarrje të vogla, në rajon mesatarisht rreth 43.8 përqind e ndërmarrjeve ishin deklaruar si ndërmarrje të vogla. Kjo mund të arsyetojë deri në një masë shkallën e ulët të financimit bankar në vitin 2009 në Kosovë. Gjithashtu, nga gjithsej ndërmarrjet e anketuara, ndërmarrjet e vogla në Kosovë deklaruan se përdorin më pak kredi apo huamarrje nga institucionet financiare (12.0 përqind të ndërmarrjeve të vogla që janë anketuar) krahasuar me ndërmarrjet e mesme apo të mëdha (përkatesisht 25.6 dhe 30.1 përqind). Në rajon, mesatarisht rreth 52.9 përqind e ndërmarrjeve të klasifikuara si ndërmarrje të vogla deklaruan se shfrytëzojnë financim bankar në vitin 2009, përderisa mesatarja e shfrytëzimit të financimit bankar për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha ishte më e lartë (përkatesisht 67.7 përqind dhe 71.9 përqind). Ndërmarrjet e mëdha kanë qasje më të lehtë në financim bankar kryesisht për shkak të historikut më të gjatë të veprimtarisë, pasi që prezenca e informacionit lehtëson dhe mundëson përzgjedhjen më të mirë të kredimarrësve nga ana e bankave. Qasja më e lehtë në financim të jashtëm ndikon që ndërmarrjet e mëdha të zgjerojnë më tej aktivitetin e tyre.

Qasja e kufizuar në financim bankar për ndërmarrjet e vogla nuk rrjedhë vetëm nga kufizimi i ofertës së bankave dhe tendencës për refuzim të kredive për ndërmarrjet e vogla, por edhe nga kërkesa për financim bankar nga këto ndërmarrje. Ndërmarrjet e vogla kanë tendencë të aplikojnë më pak për kredi bankare krahasuar me ndërmarrjet e mëdha pasi që kostoja e transaksionit për procesin e aplikimit mund të jetë shumë e lartë apo vlera e kolateralit që posedojnë është e ulët dhe nuk përmbush standardet e kërkuara. Kjo nënkupton që ndërmarrjet e vogla në të shumtën e rasteve vlerësojnë se kosto për të marr kredi nga bankat është e lartë dhe si rrjedhojë, nuk

Figura. 82 Përqindja e ndërmarrjeve që shfrytëzojnë financim bankar për investime



Burimi: [www.enterprisesurvey.org](http://www.enterprisesurvey.org)

aplikojnë fare duke lehtësuar kështu procesin e përzgjedhjes së kredimarrësve për sektorin bankar.

Përveç shkallës më të ulët të qasjes në financim bankar, Kosova dallohet nga vendet tjera edhe për sa i përket qëllimit për të cilin shfrytëzohen kreditë nga ndërmarrjet. Vetëm 25.3 përqind e ndërmarrjeve kanë deklaruar se shfrytëzojnë financimin bankar për investime, përderisa mesatarja e rajonit për këtë tregues është 49.6 përqind (Figura 82). Të dhënat nga anketa po ashtu sugjerojnë se ndërmarrjet financojnë vetëm 9.4 përqind të investimeve të tyre përmes financimit bankar


(mesatarja e rajonit ishte 28.2 përqind), ndërsa pjesa tjetër investimeve financohet përmes kanaleve të tjera të financimit si fondet vetanake, huamarrje nga familja, etj. (Figura 83).

Shkalla më e ulët e shfrytëzimit të financimit bankar në Kosovë ndërlihet me shumë faktorë. Kriza financiare globale e viteve të fundit ka ndikuar në shtrëngimin e kreditimit, gjë që është shprehur edhe në tregun financiar në Kosovë. Bankat kanë shtrënguar kreditimin sidomos për ndërmarrjet, gjë që mund të ketë ndikuar në zvogëlimin e qasjes së tyre në financim bankar. Për më tepër, ndërmarrjet në vend hasin në pengesa të shumta kur vendosin t'i qasen financimit bankar. Nëse marrim parasysh vlerën e kolateralit, shohim se raporti i mbulimit të kredive me kolateral në Kosovë është mjaft i lartë dhe tejkalon mesataren e rajonit. Sipas të dhënave nga anketa, raporti i mbulimit të kredisë me kolateral në Kosovë qëndron në

mesatarisht 236.1 përqind, përderisa mesatarja për vendet e rajonit është 126.6 përqind (Figura 84). Kjo gjë e bënë më të vështirë qasjen e ndërmarrjeve në financimin bankar dhe dekurajon ndërmarrjet për të aplikuar për kredi bankare. Sa i përket madhësisë së ndërmarrjes, sa më e vogël që është ndërmarrja, aq më i lartë paraqitet të jetë raporti i mbulimit të kredisë me kolateral, gjë që ndikon negativisht mundësitë e ndërmarrjeve të vogla për të siguruar


qasje në finance. Norma e lartë e kolateralit të nevojshëm për të marrë kredi nga bizneset në vend mund të ndërlihet me nevojën për efikasitet më të lartë të sistemit gjyqësor, gjë që do të kontribuonte në lehtësimin e ekzekutimit të kolateralit për kreditë e dështuara. Raporti i lartë i mbulimit të kredisë me kolateral në Kosovë deri në një masë mund t'i atribuohet edhe strukturës së ndërmarrjeve të anketuara ku dominojnë ndërmarrjet e vogla.

Figura 83. Përqindja e investimeve të mbuluara nga financimi bankar



Burimi: [www.enterprisesurvey.org](http://www.enterprisesurvey.org)

Figura 84. Raporti i mbulimit të kredisë me kolateral, në % të vlerës së kredisë



Burimi: [www.enterprisesurvey.org](http://www.enterprisesurvey.org)

Qasja e kufizuar e ndërmarrjeve në financa në Kosovë mund t'i atribuohet edhe normave të interesit në Kosovë, të cilat konsiderohet të jenë më të larta se sa në vendet tjera të rajonit. Norma mesatare e interesit në kredi prej rreth 14 përqind në Kosovë tejkalon normën mesatare të interesit prej 7.9 përqind në vendet e rajonit.<sup>20</sup> Normat e larta të interesit mund të dekurajojnë një pjesë të bizneseve që të mos aplikojnë fare për financim në institucionet financiare në Kosovë, gjë që ndikon negativisht në veprimtarinë dhe rritjen e biznesit të tyre. Qasja e ndërmarrjeve në financa, përveç faktorëve të lartpërmendur, varet edhe nga projektet investive me të cilat disponojnë ndërmarrjet. Një nga faktorët që mund të ketë ndikuar në shkallën më të ulët të qasjes së ndërmarrjeve në financa në Kosovë mund të ketë qenë mungesa e projekteve investive, gjë që nënkupton se niveli aktual i qasjes në financa mund jetë i mjaftueshëm për kërkesën e ndërmarrjeve për financim.

#### 11.4 Përfundim

Kjo analizë është mbështetur në të dhënat nga anketa BEEPS, e cila në Kosovë për herë të parë është implementuar në vitin 2009. Rezultatet nga kjo anketë kanë mundësuar identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet në Kosovë si dhe krahasimin e tyre me pengesat për ndërmarrjet në vendet tjera të rajonit. Bazuar nga rezultatet e anketës, mund të konstatohet se ndër pengesat më të mëdha për ndërmarrjet në Kosovë janë mungesa e energjisë elektrike si dhe prezenca e korrupsionit dhe ekonomisë joformale. Për dallim nga vendet tjera të rajonit, pjesëmarrja e ndërmarrjeve të anketuara që raportojnë qasjen në financa si pengesën kryesore për veprimtarinë e tyre në Kosovë është mjaft e ulët. Megjithatë, duhet të kemi parasysh që qasja në financa nuk u konsiderua si pengesë kryesore për bizneset në Kosovë kryesisht për shkak se pesha e pengesave tjera si energjia elektrike, prezenca e korrupsionit dhe ekonomisë joformale ishte më e madhe krahasuar me qasjen në financa. Në anën tjetër, qasja e ndërmarrjeve në financa në Kosovë paraqitet të jetë në nivel më të ulët krahasuar me vendet tjera. Kjo deri në një masë i atribuohet strukturës së ndërmarrjeve që operojnë në Kosovë, që përbëhet nga ndërmarrjet e vogla, gjë që është reflektuar edhe në strukturën e ndërmarrjeve të përfshira në këtë anketë. Ndërmarrjet e vogla konsiderohen të jenë më të kufizuara për sa i përket mundësisë së tyre për të siguruar qasje në financa për shkak të faktorëve që ndërlidhen me informacionin e kufizuar mbi performancën e tyre në të kaluarën, si dhe kërkesave më të mëdha për mbulimin e kredisë me kolateral për këto ndërmarrje. Në të njëjtën kohë, përqindja e ndërmarrjeve që shfrytëzojnë financim bankar për investime si dhe përqindja e investimeve që mbulohen nga financimi bankar është më e ulët në Kosovë krahasuar me vendet në rajon. Kjo mund të reflektojë jo vetëm problemet në anën e ofertës por edhe kufizimet në anën e kërkesës. Normat e larta të interesit për kredi në Kosovë dhe shkalla e lartë e kolateralit të nevojshëm për kredimarrje dekurajojnë kërkesën e ndërmarrjeve për të ju qasur financimit bankar. Mirëpo, qasja më e kufizuar në financim bankar në Kosovë krahasuar me vendet në rajon mund të reflektojë edhe mungesën e ideve dhe projekteve investuese nga ana e ndërmarrjeve, gjë që ndikon direkt në kërkesën e tyre për financim bankar.

<sup>20</sup> International Financial Statistics (IFS), Qershor 2010.





## **Shtojca Statistikore**



Tabela 1. Indikatorët kryesorë Makroekonomik

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
<b>Sektori real</b>				
PBB nominale (në miliona euro) 1/	3,182	3,411	3,849	3,868
PBB reale 1/	4.0%	4.0%	5.4%	4.0%
PBB për kokë banorë (në euro) 1/	1,515	1,605	1,784	1,766
PBB nominale (në miliona euro) 2/	3,120	3,394	3,851	3,912
Çmimet (mesatarja vjetore) 2/	0.6%	4.4%	9.4%	-2.4%
Çmimet (ndryshimi vjetor) 2/	1.1%	10.5%	0.5%	0.1%
<b>Sektori financiar (në milionë euro)</b>				
Asetet e korporatave financiare	2,159.0	2,941.9	3,370.3	4,005.0
prej të cilave: Korp. tjera depozituese	1,161.2	1,435.0	1,808.2	2,204.1
Kreditë e korporatave tjera depozituese	636.6	892.1	1,183.4	1,289.0
Depozitat në korporatat tjera depozituese	924.3	1,143.1	1,444.1	1,744.9
<b>Sektori i jashtëm (në milionë euro)</b>				
Llogaria rrjedhëse	-226.1	-354.1	-628.7	-673.5
prej të cilave: importi i mallrave	-1,295.6	-1,545.2	-1,885.7	-1,850.6
prej të cilave: Dërgesat e emigrantëve (pranimet)	467.1	515.6	535.4	505.6
Llogaria kapitale dhe financiare	-14.9	91.3	462.8	535.7
prej të cilave: inv. e huaja direkte (pranimet)	289.2	431.0	341.5	273.6

1/ FMN (2008, 2010);

2/ ESK (2010);

3/ MEF.

Tabela 2. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sistemi bankar	Grupi bazë i indikatorëve	2007	2008	2009	Qershor 2010
<b>Mjaftueshmëria e kapitalit</b>	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.5	16.5	18.1	18.7
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	16.2	15.3	15.2	15.9
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	2.8	2.3	2.9	3.6
<b>Cilësia e asetëve</b>	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	4.1	2.8	4.3	4.5
	Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive				
	<i>Korporatat tjera financiare</i>	0.0	0.1	0.2	0.3
	<i>Korporatat publike jofinanciare</i>	0.02	0.01	0.02	0.45
	<i>Korporatat tjera jofinanciare</i>	77.5	76.2	73.1	70.1
	<i>Ekonomitë familjare</i>	22.5	23.7	26.7	29.2
	<i>Gjithsej</i>	100.0	100.0	100.0	100.0
<b>Profitabiliteti</b>	Kthimi në asetëve (ROAA)	3.2	3.0	1.5	1.7 *
	Kthimi në kapital (ROAE)	32.6	27.3	15.0	18 *
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	69.9	75.0	74.4	75.0
	Shpenzimet jo-interes ndaj të hyrave bruto	68.2	68.7	80.2	74.1
<b>Likuiditeti</b>	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	26.5	26.8	34.6	29.2
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	26.6	28.0	37.3	32.1
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	32.9	33.4	43.6	36.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	33.0	35.0	47.0	40.5
<b>Senzitiviteti ndaj riskut të tregut</b>	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit		13.1	12.4	11.3
	<b>Grupi i zgjeruar i indikatorëve</b>				
	Kapitali ndaj asetëve	11.2	11.2	9.8	10.7
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	38.3	56.5	64.6	62.8
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	35.8	36.2	39.4	34.9
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	10.1	9.4	10.1	10.3
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	124.0	117.1	129.8	121.9
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	3.9	4.7	5.4	4.8

\* Të dhënat për ROAA dhe ROAE për qershor 2010 janë të përvitësuar.

Tabela 3. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, në mijëra euro

## Procredit Bank

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	90,221	Bilanci nga bankat tjera	1,712
Bilanci me bankat komerciale	61,295	Depozitat	597,372
Letrat me vlerë	53,096	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	498,259	Detyrimet tjera	45,666
Asetet fikse	17,788	Borxhi i ndërrvarur	24,448
Asetet tjera	17,463	Mjetet vetanake	68,924
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>738,121</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>738,121</b>

## Raiffeisen Bank

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	77,821	Bilanci nga bankat tjera	33,439
Bilanci me bankat komerciale	172,820	Depozitat	521,973
Letrat me vlerë	40,642	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	378,853	Detyrimet tjera	50,948
Asetet fikse	8,451	Borxhi i ndërrvarur	...
Asetet tjera	6,659	Mjetet vetanake	78,887
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>685,247</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>685,247</b>

## Banka për Biznes

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12,964	Bilanci nga bankat tjera	90
Bilanci me bankat komerciale	8,090	Depozitat	74,716
Letrat me vlerë	...	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	64,210	Detyrimet tjera	4,003
Asetet fikse	2,010	Borxhi i ndërrvarur	...
Asetet tjera	730	Mjetet vetanake	9,195
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>88,004</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>88,004</b>

## Banka Ekonomike

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	10,358	Bilanci nga bankat tjera	3,231
Bilanci me bankat komerciale	15,307	Depozitat	87,924
Letrat me vlerë	...	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	78,643	Detyrimet tjera	3,958
Asetet fikse	1,431	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	1,767	Mjetet vetanake	12,393
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>107,506</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>107,506</b>

## Banka Kombëtare Tregtare

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	5,515	Bilanci nga bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	1	Depozitat	43,362
Letrat me vlerë	8,184	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	51,101	Detyrimet tjera	18,145
Asetet fikse	2,335	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	591	Mjetet vetanake	6,220
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>67,726</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>67,726</b>

## NLB Prishtina

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	31,982	Bilanci nga bankat tjera	9,333
Bilanci me bankat komerciale	68,163	Depozitat	260,013
Letrat me vlerë	12,100	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	206,560	Detyrimet tjera	27,048
Asetet fikse	4,971	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	3,217	Mjetet vetanake	30,599
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>326,993</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>326,993</b>

## TEB Bank

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	30,000	Bilanci nga bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	6,268	Depozitat	124,261
Letrat me vlerë	...	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	100,093	Detyrimet tjera	3,681
Asetet fikse	4,070	Borxhi i ndërvlarur	...
Asetet tjera	480	Mjetet vetanake	12,968
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>140,911</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>140,910</b>

## Komerçijalna Banka

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	9,064	Bilanci nga bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	19,607	Depozitat	26,819
Letrat me vlerë	...	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	3,230	Detyrimet tjera	679
Asetet fikse	...	Borxhi i ndërvlarur	...
Asetet tjera	683	Mjetet vetanake	5,086
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>32,584</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>32,584</b>

Tabela 4.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto							Kërkesat e brendshme									
	Kërkesat ndaj jorezidentëve	prej të cilave:					Minus: detyrimet ndaj jorezidentëve	202.5	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore			Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	prej të cilave:				
		Ari monetar dhe DST-të	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota në FMN	Asetet dhe ekuitetet tjera			Kërkesat ndaj qeverisë qendrore	Minus: detyrimet ndaj qeverisë	Depozita		Kreditë	prej të cilave:			
														Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare		
2004 Dhjetor	722.8	772.0	—	384.0	236.7	—	83.3	49.2	202.5	-216.8	—	216.8	216.8	419.3	413.5	329.8	83.7
2005 Dhjetor	827.3	890.9	—	422.6	242.4	—	145.3	63.6	348.9	-225.7	—	225.7	225.7	574.6	565.6	439.6	126.0
Shtator	1,136.3	1,209.0	—	635.5	327.4	—	149.6	72.7	194.2	-497.8	—	497.8	497.8	692.0	676.1	532.0	144.0
2006 Dhjetor	1,173.6	1,245.7	—	660.0	341.3	—	170.8	72.1	231.7	-475.0	—	475.0	475.0	706.6	694.3	548.2	146.1
Mars	1,331.4	1,420.0	—	761.2	411.5	—	139.9	88.6	144.3	-617.4	—	617.4	617.4	761.6	749.2	598.2	150.9
Qershor	1,400.3	1,481.1	—	846.0	371.9	—	153.3	80.9	160.4	-704.9	—	704.9	704.9	865.4	852.8	682.8	169.9
Shtator	1,590.9	1,670.9	—	989.9	395.8	—	170.0	80.0	60.5	-850.2	—	850.2	850.2	910.7	895.6	709.0	186.5
2007 Dhjetor	1,622.4	1,704.6	—	956.0	408.9	—	175.4	82.3	124.5	-853.3	—	853.3	853.3	977.8	965.9	765.1	200.6
Mars	1,621.8	1,720.7	—	996.0	384.8	—	173.5	98.9	140.8	-919.6	—	919.6	919.6	1,060.5	1,045.6	834.7	210.7
Qershor	1,638.9	1,749.5	—	1,054.2	369.6	—	173.7	110.6	226.4	-963.0	—	963.0	963.0	1,189.4	1,175.4	936.6	238.6
Shtator	1,761.0	1,892.4	—	1,244.9	361.3	—	159.3	131.5	238.8	-998.3	—	998.3	998.3	1,237.1	1,223.6	961.0	262.4
2008 December	1,593.1	1,726.7	—	795.1	661.6	—	128.2	133.6	419.6	-871.8	—	871.8	871.8	1,291.5	1,276.8	995.7	281.0
Mars	1,605.4	1,758.1	—	658.4	838.4	—	115.8	152.7	446.7	-898.4	—	898.4	898.4	1,345.1	1,327.6	1,038.1	289.4
Qershor	1,610.7	1,789.3	—	654.7	862.5	—	132.1	178.6	501.2	-900.6	—	900.6	900.6	1,401.8	1,384.0	1,072.7	311.2
Shtator	1,740.1	2,009.2	—	768.0	895.1	—	138.3	269.1	535.3	-871.9	—	871.9	871.9	1,407.2	1,387.8	1,055.6	329.7
2009 Dhjetor	1,700.5	2,036.2	60.3	910.1	724.3	64.3	144.3	335.7	573.7	-846.3	—	846.3	846.3	1,420.0	1,398.4	1,052.3	343.5
Mars	1,769.7	2,116.8	62.4	1,003.7	635.3	66.5	211.5	347.1	589.3	-878.3	—	878.3	878.3	1,467.6	1,446.1	1,056.3	382.8
2010 Qershor	1,748.8	2,098.1	67.0	961.2	568.5	71.4	252.3	349.3	600.9	-940.7	—	940.7	940.7	1,541.6	1,518.6	1,103.1	409.1



Tabela 4.2. Pasqyra e korporatave financiare - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Depozitat									Kreditë	Rezerva teknike të sigurimit			Asetet dhe ekuitet e tjera	Zëra tjerë (neto)
	Dep. e transferu eshme	prej të cilave:			Dep. tjera	prej të cilave:			Ek. neto i ek. familjare ne fondet e pens.		Pagesa e premive dhe rezervave				
		Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare		Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare							
2004 Dhjetor	670.7	273.7	34.6	81.3	145.5	396.9	149.3	24.4	222.5	2.3	106.5	88.7	17.9	145.1	0.7
2005 Dhjetor	830.6	315.0	67.6	76.8	155.5	515.6	181.3	33.7	298.9	3.0	174.5	152.4	22.1	165.8	2.2
Shtator	849.6	312.5	54.6	95.0	149.8	537.1	162.3	31.0	341.2	3.2	224.5	199.8	24.7	200.5	52.6
